

Perparime Huta

BIBLIOTEKA

94965

H. 97

**FSHATI  
NE SANXHAKUN  
E SHKODRES**

**Ne shekujt xv - xvi**


949.65  
H97

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË  
INSTITUTI I HISTORISË

PËRPARIME HUTA

FSHATI  
NË SANXHAKUN  
E SHKODRES  
NE SHEK. XV-XVI

(VËSHTRIM MBI DEMOGRAFINË  
DHE EKONOMINË)



TIRANË, 1990

## PARATHËNIE

*Ky punim i kushtohet gjendjes demografike të fshatit në krahinat e sanxhakut të Shkodrës gjatë shek. XV-XVI, dhe gjendjes ekonomike në fund të shek. XV (viti 1485).*

*Objekt studimi kemi bërë qëndrueshmërinë dhe dinamikën e vendbanimeve fshatare, gjendjen e tyre demografike, lëvizjet e popullsisë të kryera për shkaqe politike, ekonomike, shoqërore dhe gjeografike, shpërndarjen e saj sipas krahinave etj. Një vend më të rëndësishëm i kemi dhënë ndriçimit të ekonomisë së fshatit, karakterit dhe nivelit të zhvillimit të saj, strukturës së prodhimit bujqësor të kësaj kohe, nëpërmjet nxjerrjes në pah të kulturave bujqësore që kultivoheshin dhe vendit që ato zinin në prodhimin bujqësor global, nivelit të zhvillimit të marrëdhënieve feudale në fshat, duke analizuar raportin midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla që shlyente fshatarësia ndaj shtetit venedikas në vitet 1416-17 dhe ndaj feudalëve të veçantë spahinj pas pushtimit osman, në vitin 1485.*

*Duke i analizuar këto probleme me të dhëna konkrete historike për një trevë dhe periudhë kohore të caktuar, jemi përprjekur t'i përgjigjemi detyrës që ka shtruar shoku Enver Hoxha kur thekson se «Ne duhet ta shkruajmë objektivisht historinë e popullit e sidomos atë të fshatarësisë, mbi bazën e një sistemi rigoroz shkencor, konsekuent, të mbështetur në metodologjinë marksiste-leniniste, që është më*

kryesorja, ndryshe nuk mund të shpjegojmë si duhet shndërrimet e thella që janë bërë...».<sup>1</sup>

Historiografia e re shqiptare, nëpërmjet studimeve të ndryshme ka hedhur dritë mbi gjendjen demografike dhe ekonomike të trevave shqiptare gjatë shek. XV-XVI. Një ndihmesë me rëndësi në këtë drejtim ka sjellë teksti i Historisë së Shqipërisë,<sup>2</sup> ndonëse në të ky problem është trajtuar në mënyrë të përgjithësuar në përputhje me natyrën e kësaj vepre. Në vijat më themelore ai është trajtuar duke arritur në përgjithësime me shumë vlerë, në studimet e prof. A. Budës.<sup>3</sup> Tiparet e përgjithshme që ato zbulojnë mbi demografinë dhe ekonominë e fshatit shqiptar na kanë shërbyer si mbështetje për hartimin e punimit.

Arritje me rëndësi e historiografisë sonë janë botimi i dy regjistrave kadastralë të shek. XV nga I. Zamputi<sup>4</sup> dhe nga S. Pulaha<sup>5</sup>. Këto regjistra kanë krijuar një bazë të gjerë dokumentare për historinë e trevave të sanxhakut të Shkodrës, e cila bën të mundur dhe lejon të ndriçohet me hollësi gjendja demografike dhe ekonomike e fshatit në shek. XV.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë, më konkrete dhe më gjerësisht duke u mbështetur në material të ri burimor janë trajtuar aspekte të ndryshme të demografisë dhe të ekonomisë së trevave të Shqipërisë së Veriut në një varg punimesh të S. Pulahës<sup>6</sup>, të cilat kanë sjellë një ndihmesë me vlerë dhe na kanë hapur rrugë për të analizuar më tej gjendjen dhe problemet që shqyrtohen.

---

1) Enver Hoxha, «Të ngrihen në një nivel më të lartë shkencat që studiojnë historinë, gjuhën dhe kulturën tonë kombëtare». Raporte e fjalime 1982-1983, f. 347.

2) Historia e Shqipërisë. Tiranë, 1959, v. I, f. 207, 212, 260-262, 322-324, 333-342.

3) A. Buda. Vendi i shqiptarëve në historinë mesjetare evropiane në shek. VIII-XVIII. «Studime historike», 1967, nr. 1, f. 3-20; Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij. Po aty, 1980, nr. 1, f. 165-188.

4) I. Zamputi. Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417. Tiranë, 1977 (më poshtë: Kadastra e Shkodrës...).

5) S. Pulaha. Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485. Tiranë, 1975 (më poshtë: Regjistri 1485...).

6) S. Pulaha, Krahinat perëndimore e qendrore të sanxhakut të Shko-

Këto probleme janë trajtuar në formë të përgjithësuar edhe në dy artikuj nga K. Biçoku<sup>1</sup> dhe nga K. Luka.<sup>2</sup>

Çështje anësore që lidhen tërthorazi me ekonominë e fshatit shqiptar dhe që na kanë vlejtur, janë prekur edhe në historiografinë e huaj nga A. Dyselie<sup>3</sup> dhe në mënyrë më të cekët nga B. Hrabak<sup>4</sup> dhe nga E. Armao. Në punimin e A. Dyseliesë sillen të dhëna me vlerë nga dokumentacioni i arkivit të Venedikut dhe të Raguzës që dëshmojnë për një zhvillim relativisht të lartë të bujqësisë në trevat shqiptare gjatë Mesjetës. Në atë të B. Hrabakut vihet në dukje eksporti mjaft i madh i drithit për në Venedik, kurse punimi i E. Armaos me karakter kryesisht gjeografik na ka vlejtur për njohjen e krahinave dhe të toponimisë.<sup>5</sup>

Një grup më vete në historiografinë e huaj përbëjnë ata autorë të cilët, të nisur nga synime politike antishqiptare, e kanë paraqitur gjendjen demografike dhe ekonomike të Shqipërisë së Veriut jo në dritën e së vërtetës. Ata janë përpjekur t'i veshin fshatit shqiptar një nivel të ulët të zhvillimit ekonomik-shoqëror, ta paraqitin atë të paqendrueshëm dhe popullsinë si endacake e të përqëndruar vetëm në trevat e brendshme malore të Shqipërisë së Veriut, nga ku ajo, sipas tyre, qenka dyndur dhe ka populluar trevat shqiptare

---

drës në fund të shek. XV. «Studime historike», 1971, nr. 2, f. 43-74, nr. 3, f. 115-138; Kontribut për studimin e ngulitjes së katuneve dhe krijimin e fiseve në Shqipërinë e Veriut në shek. XV-XVI. Po aty, 1975, nr. 1, f. 75-110; Gjendja demografike në tokat shqiptare në shek. XV-XVI. Gjetet si kapitull i veçantë në librin «Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI». Tiranë, 1984, f. 601-659. Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shek. XV-XVI, «Studime historike», 1985, nr. 3, f. 175-185.

1) K. Biçoku, *Vështrim mbi ekonominë dhe demografinë e fshatit shqiptar në shek. XV*. Po aty, 1976, nr. 4, f. 163-185.

2) K. Luka, *Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës*, «Studime filologjike», 1976, nr. 1, f. 137-188. nr. 2, f. 129-178.

3) A. Ducellier, *La facade maritime de l'Albanie au moyen age*, Thessaloniki, 1981, f. 181-200, 275-293, 359-413, 560-606.

4) B. Hrabak, *Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shek. XIII, XIV, XV*, «Gjurmime albanologjike», 1970, f. 23-90.

5) E. Armao, *Localita, chiese, fiumi, monti e toponimi varii di un antica carta dell'Albanie settentrionale*, Roma, 1933.

bregdetare dhe ato verilindore, madje edhe në shekujt e sundimit osman. Midis këtyre shquhet për pikëpamjet antishqiptare dhe pa baza shkencore A. M. Selishev. Një karakter mobil u ka veshur vendbanimeve dhe popullsisë në Shqipërinë e Veriut edhe studiuesi serb S. Novakoviç.<sup>1</sup>

Këto pikëpamje, që ndeshen edhe në autorë të tjerë të historiografisë nacionaliste serbomadhe të shek. XIX, janë të pranishme edhe sot në një formë më të gjallëruar, në historiografinë jugosllave. Ato kanë zënë vend në tekstin zyrtar «Historia e popujve të Jugosllavisë», ku autor i pjesës përkatëse është V. Çubriloviç, një nga frymëzuesit e genocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës<sup>2</sup> dhe në veprën e botuar kohët e fundit nga D. Bogdanoviçi.<sup>3</sup>

Në të njëjtat përfundime ka arritur edhe studiuesi gjerman G. Shtadmyller,<sup>4</sup> duke u nisur nga pozita metodologjike të gabuara dhe nga një bazë burimore tepër e varfër dhe e kufizuar. Tabloja që zbulon ky punim për gjendjen demografike dhe ekonomike të Shqipërisë së Veriut përgënjeshtroon pikëpamjet e kësaj historiografie.

Në dallim me të gjitha studimet e kryera deri më sot, në këtë punim i bëhet një analizë e imët e tërësore, me të dhëna konkrete të dokumentuara gjendjes së vendbanimeve fshatare, qëndrueshmërisë dhe dinamikës së zhvillimit të tyre gjatë periudhës së shekujve XV-XVI. Ai paraqet ekonominë e fshatit duke dhënë një tablo të qartë të gjendjes së kulturave bujqësore dhe të vendit të secilës në prodhimin bujqësor, të vendit të bujqësisë në ekonominë e krahinave të sanxhakut si dhe rentat në natyrë dhe në të holla që merrnin shteti venedikas dhe më vonë feudalët osmanë si edhe raporti midis tyre.

Analizë e hollësishme i është bërë edhe gjendjes demografike. Në krahasim me studimet e S. Pulahës të cilat në këtë drejtim janë të një karakteri më të përgjithshëm sepse e shqyrtojnë gjendjen demografike për gjithë tokat shqip-

1) S. Novakoviç. «Selo» marrë nga Srpska knjizavno zadruga Libri 301, cikli XLIV, Beograd, 1943.

2) Istorija naroda Jugoslavije, knjiga 2, Beograd, 1960, f. 770, 790-791, 801.

3) D. Bogdanoviç, *Knjiga o Kosovu*, Beograd, 1985.

4) G. Stadmuller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden, 1966, f. 141, 147, 154, 159.

tare duke marrë për bazë njësitë administrative si sanxhakët dhe nahijet, punimi e analizon atë për krahinat e sanxhakut të Shkodrës dhe përpiqet të shkojë më thellë në njohjen e gjendjes duke marrë për bazë fshatin. Kjo jep mundësi të zbulohen më mirë shtimi i vendbanimeve dhe i popullsisë, shpërndarja e saj gjeografike si dhe veçoritë krahinore.

\*  
\*  
\*

Shqyrtimi analitik e tërësor i të dhënave burimore në punim tregon se fshati në krahinat e sanxhakut të Shkodrës në shek. XV-XVI ishte i qëndrueshëm, se ai e kishte vijuar jetën e vet duke kaluar nga njëri shekull në tjetrin. Në fillimet e shek. XV ai paraqitej në regjistrat kadastralë i ngulitur, me ekonominë e vet të veçantë, me kufij ndarës të përcaktuar qartë nga vendbanimet e tjera. me emërtimin e vet dhe me kryefamiljarët (shtëpitë) që shlyenin detyrimet përkatëse të përcaktuara ab antiquo.

Çdo fshat kishte një fizionomi demografike dhe ekonomike të dalluar që dëshmon në mënyrë të qartë se ai ekzistonte shumë kohë më parë si vendbanim. Qëndrueshmëria e tij duket qartë në faktin se nga 116 fshatra në Ultësirën e Shkodrës të regjistruar në Kadastrën Venedikase më 1416-17 e kishin vazhduar jetën pas pushtimit osman më 1485, 50,9 për qind e tyre (59 fshatra), duke përballuar veprimin negativ të faktorëve politikë në shek. XV siç qenë konfliktet e armatosura midis Balshajve e venedikasve, dhe me një ndikim shumë më të madh, inkursicnet e herëpashershme të ushtrive osmane e sidomos, fushatat e mëdha të ushtrive të Perandorisë Osmane kundër Shkodrës më 1474 e 1478. Pasojat rrënuese e shkatërruese të pushtimit osman dhe emigracioni i madh në Itali e Dalmaci që e pasoi, shkaktuan shpopullimin dhe braktisjen e një vargu fshatrash, e për pasojë shndërrimin e një pjese të mirë të tyre në truallishte.

Me stabilizimin deri në një farë mase të gjendjes politike në shek. XVI, kur faktorët ekonomikë filluan të veprojnë më fuqishëm, vendbanimet fshatare ripërtërihen, zmadhohen, një pjesë e atyre të braktisura më parë shndërrohen përsëri në fshatra, krijohen ngulime të reja etj. Në Ultësirën e Shko-

drës në vitin 1582 e vazhduan jetën 67,2 për qind e fshatrave (78 fshatra) që ekzistonin në fillim të shek. XV.

Vijueshmëria e jetës konstatohet edhe në vendbanimet e trevave të tjera të sanxhakut të Shkodrës gjatë periudhës nga viti 1485 deri më 1582, në të cilat ndikimi shkatërrues i faktorëve politikë kishte qenë shumë më i pakët. Nga 67 fshatra në Malësinë e Shkodrës e kishin vazhduar jetën 57 fshatra (85 për qind), kurse në viset e Pejës, të Suhogërlës dhe të Altun Ilisë nga 275 fshatra 219 fshatra (79 për qind) dhe në krahinën e Bihorit 74 fshatra (95 për qind).

Dukuria e ripërtëritjes në fund të shek. XVI e fshatrave të shpopulluara e të braktisura apo të shkatërruara në fillimet e pushtimit osman (1485), si dhe vijueshmëria e jetës së shumicës së vendbanimeve, ndonëse përjetuan kushtet e veprimt shkatërrues të pushtimit osman e më në fund zmadhimi e degëzimi i fshatrave të vjetër, janë treguesit më elokuentë që flasin për qëndrueshmërinë e tyre si ngulime të krijuara shumë shekuj më parë, se ishin vendbanime me burime ekonomike të normalizuara dhe me popullsi stabël në selitjet e veta, të formuar si kombësi në rrjedhën e shekujve.

Gjatë kalimit nga shek. XV në shek. XVI numri i vendbanimeve fshatare në sanxhakun e Shkodrës ishte shtuar edhe me krijimin e ngulimeve të reja. Ky shtim, sipas kushteve konkrete natyrore e ekonomike ishte rritur diku më shumë e diku më pak. Shtim më të madh kishte pasur në Ultësirën e Shkodrës (126 fshatra) për arsye të terrenit fushor, me kushte të përshtatshme për krijimin e ngulimeve të reja, dhe të ripërtëritjes së jetës në fshatrat e braktisura në fillimet e pushtimit osman. Në trevat malore të Malësisë së Shkodrës e të Bihorit respektivisht ishin krijuar më pak vendbanime të reja, 14 në të parën e 12 në të dytën mbasi nyjat më të përshtatshme për jetesë qenë zënë me kohë dhe vetë ekzistenca e një terreni të thyer, pa toka të punueshme e vështirësonte së tepërmi krijimin e ngulimeve të reja. Me zhvillimin e forcave prodhuese dhe shtimin e popullsisë, ndonëse me ritme të ngadalta për shkak të një vargu faktorësh frenues që vepruan gjatë pushtimit osman, fshati nuk qëndroi i pandryshueshëm, statik por eci në rrugën e zhvillimit. Krahas ripërtëritjes u krijuan fshatra të reja në toka të hapura rishitas, u zgjeruan dhe u zmadhuan fshatrat e vjetra, duke u



degëzuar dhe u krijuan ngulime të reja jo vetëm nga ndarja e vëllazërive por edhe nga vendosja e blegtorëve në vendet e kullotave dimërore në fusha, krahas atyre në kullotat verore në malësi. Herë-herë konstatohet edhe kthim fshatrash në truallishte, edhe kalimi i ndonjë fshati në përbërjen e një tjetri duke mos ekzistuar më si fshat më vete etj. Edhe pse vendbanimet fshatare karakterizoheshin nga stabiliteti, ato nuk kishin qenë statike, të dhënë një herë e përgjithmonë, por kishin ecur dhe vazhduan të ecin nëpër rrugën dialektike të zhvillimit në përputhje me veprimin e faktorëve ekonomikë, politikë, shoqërorë, gjeografikë etj., të cilët herë e kishin frenuar dhe herë e kishin shpejtuar këtë zhvillim. Në përshtatje me këta faktorë popullsia kishte pasur këtë shpërndarje: më e dendur kishte qenë më 1485 në zonën Pejës-Suhogërlë-Altun-ili dhe në krakinën e Bihorit që nuk përsuan stuhinë e viteve 70, kurse më e rrallë në Ultësirën e Shkodrës, me gjithë kushtet e përshtatshme ekonomike e gjeografike. Akoma më e rrallë ishte në Malësinë e Shkodrës për shkak të kushteve të papërshtatshme ekonomike dhe gjeografike. Popullsia e sanxhakut të Shkodrës ishte e përqëndruar kryesisht në trevat fushore me ekonomi të zhvilluar bujqësore-blegtorale, në rrafshnaltat në viset kodrinore, dhe më pak në trevat malore me ekonomi kryesisht blegtorale.

Me kapërcimin e pasojave negative të pushtimit osman dhe me stabilizimin deri në një farë mase të jetës ekonomike, shoqërore e politike të vendit në shek. XVI, popullsia në vitin 1582 ishte shtuar, ku më shumë e ku më pak në të gjitha trevat e sanxhakut të Shkodrës.

Në ultësirën e Shkodrës ajo ishte rritur më shumë se dy herë e gjysmë, jo vetëm në sajë të shtesës natyrore, por edhe të zbritjes dhe vendosjes në fushë të fshatarëve të ardhur nga Malësia, sidomos nga viset e Hotit e të Kelmendit popullsia e të cilëve ishte pakësuar. Tokat e lira pas shpopullimit në shek. XV dhe kushtet më të mira ekonomike dhe gjeografike të fushës së Shkodrës e bënë të mundshme vendosjen e malësorëve në këto zona. Edhe në Malësinë e Shkodrës me gjithë shpërnguljen e lartpërmendur popullsia ishte shtuar mjaft. Në trevat e Pejës, Suhogërlës dhe në viset e Bihorit ishte shtuar më pak, kurse në trevën e Altun-ilisë ishte pakësuar. Shtimi jo i madh në trevat e Rrafshit të Dukaqinit të kuptohet se prej këndej duhet të ketë pasur ikje të elementëve të krishterë nga pakica serbe, dikur sunduese po-

litikisht por tashmë në kushte jo të favorshme të krijuara nga eliminimi i sundimit serb, nga dobësimi i pozitës mbizotëruese të kishës ortodokse serbe dhe nga përhapja e procesit të islamizimit.

Pushtimi osman, me gjithë pengesat dhe vështirësitë që solli, nuk mundi të pengonte rigjallërimin e forcave njerëzore, e këtij elementi kryesor në sistemin e forcave prodhuese. Veprimi i faktorëve politikë, ekonomikë, shoqërorë, ndonëse sollën herë kthesa prapa të përkohshme, frenuan e i ngadalësuan ritmet, ata nuk mundën dhe nuk mund të ndalnin zhvillimin e përparimin e shoqërisë shqiptare edhe në aspektin demografik.

Trevat e sanxhakut të Shkodrës në fund të shek. XV, sipas regjistrimit të vitit 1485, karakterizoheshin nga një ekonomi bujqësore të gërshetuar me atë blegtorale në çdo zonë, duke pasur përparësi diku bujqësia dhe diku blegtoria në përshtatje me kushtet ekonomike dhe gjeografike të vendit.

Sipas kushteve të terrenit kultivoheshin një numër i madh kulturash. Në zonat fushore e kodrinore si ato të Ultësirës së Shkodrës e të Rrafshit të Dukagjinit kishte shumë llojshmëri më të madhe ku mbisundonin drithërat e bukës, perimet, pemët (sidomos rrushi). Një numër më i oaktë kulturash kultivoheshin në krahinat malore të Bihorit dhe veçanërisht të Malësisë së Shkodrës, por edhe aty, ndonëse në sasi të paktë mbilleshin gruri dhe elbi.

Në të gjitha trevat gruri ishte kultura me përhapje më të gjerë në krahasim me kulturat e tjera dhe sillte të ardhura të konsiderueshme. Pas tij vinin elbi, thekri, meli etj. Nga frutat ishin më të përhapura rrushi dhe kumbullat.

Fshatari me përvojën e vet tradicionale përcaktonte vendin e kulturave të veçanta sipas terrenit dhe rëndësisë që ato kishin në jetën ekonomike të vendit. Në kushte të ndryshme natyrore doemos kulturat zinin një vend jo të njëjtë në ekonominë bujqësore të sanxhakut të Shkodrës. Kjo shprehet ndër të tjera nga shumata e të ardhurave që vileshin prej tyre në zonat përkatëse dhe që kalonin në dobi të feudalëve. Midis këtyre vendin më të rëndësishëm e zinin drithërat, kurse në drithërat prodhimi më i madh arrihej në zonën e Rrafshit të Dukagjinit e të Ultësirës së Shkodrës. Pas tyre vinte vreshtaria në trevat me ekonomi mbizotëruese bujqësore, kurse në trevat malore ishte shumë e paktë. Vendi më pak të rëndësishëm zinin kopshtaria, pemëtaria. Të ar-

dhurat nga drithërat dhe nga rrushi e nën produktet e tij përbënin rreth 45-60 për qind të të ardhurave që vinin nga bujqësia.

Në sanxhakun e Shkodrës ekzistonte një rajonizim në zhvillimin e kulturave bujqësore e sidomos në drithëra e në vreshtari. Në këtë të fundit një numër fshatrash kishin një specializim të veçantë dhe nxirrnin më shumë të ardhura nga rrushi dhe nënproduktet e tij sesa nga drithërat.

Shumëllojshmëria e kulturave bujqësore, specializimi i fshatrave të veçanta në kultivimin e drithërave ose në vreshtari ose me bimë të tjera siç qenë p.sh. edhe ato të nevojshme për prodhimin zejtar, janë tregues të qartë që dëshmojnë se popullsia vendase ishte sedentare me një ekonomi bujqësore relativisht të zhvilluar për kohën, që i kishte rrënjët në një traditë të lashtë.

Në krahinat e sanxhakut të Shkodrës, gjatë fundit të shek. XV, degët kryesore të veprimtarisë ekonomike të popullsisë i përbënin bujqësia dhe blegtoria. Në trevat e Ultësirës së Shkodrës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, bujqësia përbënte degën kryesore të ekonomisë. Në krahinën e Bihorit ajo zinte një vend më të vogël, kurse në Malësinë e Shkodrës vendin kryesor në ekonomi e zinte blegtoria.

Shprehje të mbizotërimit të ekonomisë blegtorale e sidomos në Malësinë e Shkodrës janë jo vetëm kultivimi i një numri të paktë kulturash bujqësore, por edhe mungesa e të ardhurave nga pemëtaria e kopshtaria, ruajtja e formës fikse të shlyerjes së rentës feudale si florixhinj, derbenxhij, eflakë, karakteristikë kjo në trevat me ekonomi kryesisht blegtorale. Më së fundi edhe vetë moszbatimi i regjimit të timarit, i përshtatshëm kryesisht për viset fshatare me ekonomi bujqësore, është një argument tjetër që flet për karakterin mbizotërues blegtoral të ekonomisë në viset malore.

Bujqësia dhe blegtoria si dy degë kryesore të ekonomisë ishin të lidhura ngushtë dhe pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Nuk kishte zonë ose fshat me ekonomi thjesht bujqësore ose thjesht blegtorale, qoftë edhe në Malësi, gjë që shprehej në faktin se çdo vendbanim shlyente qoftë tatime mbi prodhimet bujqësore, qoftë taksa që lidheshin me blegtorinë. Fshatarësia ishte marrë njëkohësisht me bujqësi dhe blegtori dhe në përputhje me kushtet kishte zhvilluar më tepër njërin ose tjetrën degë të ekonomisë.

Fshati në Shqipërinë Veriore në shek. XV nuk ishte një

njësi e mbyllur në vetvete në guaskën e ekonomisë natyrore. Në një masë të konsiderueshme ai ishte i lidhur me tregun. Këtë e dëshmon qartë raporti që ekzistonte midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla si në periudhën e sundimit venedikas ashtu edhe atij osman. Në të dyja periudhat, raporti ishte në favor të rentës në natyrë.

Me pushtimin osman nuk u krye ndonjë ndryshim thelbësor në raportin midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla. Është për t'u theksuar se në trevat malore me ekonomi kryesisht blegtorale renta në të holla zë një vend më të madh nga ajo në natyrë. Mbizotërimi i kësaj rente lidhet në radhë të parë me faktin që në këto krahina renta kërkohej kryesisht në të holla, meqë u përkiste edhe të ardhurave qendrore të shtetit osman, gjë që i detyronte malësorët të lidheshin me tregun. Nga ana tjetër edhe vetë sistemi shtetgus i blegtorisë nuk lejonte që ato treva të mbeteshin të mbyllura. Por epërsia e rentës në të holla nuk duhet të na çojë në përfundimin se kemi të bëjmë me një etapë zhvillimi më të lartë të marrëdhënieve feudale në krahasim me trevat bujqësore. Përkundrazi në trevat malore mbizotëronte ekonomia natyrore dhe marrëdhëniet feudale ishin shumë më pak të zhvilluara.

Pushtimi osman nuk solli një kthim nga renta në të holla në atë në natyrë. Përkundrazi, sistemi fiskal i vendosur mbi bazën e pronësisë mirie mbi tokën edhe pse e rriti deri në një farë mase vëllimin e mëparshëm të rentës në të holla, prapëseprapë renta në natyrë në pjesën më të madhe të trevave të Shqipërisë Veriore mbeti mbizotëruese.

Tendencat për rritjen e rentës në të holla, të shfaqura si gjatë sundimit venedikas, ashtu edhe atij osman shprehnin faktin se në Shqipërinë e Veriut ekzistonte në shek. XV një ekonomi mjaft e zhvilluar dhe e përparuar, që e bënte të mundur rritjen e kësaj rente dhe të realizueshme tendencën e klasës feudale për të përvetësuar sa më shumë nga mbiprodukti i fshatarit. Ajo tregon gjithashtu se ekonomia monetare kishte pasur një nisim shumë më të hershme nga fillimet e shek. XV dhe se guaska e ekonomisë së mbyllur natyrore ishte çarë shumë kohë më parë.

Gjendja demografike e Shqipërisë së Veriut në shek. XV-XVI, si dhe gjendja ekonomike në fund të shek. XV, që zbulohen në punim, përgënjeshtrojnë dhe rrëzojnë si pa baza shkencore dhe si antishqiptare tezat e autorëve të huaj: A.

Selishev, G. Shtadmyller etj., të cilët, pa u mbështetur në të dhëna dokumentare, primitivizojnë nivelin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit dhe e paraqesin fshatin të paqendrueshëm, me një popullsi endacake baritore të struktur kryesisht si ashkla në zonat e thella malore dhe që në shek. XV e sidomos më vonë nën egidën e osmanëve paska zbritur dhe populluar trojet e veta në viset fushore perëndimore dhe verilindore. Kjo edhe për faktin se siç rezulton nga regjistrat, popullsia e zonave të thella malore ishte aq e paktë sa sikur e tëra të ishte shpërngulur në viset fushore nuk do të ndryshonte thujtë aspak gjendjen demografike, e jo më të përmbyste atë siç pretendohet.

\*  
\*   \*  
\*

Për të hartuar këtë punim kemi shfrytëzuar një bazë të gjerë dokumentare që përbëhet kryesisht nga të dhënat e defterëve kadastralë të shek. XV-XVI siç janë: «Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417», dhe «Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485» dhe ai i vitit 1582.<sup>1</sup> Këto regjistra kanë rëndësi të dorës së parë në trajtimin e problemeve që lidhen me fshatin për arsye se lejojnë të ndjekim nga afër dhe në mënyrë konkrete zhvillimin demografik dhe ekonomik të tij. Edhe pse të hartuar nga administrata të huaja të shteteve push-tuese, ato përbëjnë burime me vlerë të pazëvendësueshme për njohjen «de visu» të fshatit sepse duke u hartuar në terrenin shqiptar mbajnë karakterin e një materiali dokumentar vendas.

Këto burime sjellin të dhëna me interes të veçantë mbi vendbanimet dhe popullsinë e tyre, mbi detyrimet që ata duhej të shlyenin qoftë në natyrë ose në të holla; dhe nëpërmjet këtyre japin një tablo të qartë të kulturave bujqë-

---

1) Defter-i mufassal livâ-i Iskenderiye, ndodhet në: «Tapu ve kadaastro umum müdürlüğünün arsivi», në Ankara (më pas TK.A), defter nr. 59. Kemi përkthimin shqip në dorëshkrim të bërë nga S. Pulaha për- sa i përket vendbanimeve të popullsisë, kurse për- sa i përket ekonomisë nuk e shfrytëzuam sepse S. Pulaha nuk e ka përfunduar përkthimin.

sore dhe të gjendjes së ekonomisë bujqësore dhe blegtorale. Të dhënat e shfrytëzuara janë përgjithësisht të sakta për arsye se lidheshin drejtpërdrejt me vjeljen e rentës dhe shpërndarjen e saj pjesëtarëve të klasës feudale. Por, meqenëse janë dhënë në atë mënyrë dhe në atë formë që u nevojitej nëpunësve të kadastrës për vënien në jetë të pronësisë feudale në këto troje, ato nuk hedhin dritë drejtpërdrejt dhe në mënyrë tërësore mbi gjendjen demografike dhe ekonomike gjatë shek. XV-XVI. Për këtë arsye materialin e kemi përpunuar gjerësisht dhe rezultatet e kësaj pune i kemi parashtruar në punim. Si i tillë ky material burimor dokumentar është më i gjerë dhe më i përpunuar nga ai që kanë përdorur studiuesit e tjerë për çështjet e marra në shqyrtim.

Regjistrat kadastralë mbi të cilët mbështetet punimi përfshijnë një territor mjaft të gjerë. Kadastra venedikase e vitit 1416-17 i përket një zone të ngushtë, vetëm Ultësirës së Shkodrës të pushtuar nga venedikasin, kurse defterët kadastralë osmanë të viteve 1485 dhe 1582 përfshijnë një territor shumë më të gjerë të inkuadruar në një njësi administrative, në sanxhakun e Shkodrës. Në këtë bënin pjesë naijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Këndejmë, të Bregut të Përtejme, të Shestanit, të Merkodit, të Zhabjakut, të Podgoricës, të Kuçit, të Pjetërshpanit (Pulti i sctëm, Shala e Shoshi), të Kelmendit, të Hotit, të Pipërit, të Pejës, të Suhogërlës, të Altun-ilisë (viset e Gjakovës dhe të Tropojës), të Komunitit të Komaranit, të Plavës, të Izlarjekës. Në studim nuk kemi ndjekur si kriter bazë ndarjen administrative (nahijet), por atë të ndarjes së trevave të krejt sanxhakut, në katër zona të mëdha që përbëjnë unitete krahinore më vete siç janë: Ultësira e Shkodrës, Malësia e Shkodrës, Rrafshi i Dukagjinit dhe krahina e Bihorit. Në këtë ndarje kemi pasur parasysh veçoritë e këtyre krahinave në gjendjen ekonomiko-shoqërore, në karakterin e ekonomisë, në pozitën e tyre gjeografike etj

Ultësira e Shkodrës ka në përbërje të saj vendbanime të vendosura kryesisht në një terren fushor, si dhe në territore kodrinore. Këto të fundit ndodhen në më të shumtat e rasteve në periferi të Ultësirës. Malësia e Shkodrës përmban në përgjithësi vendbanime malore, janë pikërisht malësitë që merren më së shumti me blegtori. Rrafshi i Dukagjinit përfshin fshatra të vendosura në një terren të sheshtë. Kjo zonë është një rrafshnaltë me sipërfaqe tokash të mëdha e pjellore

për kultivimin e kulturave të shumëllojshme bujqësore. Ekzistenca e fushave të gjera e të pamasa e bën Rrafshin e Dukagjinit zonën me prodhimtari më të lartë në bujqësi. Krahina e Bihorit karakterizohet nga një terren i thyer malor.

Këto regjistra lejojnë të ndriçohet gjendja demografike në tri momente kryesore, në vitet 1416-1417 për Ultësirën e Shkodrës dhe në vitet 1485 dhe 1582 për krejt krahinat e sanxhakut të Shkodrës duke ndjekur edhe evolucionin që ajo pësoi me zëvendësimin e sundimit venedikas në viset perëndimore, të atij serb në viset veriore e lindore, dhe të atij të feudalëve vendas në disa zona, me sundimin osman në shek. XV. Ato japin mundësi të gjykohet gjithashtu për ndikimin e një vargu faktorësh ekonomiko-shoqërorë e politikë që lindën e vepruan pas pushtimit osman.

Nëpërmjet regjistrave që zotërojmë mund të ndriçohet gjithashtu gjendja ekonomike vetëm për shek. XV, sidomos për fundin e tij, në bazë të regjistrimit të vitit 1485. Nuk mund të ndiqet zhvillimi i ekonomisë fshatare në shek. XVI, ashtu siç u bë për demografinë për shkak se nuk kemi mundësi të shfrytëzojmë pjesët që lidhen me ekonominë në defterin e vitit 1582, meqë ato janë ende të papërkthyer nga gjuha osmane.

Në vlerësimin e të dhënave demografike dhe ekonomike të këtyre burimeve kemi mbajtur parasysh jo vetëm faktorët gjeografikë por edhe ata politikë.

Për shek. XV ne kemi dy regjistra, të cilët i ndajnë vetëm 68 vjet. Është e vërtetë se janë dy regjistrime pak a shumë të afërta në kohë, por ajo çka është e rëndësishme dhe duhet vënë në dukje është se këto kadastra janë hartuar nga pushtues të huaj të ndryshëm: e para nga shteti venedikas dhe e dyta nga ai osman. Edhe pse këto regjistrime janë hartuar njëri pas tjetrit, ato në vetvete përbëjnë burime madhore për njohjen e gjendjes ekonomiko-shoqërore të fshatarësisë nën pushtues të huaj të ndryshëm, atë para dhe pas pushtimit osman. Përmes tyre na jepet një tablo e hollësishme e kushteve në të cilat jetonte fshatarësia shqiptare nën Venedikun e më vonë nën Perandorinë Osmane. Periudha e ndërmjetme midis dy regjistrimeve ngërthen brenda saj ndodhi e ngjarje politike, rrjedhojat e të cilave qoftë edhe në një masë fare të vogël janë pasqyruar në regjistrimet kadastrale. Brenda kësaj periudhe 68-vjeçare janë krijuar situata të tilla politike të cilat në një formë ose në një tjetër

kanë ndikuar edhe mbi vendbanimet. Të kësaj kohe janë dy fushatat e mëdha osmane kundër Shkodrës të cilat do t'i cekim më poshtë. Brenda këtyre viteve kemi edhe kryengritje të fshatarëve të zonës së Shkodrës kundër sundimit venedikas, konflikte të Balshajve me venedikasit, inkursione të herëpashershme të osmanëve para pushtimit të vendit. Sigurisht kalimi nga sundimi venedikas nën atë osman nuk duhet parë thjesht si një ndërrim pushtuesish, pasi vendosja e një pushtuesi të ri nuk ndodh në mënyrë të qetë e të zakonshme, ai është i lidhur me situata të vështira për popullsinë vendase. Banorët e këtyre viseve të cilët kishin mbajtur mbi supë të gjithë peshën e rëndë të shtypjes venedikase, në kushte të tilla të një shfrytëzimi ekonomik, iu desh t'i bënin ballë edhe furisë osmane, kësaj fuqie të madhe të kohës. Dihet se në vitet 1474 dhe 1478 ekspeditat osmane u drejtuan kundër Shkodrës për t'i dhënë kështu goditjen përfundimtare rezistencës shqiptare. Këto ekspedita qenë me pasoja rrënuese e shkatërruese për vendin. Me gjithë mbrojtjen heroike dhe shembujt e lartë të heroizmit të demonstruar në këtë luftë, ku trimat shkodranë po përballonin ushtri të panumërta e të pajisura me teknikën më moderne të kohës duke i sjellë humbje të rënda armikut, qyteti i braktisur nga Venediku më 1479 ra. Në këto momente tepër të vështira e tragjike për fatet e vendit një pjesë e mirë e banorëve u detyruan të lënë Atdheun duke mërguar në Venedik e gjetiu. Nga ana tjetër shumë banorë të fshatrave të shkatërruara u tërhoqën në malësitë. Doemos në këto kushte veprimi i faktorëve politikë ka luajtur një rol të rëndësishëm, natyrisht edhe brenda një periudhe të shkurtër kohe ato kanë lënë gjurmë në gjendjen e vendbanimeve fshatare. Krahas shkaqeve të tjera faktorët politikë janë shkak kryesor i ndryshimeve që konstatoheshin lidhur me vendbanimet duke i studiuar ato në plan krahasues nga regjistrimi venedikas në atë osman.




## KREU I

### VENDBANIMET FSHATARE NË KRAHINAT E SANXHAKUT TË SHKODRËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TYRE NË SHEK. XV-XVI

Në burimet kadastrale të shek. XV-XVI fshati në trevat e Veriut paraqitet si vendbanim i qëndrueshëm, me kufij të përcaktuar, me ekonominë e tij të veçantë. Herë-herë në të përmenden kufijtë e fshatrave ose të tokave e të pyjeve të tyre. Kufijtë ndarës të fshatrave kanë qenë të përcaktuar qartë.<sup>1</sup> Si të tillë shërbenin kryesisht objekte natyrore: male, pyje, lumenj, përrenj, hendeqe, vija uji, rrugë publike etj. Shkeljet e kufijve bëheshin shkak grindjesh gjë që është e dokumentuar shumë më parë se shek XV. Fakti që fshatrat

1) Në kadastrën venedikase fshati Vedolishti i Ultërsirës së Shkodrës, i pabanuar, përbëhej prej 100 arash, prej të cilave 40 ishin tokë buke, kurse pjesa tjetër pyll. Ai kufizohej me fshatrat e Reçit, Projanit, Pulajt dhe Zupanit. Lidhur me fshatin Podgorë; në Kadastër thuhet: «Përreth fshatit të Podgorës është një kullotë e Sinjorisë që quhet Postopoja, kullotë dhe pyll që zgjatet tri mile. Kufiri i saj është Përroi i Thatë». Toka e quajtur Zutëri (Çutëri), lëshuar Nikolla Hotit, kufizohej nga njëri kah me male, kurse nga krahu tjetër me lumin e Slikcës. I. Zamputi. Kadastra e Shkodrës, fl. 108/b, 149/b, 62/b.



në fillim të shek. XV paraqiten me kufijtë dhe emërtimet e tyre, me kryefamiljarët dhe detyrimet përkatëse të përcaktuara ab antiquo dëshmon që në vështrim të parë dhe në mënyrë të qartë për fshatra të ngulitura kohë më parë, të cilat pushtuesi venedikas i gjeti dhe i regjistroi sipas pozitës gjeografike, shtrirjes, sipas afërsisë dhe fqinjësisë që kishin në lidhje me njëri-tjetrin. Fshati kishte një bazë të qëndrueshme ekonomike, që përbëhej nga toka të punueshme, djerrina, livadhe, pyje, të cilat u duheshin banorëve për të plotësuar nevojat e jetesës dhe për të shlyer detyrimet ndaj kryezotit feudal.

Dokumentacioni i fillimit të shek. XV na njeh me detyrimet tradicionale që i shlyenin fshatarët e zonës së Shkodrës Sinjorisë së Venedikut si pronare supreme e tokës, si dhe me ndryshimet e bëra në sistemin e detyrimeve. Fillimisht fshatarësia i shlyente shtetit detyrimet në sistemin e së dhjetës, ndërsa më vonë sipas një sistemi fikso, në bazë të të cilit përgjithësisht çdo shtëpi shlyente 1 dukat flori, 1 mod drithë, obrokun në masën 4 groshë dhe të dhjetën e melit. Fakti që familjet në pjesën dërrmuese shlyenin detyrimin e 1 modi drithë dëshmon në mënyrë të pakundërshtueshme se këto vendbanime ishin të ngulitura e të stabilizuara me kohë sepse garantonin pa vështirësi pagimin normal të detyrimeve në prodhime bujqësore, se popullsia vendase ishte një popullsi me tradita në kultivimin e drithërave.

Regjistrat kadastralë të shek. XV na njohin së afërmi me kulturat bujqësore që kultivoheshin. Lista e gjatë e detyrimeve që banorët vendas i shlyenin pushtuesit të huaj — siç del nga regjistri osman i vitit 1485. zë fill me taksën e grurit e pastaj vazhdon me drithërat e tjera si thekra, elbi, meli, ujemi etj. Fshatrat, që kultivonin rrushin, paguanin në prodhime të vreshtarisë. Gjithashtu paguanin edhe detyrime për perimet si qepë, spinaq, bathë, bishtajore, etj., për frutat si kumbulla, arra, gështenja, qershi, dardhë, mollë etj.

Në territorin e fshatit bënte pjesë edhe pylli. Ai herë del i dokumentuar drejtpërdrejt dhe herë nënkuptohet nga taksa e drurëve<sup>1</sup> që paguante fshati. Kështu banorët e Kalldrunit,<sup>2</sup> ishin të detyruar të prisnin dërrasa dhe çdo dru tjetër për Sinjorinë.

1) S. Pulaha, *Regjistri 1485*, fl. 1, 2, 3, 4, 5, 6...

2) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 39/ab.

Krahas ekonomisë bujqësore me ara, kopshte, vreshta pasqyrohet deri në një farë mase edhe ekonomia blegtorale që del në livadhet, me taksën e barit,<sup>1</sup> me bidatin e derrave, me taksën e dhenve etj.

Krahas së përbashkëtës, bujqësisë dhe blegtorisë, dalin edhe një varg fshatrash me detyrime specifike. Defteri i regjistrimit të vitit 1485 dëshmon se sasia dhe lloji i detyrimeve që shlyente njëri fshat ndryshonte nga ajo e tjetrit. Kjo varej nga terreni i fshatit (fushor, kodrinor apo malor), nga madhësia e tij, nga dendësia e popullsisë, nga specializimi i tij në kultura të veçanta etj. Pavarësisht nga sasitë e ndryshme të prodhimeve bujqësore që nxirreshin nga vendbanime të veçanta, dokumentacioni dëshmon se fshatarët i siguronin në vend burimet ekonomike për jetesën e tyre dhe, në të njëjtën kohë, për të shlyer detyrimet feudale.

Që problemi i qëndrueshmërisë së vendbanimeve fshatare në Shqipërinë e Veriut të kuptohet e të interpretohet drejt, është e domosdoshme të kihet parasysh situatat politike nëpër të cilat kaloi vendi ynë në shek. XV. Vendbanimet fshatare nuk mund të studiohen të dhëna një herë e përgjithmonë, sepse mbi to vepruan faktorë politikë, ekonomikë e shoqërorë të cilët e penguan ose e shpejtuan ecurinë e zhvillimit normal të tyre.

Periodha e ndërmjetme midis dy regjistrimeve, atij venedikas (1417) dhe osman (1485), ngërthen brenda saj ndodhi e ngjarje politike, rrjedhojat e të cilave janë pasqyruar në regjistrimet kadastrale. Brenda kësaj periudhe 68-vjeçare janë krijuar situata të tilla politike, të cilat kanë influencuar në një formë ose në një tjetër edhe mbi vendbanimet fshatare të Shqipërisë së Veriut. Brenda këtyre viteve janë zhvilluar kryengritje të fshatarëve të zonës së Shkodrës kundër sundimit venedikas, konflikte të Balshajve me venedikasit, inkursione të herëpashershme të osmanëve para pushtimit të vendit.

Kalimi nga sundimi venedikas nën sundimin osman nuk ishte thjesht një ndërrim pushtuesish, pasi vendosja e pushtuesit të ri nuk ndodhi në mënyrë të qetë. Banorëve të këtyre viseve të cilët kishin mbajtur mbi supe të gjithë peshën e rëndë të shtypjes e të shfrytëzimit ekonomik venedikas, iu

---

1) S. Pulaha. *Regjistri 1485*, fl. 1, 2, 3, 4, 5, 6...

desh t'i bënin ballë edhe furisë osmane, fuqisë më të madhe e më të egër të kohës. Dihet se në vitet 1474 dhe 1478 fu-shatat e mëdha osmane u drejtuan kundër Shkodrës për t'i dhënë goditjen përfundimtare rezistencës shqiptare. Është e kuptueshme se këto ekspedita, siç i paraqet Barleti, kishin qenë me pasoja rrënuese e shkatërruese për vendin tonë. Me gjithë mbrojtjen heroike të trimave shkodranë, që përballuan për një kohë të gjatë ushtri të panumërta e të pajisura me teknikën më moderne të kohës, Shkodra e braktisur nga Venediku më 1479, ra. Në këto momente tepër të vështira e tragjike për fatet e vendit një pjesë e mirë e banorëve u detyruan të lenë Atdheun duke mërguar në Venedik, në Pulje e gjetiu. Nga ana tjetër shumë banorë të fshatrave të shkatërruara u tërhoqën në malësitë. Domosdo në këto kushte veprimi i faktorëve politikë kishte qenë i fuqishëm dhe kishte lënë gjurmë në gjendjen e vendbanimeve shqiptare. Ndikimi i këtyre faktorëve ishte shumë i dobët në trevat e tjera të sanxhakut si në Rrafshin e Dukagjinit, në krahinën e Bihorit. në malësitë e Shkodrës, të cilat nuk kishin qenë fusha betejash të mëdha gjatë realizimit të pushtimit osman.

Faktorët politikë përbëjnë shkakun kryesor për të shpjeguar ndryshimet që konstatohen lidhur me vendbanimet në Ultërsirën e Shkodrës po t'i vështrojmë ato në plan krahasues nga regjistrimi venedikas (1417) në atë osman (1485). Le ta shqyrtojmë këtë çështje nëpërmjet materialit konkret të Kadastrës së Shkodrës të viteve 1416-1417 dhe të Defterit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485.

Në regjistrimin venedikas të Shkodrës janë përfshirë 116 fshatra. Nga këto dëshmohen në regjistrimin osman të vitit 1485, 79 fshatra, ndërsa të tjerët nuk përmenden.

Për ta ndjekur problemin më në thellësi dhe më në detaj, zonën e Shkodrës për qëllime studimi e marrim në dy nëndarjet e saj, Mbishkodër dhe Nënshkodër, nëndarje të cilat ekzistojnë edhe sot në përputhje me gjendjen ekonomike dhe gjeografike.<sup>1</sup>

---

1) Mbishkodra e vitit 1417 përfshin trevën çka merr prej vijëndarjes së viseve të Postripës, d.m.th. mbarë Rranxat e Mbishkodrës afër Mesit (në atë kohë nuk hynte në Postripë, ndoshta duhet të ketë një vendosje tjetër sepse në kadastër e kemi të vendosur në Nënshko-

Sipas Kadastrës venedikase. Mbishkodra kishte 42 fshatra, nga të cilat në regjistrimin osman të vitit 1485 dalin 26.<sup>1</sup> Pra, kanë ruajtur vazhdimësinë 61.9 për qind e tyre. Këto fshatra e ruanin ekzistencën edhe në vitin 1582 me përjashtim

dër), dhe ndjek vijën e kontraforteve të vargmaleve veriore pak a shumë deri në Liqenin e Hotit me pikat më të larta Qafëgratin, Rrjoilin, Gjamaratin, për të datë deri në Budishë, Pujicë dhe Kurte. Në Nënshkodër, kjo vijë ndjek bregun e majtë të Bunës, të njohura në çdo kohë si vise të pasura bujqësore, përfshin Rranxat e Bushatit të sotëm, për t'u hapur më tutje në Barbullush, Kakarriq, dhe Balldre, duke përfshirë të gjithë luginën që sajón Këneta e Kakarriqit ose e Balldrenit me krejt sistemin e Maleve të Shëngjinit (Medoa më 1417, Mjet më 1485) për t'u kthyer drejt veriut, gjatë bregut të Drinit deri në Vaun e Dejës. K. Luka. *Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës të shek. XV*: «Studime filologjike», nr. 1, 1976. f. 141.

1) Këto janë: Bisht-Riola, Dobri, Shën-Ivrash, Kadrun, Tuz, Lugji ose Podol Tuz, Gradec-Tuz, Sokiovinë ose Shukovik-Tuz, Koplik, Kuruemira, Podgora, Egjirish ose Igrish, Bratoran, Lushta, Zhajna, Marin, Shkripol (Shkriil, Ishkriil), Puleç, Marshejn, Luk (Lok), Rijol, Baren (Balce), Braça Lepurosh, Grizha dhe Dobranica. Në kadastrën venedikase dokumentohet fshati i Tuzit nga i cili varen dy fshatra: i Lugjit dhe i Gradecit. Ky fshat kishte edhe tokën e quajtur Stoiçi, pjesërisht e lërueshme, pyll e kullotë prej rreth një miu arash; tokën e quajtur Vira, pjesërisht e lërueshme, pyll e kullotë prej rreth dyzet arash, tokën e quajtur Kamenica, pjesërisht e lërueshme, pyll e kullotë, prej rreth 300 arash, tokën e quajtur Sokiovinë që gjendej në përkatësinë e fshatit Kalldrun, prej rreth 40 arash. Këto toka më 1485 në defterin osman, dalin si fshatra më vete me numër të caktuar shtëpish: Podol-Tuz me 14 shtëpi e 2 beqarë, Gradec-Tuz me 32 shtëpi, Istulush-Tuz me 30 shtëpi, Bgur-Tuz me 43 shtëpi dhe 3 beqarë, Damnic-Tuz me 47 shtëpi dhe Shukovik-Tuz me 4 shtëpi. Më 1485 kemi edhe fshatra të rinj si Petrashani-Tuz e Kuqih-Tuz si dhe fshatrat e braktisur Pistull-Tuz dhe tokën Gjon-Tuz, të cilat nuk përmenden në Kadastrën venedikase. Pavarësisht nga këto kriime të reja duhet vënë në dukje se edhe më 1417 Tuzi ishte një fshat i madh, me 150 shtëpi. Fshatra kemi konsideruar në vitin 1417 edhe Lugjin (Podol-Tuz) dhe Gradecin, meqenëse në kadastër cilësohen të tillë, ndonëse për to nuk janë regjistruar shtëpitë veças. Mundet të jenë përfshirë në sasinë e shtëpive të fshatit Tuz, me që vareshin prej tij: Shih S. Pulaha. *Kontribut për studimin e ngulitjes së katuneve dhe krijimin e fiseve në Shqipërinë e Veriut në shek. XV-XVI*; në: «Studime historike», 1975/1.

të Bisht Rjolës, Lukut (Lok) dhe Barenit. Nga vendbanimet e vitit 1417 nuk dalin në defterin osman të vitit 1485 fshatrat.<sup>1)</sup> Ka raste që ndonjë fshat që më 1417 ekzistonte më vete, më 1485 nuk dëshmohet si i tillë, por ka hyrë në përbërjen e ndonjë fshati tjetër, siç është p.sh. rasti i Kereçit i përfshirë në fshatin Grizhë. Përveç këtyre fshatrave që nuk ruajtën ekzistencën më 1485, vërehet edhe fenomeni i anasjelltë, krijimi i fshatrave të reja, të cilat nuk janë regjistruar në Kadastrën venedikase të vitit 1417.<sup>2</sup> Defteri osman na njeh edhe me truallishte (mezra), fshatra të braktitura si Radina, Gjon-Tuz, Pistull-Tuz, Grili, Bjeli Brod, të cilat nuk përmenden në kadastrën e vitit 1417.

Nënshkodra në vitin 1417 përfshinte 74 fshatra; 33 prej tyre dalin më 1485, pra, vazhdojnë ekzistencën në masën 44,6 për qind.<sup>3</sup> Përveç këtyre kishte edhe 41 fshatra që ishin braktisur si vendbanime. Prej tyre 14 përmenden si truallishte,<sup>4</sup> kurse 27 të tjera nuk përmenden fare në regjistrimin e

---

1) Këto janë: Okseti, Majora, Faralini apo Karokjeta, Sordani, Rastjeni apo Bodisha, Kadikani, Bardhi i Mbishkodrës, Bolca, Repishti, Keqoli, Kuçi, Dari, Gjaramati, Kereçi, Bulsari, Gruemira e Vogël.

2) Këto janë: Kurta, Petroshani-Tuz, Kuçik-Tuz, Shend Bifshi, Reçi, Mosil, Voroniça e Sipërme dhe Voroniça e Poshtme, Gruda, Rashi, Xhovan, Stres, Gradisaliq, Rasha, Dragovol, Balozi. Shënt Bifsh lidhet me Figara të Kadastrës venedikase, shih: K. Luka. *Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës të shek. XV*. në: «St. filologjike», 1976/2, f. 151. Më 1417 Figara ekziston vetëm si toponim.

3) Fshatra që ruajnë vijueshmërinë dhe që dëshmohen në defterin osman janë: Prekali, Kryethiu, Perlat ose Bardani. Mesi, Kusmaç, Selita, Maliç, Romeshtina (Gastoli dhe Misgoj), Gjerc, Shgul, Pulic, Barbullush, Postërpat, Kukla, Melsha barz, Kakarriq, Borom, Daraglat. Shën Shirgj. Mushani, Gramshi, Dajçi, Samirish dhe Samarish, Pelani. Pendërtari, Kiryq (Kiroq), Buvarza, Loros, Reçi, Pulani, Bardon, Turmshi i Poshtëm, Turmshi i Epërm.

4) Këto janë: Prekal, Gurizi, Mgaxhapur; Gjervos (Gjeruos), Bulkija, Symizë, Rashi në Malet Mjet Idvalmi, Dobranica, Gunësi, Rushkull, Ish-tira, Prekali në mal, Kakarriq-Tuz, Mandros.

vitit 1485.<sup>1</sup> Dokumentohen edhe fshatra të reja që dalin për të parën herë në defterin osman të vitit 1485.<sup>2</sup>

Vendbanimet e zonës së Shkodrës të marra në tërësi, pra me Mbishkodrën dhe Nënshkodrën e ruajtën vijueshmërinë e tyre në masën 50.9 për qind (59 fshatra nga 116 fshatrat gjithsej). Në përgjithësi fshatrat e përmendura në vitin 1485 e vazhduan jetën edhe në shekullin pasardhës. Me stabilizimin deri në një farë mase të situatës sipas regjistrimit të vitit 1582 konstatohet se nga 116 fshatrat e regjistruara në vitin 1417 ruajtën vijueshmërinë 73. d.m.th. 67.2 për qind e tyre, pa përfshirë këtu vendbanimet e krijuara rishtaz. Pra, kemi të dokumentuara një numër më të madh vendbanimesh në krahasim me pothuaj një shekull më parë (1485).

Vijueshmëria e vendbanimeve të Mbishkodrës e Nënshkodrës gjatë një periudhe gati dyshekullore, mosekzistenca në defterin osman e disa fshatrave që përmendeshin në Kadastrën venedikase dhe dalja e fshatrave të reja, formimi rishtaz i fshatrave më vete nga tokat e përfshira më parë në kuadrin e një fshati apo kalimi i një fshati në përbërjen e një tjetri, duke mos ekzistuar më ai fshat më vete si dhe zgjerimi me kalimin e kohës i një fshati në dy etj.. të gjitha këto dukuri flasin për dinamikën e zhvillimit të vendbanimeve. Ekzistenca e fenomeneve të tilla tregon se vendbanimet ishin zhvilluar duke ndjekur në përgjithësi, një vijë ngjitëse, ndonëse jo gjithnjë në vijë të drejtë. Nën veprimin e faktorëve ekonomik-shoqërorë e politikë vendbanimet nuk mund të ecnin në rrugë të njëtrajtshme zhvillimi. Veprimi i këtyre faktorëve herë ka frenuar dhe herë ka nxituar zhvillimin e tyre.

Fshatrat që vazhduan jetën e tyre në periudhën nga 1417 deri më 1485, përgjithësisht mbetën si vendbanime edhe pas një shekulli në 1582. Në Mbishkodër nga 26 fshatra

---

1) Këto janë: Guri i zi i Dabasej Bonçit, Vladami, Martani, Lubani, Vulkatani, Spatari, Turki, Dardha, Beltoja, Zamorani, Qimekeqi, Sigjeçi, Dozani, Trompsisi i Vukut, Luorsi, Teklani, Shënkolli i Kakarriqit apo Blinishti, Baladrini, Saraçinopoli, Bassi, Zupani, Gazoli, Serelji, Baksi, Gaduçi, Progjani e Stikjani, Kruetim apo Frankesi.

2) Këto janë: Shënmri Megalen Mglush, Kuçi, Buzogjatja, Gjondra, Karpent, Mazarak dhe Irmal.

vazhduan jetën 22 fshatra,<sup>1</sup> kurse 4 fshatra nuk përmenden më në regjistrimin e vitit 1582.<sup>2</sup> Në Nënshkodër nga 33 fshatra 30 fshatra,<sup>3</sup> ndërsa 3 të tjerat nuk përmenden në kadastrën e vitit 1582<sup>4</sup>. Për gjithë trevën e Shkodrës nga 59 fshatrat që dalin më 1417 dhe 1485, 52 fshatra vazhduan jetën edhe në intervalin nga 1485 deri 1582, pra 89.7 për qind e tyre, dëshmi kjo për stabilitetin e vendbanimeve.

Gjatë shek. XVI fshati eci në rrugën e zhvillimit në mënyrë më normale se gjatë periudhës së luftërave të shek. XV. Ai së pari e rimori veten me ripërtëritje të një vargu vendbanimesh që përmenden më 1417, por që ishin zhdukur më 1485. Kështu rifilluan jetën më 1582, pas më shumë se 150 vjetësh 26 fshatra të tilla (6 në Mbishkodrën, 20 në Nënshkodrën).<sup>5</sup>

Nga 116 fshatrat që përmendëm në fillim të shekullit XV, në fund të shek. XVI e kishin vazhduar jetën 78 fshatra, d.m.th. 67.2 për qind e tyre. Nga fshatrat e regjistruara më 1416 nuk përmenden më 1582, 38 fshatra, gjë që le të mendohet se ato nuk e kanë vazhduar jetën.<sup>6</sup> Mendojmë se numri

---

1) Këto janë: Dobrea (Dobri), Shën Auracio (Shënd Ivraşh), Kalderon (Kalldrun), Tuz, Gradec-Tuz, Lugji (Podol-Tuz), Koplík, Gruemira, Dobraçi, Podgora, Egci (Egrişh, Içrişh), Liusta (Lushta), Zanjeva (Zhajna), Laol ose David, Shkrel (Shkripol), Polica e Shkurti (Puleç), Mar-sen (Marshenj), Logoa (Luk, Lok), Rrjolli, Braça, Lepurosh, Grizha.

2) Këto janë: Bishtrjolla, Sokjovina (Shukoviq-Tuz), Vajushi (Bartoran) Baleci.

3) Këto janë fshatrat: Prekali, Kryethiu, Perlat ose Bardani, Mesi, Kusmaçi, Selita, Mali i Larit (Maliç), Gostoli e Misgonj (Romeshtina), Engjekjani (Gjerxh), Shakull (Shgul), Andrea Skiavo (Puliç), Posterpat, Kukla, Kakarriq, Reçlati (Daraglati), Shënshingji, Musanthi, Gramshi, Dajçi, Samrişh, Belani (Pelani), Pendëtari, Kirruq (Kirroq), Buzëzezi (Buzarza), Luarizi (Loros), Reçi, Pulani, Bardhi në Velipojë (Bardon), Trushi i Madh Trushi i Poshtëm.

4) Fshatrat Barbullush, Mensabardhi e Bromi (në Mede).

5) Këto janë: Rastjeni, Bardiza-Bardhi, Repishti, Kuçi, Zakoli, Gruemira, Guri i Zi i Rajko Prekalit, Lubani, Vukatana, Spathari, Turki, Dardha, Beltoja, Xamarani (Xhimaran), Somesi (Symiza), Sigeci, Trushi i Vogël i Vukut, Blinishtit ose Shënkollit, Baladrini (Balldreni), Rensi, Rushkull Stira (Shtira), Serelji, Prekali në Mal, Tushani i Vogël në Shkallë (Kakarriq Duz), Kryetim.

6) Këto janë: Okseti, Majora, Karokjeta ose Faralini, Sordani nën



i këtyre duhet të jetë më i vogël, sepse zona e Medues (Shëngjinit) nuk gjendet e përfshirë në dofterin e vitit 1582 dhe, rrjedhimisht, për disa fshatra të saj, që përmenden më 1416, nuk mund të thuhet nëse e vazhduan ose jo jetën e tyre. Po kështu është e vështirë të arrihet në një unifikim të plotë të fshatrave të regjistruar më 1416 me ato të regjistruara më 1582.

Dëshmi tjetër e zhvillimit normal të fshatit është fakti se ai, sipas të dhënave të dofterit të vitit 1582, pësoi një rritje të ndjeshme me krijimin edhe të vendbanimeve të reja që nuk dalin në regjistrimin e 1485.<sup>1</sup>

Po kështu ripërtëritja në vitin 1582 e një numri fshatash që dokumentohen në regjistrimin e vitit 1417, e që u gjetën të shpopulluara në fillimet e vendosjes së pushtimit osman, siç vërteton regjistri i vitit 1485, përbën një dëshmi të fortë për forcën e qëndrueshmërisë së vendbanimeve fshatare në këtë zonë. Fshatrat edhe pse në rrugën e tyre të zhvillimit hasin pengesa e vështirësi që e ngadalësuan këtë

---

Podgorë Kadikami, Bolca (Bolsa), Keqoli nën Bolc, Dari nën Balëzë, Zameraki nën Balezë, Kereçi nën Balëzë, Bulsari nën Grizhë, Guri i Zi i Dabsej Boncit, Vladami, Martani, Kacapur (Mgaxhapur), Gleros, Bulkija e Madhe, Dozani, Luorsi, Teklani, Saracinopoli në Mede, Valmi në Mede, Dobrançi në Mede, Gunesi në Mede, Bassi në Semrish, Zupani, Gazoli, Baksi, Gaduci, Progjani e Stikjani, Mandroshti në Mede. Këtyre duhet t'u shtohen edhe 8 fshatrat e përmendura pak më lart, të cilat ndonëse vazhduan jetën më 1416 '17 dhe 1485 nuk dalin në regjistrimin e vitit 1582).

1) Të tillë janë Hoshkdem, Musellem, Gjirkoviça, Kondina, Mes Kosmaç, Isperdod, Obod, Hajken, Andrea Bgur Tuz, Tikosav, Policani, Rogam, Dushan, Bobonja Ivraça, Ishtul ose Dragush, Rrjeça, Zir, Shucunia, Gjiç Marin Tuzi, Dragush, Monita, Poshtërpola, Cuan (Coran), Kakarriq, Renësi, Ganjolla, Berdica, Kastirat (4 fshatrat e fundit përmenden si troje ose toka në kadastrën venedikase të vitit 1416 '17). Në zonën e regjistruar më 1416 nga venedikasit, përveç këtyre 29 vendbanimeve të reja, kishte edhe një varg vendbanimesh të tjera që dalin për herë të parë më 1485 dhe nuk përmenden në regjistrimin e 1417. Si total numri i fshatrave për Ultësirën e Shkodrës më 1582 (vetëm për nahijet e Shkodrës, Drishtit, Bregut të Këndejmë e Bregut të Përtejme që përputheshin përafërsisht me zonën e regjistruar nga venedikasit), arriti 222.

zhvillim në momente të caktuara. ato nuk e ndërprejnë jetën e tyre.

Faktorët politikë, goditën sidomos Nënshkodrën. Le të shohim këtë nëpërmjet shifrave. Siç del nga të dhënat e regjistrave, ajo në vitin 1417 kishte 1087 shtëpi,<sup>1</sup> kurse në vitin 1485 kishte 321 shtëpi dhe 18 beqarë. Pra, pas pushtimit osman kishte më pak se 1/3 e popullsisë së mëparshme. Vetë pozita gjeografike e saj, si zonë e ulët bregdetare me kushte më pak të favorshme për t'u mbrojtur nga armiqtë dhe në të njëjtën kohë arenë e luftimeve me forcat osmane, bëri që një pjesë e mirë e popullsisë të tërhiqet në zonat më në veri, në Mbishkodër. Mbishkodra në vitin 1417 kishte 597 shtëpi,<sup>2</sup> kurse më 1485 kishte 1904 shtëpi dhe 131 beqarë. Pra, brenda një periudhe të shkurtër ajo pothuajse e dyfishon numrin e shtëpive. Një rritje e tillë nuk lidhet vetëm me shtimin natyror të popullsisë për një kohë prej 68 vjetësh, por kryesisht me lëvizjen e banorëve nga Nënshkodra në Mbishkodër. E marrë në tërësi Shkodra në vitin 1417 kishte 1684 shtëpi, kurse më 1485 kishte 1325 shtëpi dhe 149 beqarë, gjë që dëshmon për një pakësim të numrit të banorëve për

Fshatrat	Sasia e shtëpive	
	1417	1485
Kryethi	10	3
Shakull-Shgul	24	1
Somes-Symizë	19	—
Barbullush	50	14
Pastërpat	19	3
Kukël	24	2
Mensabardh-Melsha barz	14	4
Shirgj	48	14
Dajç	18	5
Trush i madh — Trush i epërm	67	11

1) K. Luka. *Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës të shek. XV*, në: «Studime filologjike», 1976/2, f. 170.

2) *Po aty*, f. 170.

shkak të pushtimit osman. Për ta argumentuar këtë mendim le t'i referohemi materialit konkret për fshatrat. popullsia e të cilëve ishte pakësuar.

Pas një shekulli nën sundimin osman popullsia e zonës së Shkodrës ishte shtuar: më 1582 popullsia e krishterë kishte 5957 shtëpi dhe 1077 beqarë, popullsia myslimane 1656 shtëpi, 323 beqarë dhe 197 familje myslimane pa tokë.<sup>1</sup> Le të përmendim disa shembuj konkretë që e demonstrojnë në mënyrë të dukshme këtë fenomen.

Fshatrat	Sasia e shtëpive		
	1417	1485	1582
Shirgji	48	14	71
Kopliku	39	70	269
Kastrati	7	—	68
Vukatana	7	—	40
Lubani	14	—	63
Samrishi	49	7	68
Dajçi	18	5	77
Gruemira	20	16	35
Kukla	24	2	57
Dardha	3	—	13
Pulani	9	7	19
Kakarriqi	11	8	16

1) Shifra për sasinë e shtëpive që nxirret nga kadastra venedikase nuk duhet marrë krejtësisht e saktë, sepse kadastra ka mangësi. P.sh. ka fshatra për të cilat nuk është shënuar sasia e shtëpive, këto i kemi llogaritur në bazë të detyrimeve që paguanin, si nër Bulkijen e Madhe (fl. 83/a), Bassin (fl. 99/a) etj. Në regjistër nuk figurojnë familjet shumë të varfra pa tokë që janë të përjashtuara nga detyrimet ose familjet që janë të vendosura në parasporët e feudalëve në afërsi të Shkodrës, ose ato të fshatrave me detyrime fikse që nuk numërojnë shtëpitë dhe detyrimet si Gramshi (fl. 97/a), Mushani (fl. 97/a) Beltoja (fl. 79/b) etj. Këto raste zenë një përqindje fare të vogël në kuadrin e kadastrës.

Këto të dhëna dëshmojnë se tashmë popullsia ishte shtuar.<sup>1</sup>

\*  
\*   \*  
\*

Ndryshe nga zona e Shkodrës, për një pjesë të mirë të së cilës kemi material më të gjerë dokumentar për tre momentet si ato të viteve 1417, 1485 e 1582, për viset e tjera të përfshira gjatë periudhës së sundimit osman në sanxhakun e Shkodrës kemi një material më të kufizuar nga ana kohësore, vetëm nga regjistrat osmanë të viteve 1485 e 1582. Për këto zona mungojnë regjistrime kadastrale për periudhën para pushtimit osman. Më poshtë po shqyrtojmë gjendjen e fshatit në viset në fjalë.

Defteri i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 ka regjistruar gjithsej 558 fshatra në Ultësirën e Shkodrës, në Malësinë e Shkodrës, në Rrafshin e Dukagjinit (një pjesë) dhe në krahinën e Bihorit. Ultësira e Shkodrës përfshinte: nahijen e Shkodrës, të Bregut të Këndejmë, të Bregut të Përteimë dhe të Drishtit, të Shestanit, krahinën e Anamalit, të Merkodit të Krajës, të Zhabjakut, të Podgoricës. Ajo kishte gjithsej 142 fshatra. Malësia e Shkodrës me nahijet e Kucit, të Petrishpanit, të Kelmendit, të Hotit, të Piprit, të Bielopavliqit kishte gjithsej 67 fshatra. Pjesa e Rrafshit të Dukagjinit, e përbërë nga nahijet e Pejës, të Suhogërlës, të Altun-ilisë, kishte gjithsej 275 fshatra. Krahina e Bihorit me nahijet e Komninit, të Komaranit, të Plavës e të Izla Rjekës kishte gjithsej 74 fshatra.<sup>2</sup>

---

Pra shifra e dhënë nuk përfaqëson numrin e shtëpive në realitet, ajo duhej të ishte diçka më e madhe. Të meta të kësaj natyre nuk vërehen në regjistrimet osmane, hartuesit e të cilëve me sa duket kanë qenë më të rregullt, sepse kanë regjistruar një për një të gjitha shtëpitë. Për pasojë edhe shifra që paraqet se sa ishte pakësuar numri i shtëpive duke kaluar nga regjistri para osman në atë osman do të ishte më e vogël nga sa na rezulton, në rast se Kadastra venedikase nuk do të kishte ato mangësi.

1) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 83/a.

2) Për të qenë më të saktë duhet të themi se për Ultësirën e Shkodrës dhe në mënyrë të veçantë për nahijet e Merkodit dhe të Krajës

Duke kaluar nga fundi i shek. XV në fundin e shek. XVI numri i vendbanimeve ka ardhur duke u rritur. Kështu ndërsa në defterin osman të vitit 1485 regjistroheshin 558 fshatra, në atë të vitit 1582 regjistroheshin 745 fshatra. Pra dalin 187 vendbanime më shumë në krahasim me një shekull më parë. Ultësira e Shkodrës, sipas defterit të vitit 1485, regjistronte 142 fshatra, kurse në vitin 1582 po për këtë zonë dokumentohen 268 fshatra. Pra, kemi një rritje prej 126 vendbanimesh, baras me 47 për qind.

Gjendjen e shumicës së këtyre fshatrave e paraqitëm në analizën e mësipërme, por meqenëse zona e regjistruar në kadastrën venedikase të viteve 1416-17 është më e ngushtë nga zonat e regjistruara në defterët osmanë për Ultësirën e Shkodrës, gjenden në këto të fundit edhe vendbanime të papërfshira në Kadastrën venedikase të cilët e vazhduan jetën edhe për periudhën 1485-1582.<sup>1</sup>

Malësia e Shkodrës në vitin 1485 kishte gjithsej 67 vendbanime, ndërsa pas një shekulli numri i tyre rritet edhe arrin në 81, domethënë shtohen 14 vendbanime ose 17.3 për qind e tyre.<sup>2</sup> E vazhduan jetën 85 për qind e vendbanimeve (57 fshatra) nga viti 1485 në vitin 1582.<sup>3</sup>

nuk janë regjistruar në defter fshatrat, ato do të dalin më vonë në regjistrimin osman të vitit 1582. Ndërsa lidhur me Malësinë e Shkodrës u kufizua vetëm me nahijen e Piprit të vitit 1497 pa zënë në gojë nahijen e Piprit të vitit 1485. Këto të dhëna na krijojnë një tablo për vendbanimet e sanxhakut të Shkodrës në fundin e shek. XV.

1) Këto janë: Shkodra, Petrashani-Tuz, Irmal, Kurta, Gruda, Kuçik-Tuz, Gjon-Tuz, Rashë, Bujuk Veroniça, Karpni, Buzëgjarpni, Pistull-Tuz, Nikshiq, Dragovojë, Shëngjin ose Rash, Kuçuk Veroniça, Pleshta, Gradsklad (Gradisaliq), Egjriş Patorad ose Batorad, Mengusha, Luk ose Kurtja, Drishti, Mazarak, Vilza, Koprijova, Ifshas, Shënkollë, Muriçani, Vidhigar, Kalza, Dramosh, Valëza, Podgorica, Grila, Grudë, Goriçan, Tuza, Dajbada, Islanica, Varoshi i kalasë së Medunit, Kurilo, Goshtil, Plavniça, Krapzha, Golobovca, Mërtish.

2) Në krahasim nuk kemi përfshirë fshatrat e nahijes së Ivrazhagrecit, e cila nuk përfshihet si zonë në regjistrimin e vitit 1485.

3) Këto janë: Lubiçe, Mihal, Geg, Pobrezhan, Bozhan, Tihomir, Trabolín, Diragiça, Martiniq, Pariq, Kolashin, Dobrapola, Virala, Vojniq, Fhonoviç, Dobrova, Çenica, Mirka, Bukmir; Recica, Bushad, Istrahaliq, Selça, Ishpaja, Ljeshoviç, Bythadosa, Bankeq, Bardiq, Radon, Lazarniçi, Brokina, Ljepofc, Mavriq, Zhozh, Klir, Pulic, Brisa, Blaka,

Pjesa e Rrafshit të Dukagjinit me nahijet e Suhogërlës, të Pejës dhe të Altun-ilisë në defterin osman të vitit 1485 regjistronte 275 vendbanime, ndërsa në vitin 1582 kishte 294 vendbanime. Pra shtohen vetëm 19 fshatra, domethënë 6.5 për qind e vendbanimeve. E vazhduan jetën më 1582 219 fshatra, d.m.th. 79 për qind e vendbanimeve.<sup>1</sup>

Torna, Brashta, Radina, Palça, Hrasta, Greva, Salça, Dotlana, Xhovan, Shëndëlli, Bop, Planda, Mula (Mola), Shosh, Shalë, Voneshta, Erdol, Nikijt, Këmdaç.

1) Këto janë: Osak (Usak), Slojani, Kramor, Peja, Bjelopolje, Buzrek, Poçoç, Ljepovaç, Traka Gjin, Gjorgjovik, Istudenica, Radoçiq, Paluva, Bana (Banja), Kush (Kosh), Todoricoçi, Klinac, Gorna Dren, Suhogërlla, Isteniq, Lukavac, Jagodina, Kavalenica, Oprashko, Vokshiq, Çernila, Çerkova, Vardishta, Nenadenec, Susiça, Mojster, Niça, Gorazhdefiq, Poçoshta, Beliça, Kirminça, Gorna Beliça, Streleç, Luboliq, Milgjani, Gorna, Leoçina, Çirun brek, Zahaq, Gorna Luka, Podi Saliç, Romaniça, Muzhevenja, Sredna Çirna Goi, Bjelopolja e vogël, Shaboka, Shabiti, Rodinova, Dolina Belica, Izbiça, Istok, Çërkolaç, Ishtubil, Kosturic, Gorna Jablanica, Leskofiq, Dolina Prekala ose Zahaç, Gorna Prekala ose Dujak, Shiboviq, Brestoviq, Klina, Dolina Joshanica, Deçani, Drovadil, Dolina Barani, Lutoglava, Luzhiça, Lipa, Nivokas, Lugjani, Radosha, Drenofic, Dolina Krusheva, Novasel, Çernica, Çirni, Luka Buzreq, Çirni Luka Kuçuk, Bjełoçaç, Isniq, Oçrim, Terbuhofic, Rakojina, Dobrodol, Dobrodol ose Grençar, Trepova Pole, Vodojina, Novosel, Dulova, Mali Lepovac, Rakosh, Stardusan, Radovac, Kashiça, Otomaniça, Zhalaç, Berkova, Baniça, Gorna Glogjani, Bujuk Jablanica, Kotoradiq, Duboviq, Iznopole, Boshaniça, Bjelopolja, Rashkovaç, Novasel, Hrastoviça, Grebeniq, Plava, Zhakova, Kostrac, Dolina Nekrovac, Gorna Nekrovac, Dolina Luka, Jablanica e madhe, Jablanica e vogël, Butosha, Bresteq,, Dolina Bubq, Papragjani, Radosniq, Prigoda Popole, Manastir Simon, Luboshta, Krusheviça, Rikova, Shikojna, Radulovac, Virniça, Tuçep, Gjurgjovik Kyçyk, Naglavka, Popoviq, Breatovac, Baç (Beç), Novasel, Studenica Kyçyk, Lezibaba, Barani, Lazhani, Dujak, Jednozh, Çirnivirh, Dobrosh Buzreq, Shalnoviq, Dobrica dol, Gorna Kirnina, Gorna Petriça, Dolina Petriça, Ivranic, Dolina Kaliçani, Rajovac, Ostropaç, Gorna Lutoglava, Mraç ose Çirni Potok, Brodgjin Nikla, Çeskova, Irznic, Grabofiq, Dolina Çirna Goi, Mezrea Bjelopavliq, Ljeshan, Jablanica e Vogël, Graboça, Prekolug, Grabonica, Dolina Krnina, Jablani (Bablani), Dolina Lablani, Bugjani ose Butin, Girmixhil, Rugova, Dolina Leoçina, Manastiri Shumeniq, Drenofic, Pusto Joshanic, Dolina Ivranic, Mezraa Sipoti

Krahina e Bihorit e marrë në tërësi, më 1485 kishte 74 vendbanime, kurse më 1582 86 vendbanime, pra kemi një shtesë prej 12 fshatrash, domethënë 13.9 për qind e tyre. E vazhduan jetën nga viti 1485 në vitin 1582 70 fshatra, d.m.th. 91 për qind e tyre.<sup>1</sup>

Siç del nga shifrat e lartpërmendura vendbanimet e sanxhakut të Shkodrës nga shek. XV në shek. XVI u shtuan, por diku shtimi ishte më i madh dhe diku më i vogël. Nga të dhënat rezulton se shtimin më të madh e ka pasur Ultësira e Shkodrës jo vetëm për arsye se kjo ishte një zonë me terren fushor me kushte të përshtatshme për krijimin e vendbanimeve të reja, por edhe për faktin se luftërat dhe pushtimet këtu kishin zhdukur gjatë shek. XV një varg fshatrash, të cilat me stabilizimin e gjendjes pas pushtimit osman pjesërisht ishin ripërlëritur. Në zonat malore që më i vështirë krijimi i vendbanimeve të reja mbasi nyjat më të përshtatshme për jetesë qenë zënë me kohë dhe vetë ekzistenca e një terreni të thyer pa toka të punueshme e vështirësonte së tepërmi krijimin e ngulimeve të reja. Shtimi i tyre që bërë kryesisht në nahijen e Bjelopavliqit (Ivrezhgrenci). Krahina malore e Bihorit, për të njëjta arsye si edhe Malësia e Shkodrës kishte pasur gjithashtu, një rritje të paktë të vendbanimeve.

Edhe në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit nga shek. XV në të XVI pati një rritje të vogël të numrit të vendbanimeve,

---

fiça, Shuma, Lutinik Rjeniça, Kolsh, Brovina, Planjani, Dolina Bugjani, Vuçidol, Gorna Bugjani, Shipçani, Ismolica, Shoshan, Kamenica, Mel, Jasiça, Kaliq, Goranica, Ponoshneci, Banica, Çernomile, Lizhani, Stepaneselo, Brebad, Trenova ose Vokshiq, Çirna Potok, Gosturani, Gorna Çirna Goi, Gorani, Poçeshta, Istubla, Kovaçiça, Shushçiça, Rogam, Shishmanci, Trebnosh.

1) Këto janë: Lubeniça, Parjova, Glavac, Budimile, Gorna Zagradija, Shekullar, Irzhanica, Papratniça, Zaostro, Bojin, Dapsiq, Trepç, Çermilovina, Grazhda, Lug, Sçerça, Dragosava, Kaludra, Zagorja, Peknik, Maçeta, Dolina Zagrada, Tihodol, Çërnavihr, Berkovac, Podstrana, Leshnica, Gradovica, Grençar, Bara, Nilutin, Komadin, Kiç, Sijal Grashica, Zakot, Oklat, Manastiri Petrova Çerkova, Pron, Bjelokova, Kotac, Onica, Bukaviq, Luzi, Gorna Ulutina, Dolina Ulutina, Mashnica Irzhanica, Noshiq, Komaran, Ribar, Grada, Krushova, Gusina, Trepç, Velika, Rozhiq, Kral ose Gludi, Zabrda, Gjoliç, Çoreshkova, Rreshovina, Çaçuni, Sijuç-Sivaç, Bokova ose Kotobesin, Islatina, Inxhilat, Podi.

ndonëse në përgjithësi kjo trevë ka toka të mira e pjellore të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë dhe për krijimin e ngulimeve të reja. Kjo kishte ardhur ngaqë fshati aty ishte i stabilizuar me kohë dhe se me pushtimin osman nuk pësoi rrënimë, siç ndodhi në Ultësirën e Shkodrës, të cilat do të shkaktonin për një farë periudhe zhdukjen e një vargu vendbanimesh të lashta dhe nevojën e ripërtëritjes së tyre, më vonë në shek. XVI. Rrafshi i Dukagjinit, si një zonë me burime ekonomike të pasura, kishte pasur më tepër vendbanime se trevat e tjera të sanxhakut të Shkodrës.

Në tërësi, mund të thuhet se gjendja e vendbanimeve në fund të shek. XVI del më e stabilizuar në krahasim me atë që na paraqitej në fillimet e pushtimit osman. Shtimi i numrit të vendbanimeve në secilën zonë kishte ardhur në radhë të parë si rezultat i shtimit natyror të popullsisë, i ndarjes së ndonjë fshati në dy fshatra, si rezultat i zgjerimit të tij. Shtimi i ndjeshëm i numrit të shtëpive brenda fshatit solli për pasojë që fshatra të vjetra të degëzoheshin në disa fshatra, duke formuar vendbanime të reja. Kështu në regjistrin venedikas të vitit 1416-1417 përmendet fshati Samrish me 49 shtëpi, në vitin 1485 një pjesë e tij bënte pjesë në timarin e Hasan Marinit, kurse pjesa tjetër në timarin e Kasemit. Në regjistrin e vitit 1582, si rezultat i rritjes së numrit të shtëpive, dalin 2 fshatra më vete; Samrishi i Poshtëm dhe Samrishi i Epërm. I njëjti fenomen ndodhi edhe me fshatin Dulo-va. Ripërtëritjen e fshatrave të braktisura e ilustron qartë rasti i fshatit Beltojë. Në vitin 1416-1417 ky fshat ekzistonte si vendbanim, kurse në vitin 1485 nuk përmendet në regjistrimin osman. Është e kuptueshme se ai duke u ndodhur pranë Shkodrës, e cila u bë epiqendra e sulmeve osmane më 1474 dhe 1478, të jetë shkatërruar nga luftërat, ose të jetë braktisur nga banorët. Në vitin 1582 Beltoja dokumentohet me 36 shtëpi. Pra duhet të jetë ripopulluar pas vitit 1485 ose nga banorët e shpërngulur, ose nga fshatarë të ardhur në toka të lira, të përshtatshme për banim meqë më parë Beltoja kishte qenë fshat.

Vendbanimet nuk krijoheshin kudo. Që në një vend të caktuar të ngrihej një fshat ai duhej të plotësonte disa kushte. Së pari duhej të kishte burime uji dhe toka të punueshme. Përveç kësaj shtimi i vendbanimeve dhe lindja e fshatrave të reja lidhej edhe me ripërtëritjen dhe shtimin e forcave të gjalla njerëzore. Këto dukuri i pasqyrojnë qartë def-



teri i regjistrimit të vitit 1582. Pavarësisht nga arsyet e veçanta që kanë ndihmuar në krijimin e një fshati apo të një tjetri, të cilat ne nuk kemi mundësi t'i ndjekim e shohim me vend të paraqitim këtu në mënyrë të hollësishme shtimin e vendbanimeve në bazë të nahijeve:

### Ullësira e Shkodrës

Nahijet	Sasia e fshatrave		Numri i fshatrave të shtuara	Shtimi i fshatrave i shprehur në
	1485	1582	nga 1485-1582	%
1. Shkodra	82	139	57	69.51
2. Drishti	12	28	16	133.33
3. Bregu i Këndejmë	5	—	—	—
4. Bregu i Përtejme	5	55	37	205.86
5. Krahina e Anamalit	8	—	—	—
6. Shestani	3	7	4	133.33
7. Merkodi	1	1	—	—
8. Krajna	1	1	—	—
9. Zhabjaku	18	16	-2	—
10. Podgorica	7	21	14	200
<b>Gjithsej</b>	<b>142</b>	<b>268</b>	<b>126</b>	<b>88.73</b>

### Malësia e Shkodrës<sup>1</sup>

Nahijet	Sasia e fshatrave		Numri i fshatrave të shtuara	Shtimi i fshatrave shprehur në
	1485	1582	nga 1485-1582	%
1. Kuçi	8	12	4	50
2. Petrishpani	30	36	6	20
3. Kelmendi 1497	2	3	1	50
4. Hoti	9	8	-1	—
5. Pipri 1497	15	16	1	6.87
6. Bjelopavliqi	3	6	3	100
<b>Gjithsej</b>	<b>67</b>	<b>81</b>	<b>14</b>	<b>20.90</b>

1) Nahija e Ivrazhagrançit nuk qe përfshirë në regjistrimin e 1485-ës

### Krafshi i Dukagjinit (një pjesë)

Nahijet	Sasia e fshatrave		Numri i fshatrave të shtuara nga 1485-1582	Shtimi i fshatrave i shprehur në %
	1485	1582		
1. Peja	196	252	28	12.5
2. Suhogërlla	28	—	—	—
3. Altun-ilia	51	42	9 (pakësim)	—
Gjithsej	275	294	19	6.91

### Krahina e Bihorit

Nahijet	Sasia e fshatrave		Numri i fshatrave të shtuara nga 1485-1582	Shtimi i fshatrave i shprehur në %
	1485	1582		
1. Komarani	15	23	8	53.33
2. Plava	15	18	3	20
3. Izla Rjeka	12	13	1	8.33
4. Komnini	32	32	—	—
Gjithsej	74	86	12	16.22

Duke ndjekur zhvillimin e vendbanimeve nga shek. XV në shek. XVI konstatohet se në numrin e përgjithshëm të vendburimeve vendin më të rëndësishëm e zënë ato fshatra që vazhduan ekzistencën nga njëri shekull në tjetrin. dha pas tyre vijnë fshatrat e krijuara rishtas dhe ato të zhdukura.

Vijueshmëria e jetës së shumicës së vendbanimeve fsha-

ku përmendet vetëm fshati me të njëjtin emër. Për këtë arsye nuk e kemi përfshirë në krahasimin e shtimit të vendbanimeve.

tare nga shek. XV në XVI, ndonëse përjetuan kushtet e vëprimit shkatërrues të pushtimit osman, është një ndër treguesit më elokuentë që flet se ato kishin qenë të qëndrueshme dhe të ngulitura shumë kohë më parë se shek. XV, flet për fshatra me një traditë të gjatë ngulësie të popullsisë, për vendbanime siç do të flitet në kapitujt e tjerë, me burime ekonomike të normalizuara, për një kulturë prodhuese të një popullsie stabël në selitjet e veta e të formuar si kombësi në rrjedhën e shekujve.

Në materialet e kadastrës së Shkodrës ekziston vetëm një rast që flet për fshatarë në anën e sipërme të Shkodrës, pranë liqenit, që quhen Dobranci e Vlakë (Vrakë?)<sup>1</sup> të cilët nuk paguanin as dukatin, as modin e drithit, as obrokun, sepse nuk ishin të ngulur, Këta banorë e kalonin jetën në një mënyrë të tillë për shkak të karakterit të ekonomisë që ushtronin. Ata ishin barinj që shkonin e vinin për të gjetur kullota të përshtatshme për bagëtitë e tyre. I marrë në tërësi dokumentacioni i fillimit të shek. XV tregon se vendi që zënë banorë të tillë në kuadrin e kadastrës është fare i parëndësishëm. Ngulësia e popullsisë nuk i përjashton lëvizjet, shpërnguljet, ecejaket e asaj pjese që merrej me blegtori me qëllim që të sigurohej ushqim për tufat e bagëtive si në kullotat dimërore ashtu edhe në ato verore.

Në disa treva të kufizuara të Malësisë së Mbishkodrës si në Kuç, Kelmend, Pipër ekzistonin edhe bashkësi fshatare që merreshin kryesisht me mbarështimin e bagëtive të cilat ishin të organizuara në katunde. Këto ishin zakonisht vendbanime me banorë që në zanafillë merreshin kryesisht me blegtori dhe që kishin organizim shoqëror të ndryshëm nga fshati, i cili ushtronte kryesisht bujqësinë. Këta zakonisht lëviznin nga vendbanimet e tyre malore për në zonat fushore fqinje për t'u siguruar ushqim bagëtive. Në muajt e ftohtë të dimrit ata së bashku me kopetë e tyre zbrisnin nga viset e kullotave verore të bagëtive, në kullotat dimërore, që ishin në përgjithësi zonat bregdetare. Kjo lëvizje është një fenomen i njohur në mesjetë që dëshmon për blegtorë të mirë e me përvojë.

Në defterin e regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 figurojnë të regjistruar në nahijen e Kelmendit katundi Liçeni që kishte formuar fshatin Selçisha dhe katu-

1) *Kadastra e Shkodrës*, fl. 65/a.

ndet Gjonoviq, Leshoviq, Muriq, Kolemadi që kishin formuar fshatin Içpaje,<sup>1</sup> në nahijen e Piprit katundet Bukmir, Bushat, Dirnovaça kishin formuar respektivisht fshatrat Istrahaliq dhe Dirnovaça.<sup>2</sup> Transumanca e katundeve ndihet në regjistrinain e vitit 1485 sidomos për viset malore, kështu lidhur me katunin Dirnovaça thuhet: «[në fillim] zbritën nga Brestica në Belirte, pastaj shkuan nga Belirta në mëhallën e quajtur Birnovaça në Lushkozhupa; paskëtaj përsëri shkuan në Belirten e sipërpërmendur dhe përsëri shkuan në Lushkozhupa, tani zbritën në Dirnovaça dhe u regjistruan si banorë të atyshëm».<sup>3</sup>

Gjurmët e lëvizjes së popullsisë dhe sidomos fenomeni i shndërrimit të katundit në fshat dëshmohen qartë në nahijet e Piprit e të Kelmendit, për shumë fshatra defteri thotë edhe se nga kanë ardhur banorët e tyre. Kështu ai regjistron: fshati Lushkozhupa: më parë banonin në fshatin e quajtur Istana<sup>4</sup> dhe Lutova;<sup>5</sup> fshati Drezka, më parë banonin në vendin e quajtur Sopa,<sup>6</sup> dhe Prostovi;<sup>7</sup> fshati Mirasniça, kanë zbritur nga Hrasniça,<sup>8</sup> fshati Belica, më parë banonin në vendin e quajtur Podkos<sup>9</sup> dhe në fshatin Mirasniça,<sup>10</sup> fshati Istrahaliq, më parë banonin në Brestica,<sup>11</sup> katuni Bukmir dhe Bushat që kishin formuar fshatin Istrahaliq, më parë banonin në vendin e quajtur Veternik,<sup>12</sup> fshati Radushevdo nga katuni i të sipërpërmendurit Radiç.<sup>13</sup> Defteri veçon fshatrat e ngulura nga ato të krijuara rishtas. Kështu në nahijen e Piprit thuhet se

---

1) *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, f. 200-204.

2) *Po aty*, f. 197-200.

3) *Po aty*, f. 199.

4) *Po aty*, f. 189.

5) *Po aty*, f. 189.

6) *Po aty*, f. 190.

7) *Po aty*, f. 192.

8) *Po aty*, f. 192.

9) *Po aty*, f. 192.

10) *Po aty*, f. 193.

11) *Po aty*, f. 195.

12) *Po aty*, f. 198.

13) *Po aty*, f. 198.

banorët e fshatrave Dobriqo,<sup>1</sup> Dugë,<sup>2</sup> Bresticë,<sup>3</sup> Reçiçë,<sup>4</sup> banonin gjithmonë në vendet e tyre.<sup>5</sup>

Në kushtet e shtimit të popullsisë një pjesë katundesh gjatë kalimit në vendet e kullotave dimërore në zonën bregdetare i shndërroan vendqëndrimet e staneve të tyre në troje të populluara rishtas, në fshatra të cilat morën emërtimet e vetë katuneve. Në këtë mënyrë në fushën e Shkodrës në fund të shek. XV nga bashkësia e Kuçëve lindën fshatrat: Kuç. Tuz, Prekal, Bushat, Fëç, Kakarriq etj. nga katunet me të njëjtat emra, ose nga degë të katuneve ishin krijuar vendbanime të cilat morën emrin e krerëve të vëllazërive, si p.sh. Gjon Tuz, Gjiç Marin Tuz etj. Përvec këtyre pjesëtarë të katundeve ose pjesë të tëra të tyre u shkëputën duke u vendosur në fshatrat e fushës. Në përgjithësi në fshatrat ku këta përbënin pakicën e popullsisë u mbizotëruan nga banorët anas. kurse në një numër fshatrash këto degë katunesh u ruajtën më kompakte duke mbizotëruar mbi banorët anas dhe duke i dhënë emërtimit të fshatit edhe emrin e katundit. Kështu vëllazëria e Tuzëve më 1485 ishte ngulitur në 11 qendra banimi. kurse më 1416-17 aio popullonte tërësisht vetëm fshatin Tuz.<sup>6</sup> Në fund të shek. XV. katuni Bushat ishte degëzuar duke u ngulitur në dy fshatra, të cilëve u dha emrin e vet. në nahijet e Zhabjakut dhe të Piprit. Pjesëtarë të tij ishin shpërndarë ajëkohësisht edhe në fshatrat e trevës fushore të Shkodrës.

Katunet e ardhura në fushën e Shkodrës në mënyrë graduale u përfshinë në ekonominë feudale, në sistemin proniar, duke humbur gradualisht pozitën e vecantë social-ekonomike që zinin në shoqërinë feudale.<sup>7</sup> Kështu p.sh. si-nas kadastrës së Shkodrës më 1416-1417 fshatrat Kuc. Rec. Kakarriq, Prekal, i ishin nënshtruar sistemit proniar. pagimit të rentës në formën e dukatit, të modit dhe të obrokut dhe

1) *Po aty*, f. 191.

2) *Po aty*, f. 194.

3) *Po aty*.

4) *Po aty*.

5) *Po aty*.

6) S. Pulaha. *Kontribut për studimin e ngjiljes së katuneve dhe krijimin e fiseve në Shqipërinë e Veriut në shek. XV-XVI*. «Studime historike», 1975/1, f. 75-110.

7) *Po aty*.

jo sistemit të dukatit për çdo vatër që ishte karakteristike për trevat malore me ekonomi kryesisht blegtorale.<sup>1</sup> Në fund të shek. XV fshatrat Reç, Kuç, Gradec Tuz, Podol Tuz, Damnic Tuz, Bgur Tuz, Kuçik Tuz, Istulush Tuz, Petroshani Tuz, Tuz, Shukoviç Tuz, i ish-in nënshtruar sistemit të timarit, kurse fshatrat Reç, Kakarriq, Prekal, vazhdonin të qëndronin nën sistemin e dukatit, modit dhe obrokut tashmë të emërtuara me termin osmane *hinne* dhe *hënta*. Këto qendra banimi nuk qenë përfshirë në statusin e florixhinjve ashtu siç kishin qenë trevat malore të sanxhakut të Shkodrës.<sup>2</sup>

Pra, siç vumë në dukje, një pjesë katundesh u ngulitën në troje të banuara rishtas dhe krijuan aty fshatra të reja; pjesa tjetër mbushi fshatrat e mëparshme të braktisura ose u shkri me popullsinë e fshatrave të tjera duke mbizotëruar mbi të.<sup>3</sup>

Sipas analizave të bëra nga S. Pulaha procesi i shndërrimit të katundit në fshat përfundoi në shek. XVI edhe në viset e Kucit, Kelmendit dhe Piorit. Pas kësaj periudhe fjala katun bëhet sinonim me fjalën fshat. Fakti se katunet gjendeshin në një sasi shumë më të paktë se në viset fqinje të Malit të Zi, Bosnjës dhe të Hercegovinës, në një zonë tepër të kufizuar dhe që mbarojnë së ekzistuari në fund të shek. XVI. është dëshmia më e qartë që tregon se fshatrat bujqësore ose blegtorale-bujqësore të Shqipërisë së Veriut ose të trevave të tjera shqiptare ku nuk ndeshen katune në shek. XV. ishin vendbanime të formuara shumë kohë përpara pushimit osman.

Lëvizje të popullsisë vërehen në braktisjen e fshatrave për arsye të ndryshme. Për to jemi në gjendje të givkojmë në mënyrë të tërthortë nga mbiemrat që vazhdonin të ruajn fshatarët sinas fshatit nga vinin. Kështu në fshatin Majora është regjistruar si kryefamiljar Jon Tuzi,<sup>4</sup> nga mbiemri i të cilit mund të givkohet se ka qenë banor i fshatit Tuz. ose në fshatin Luban përmenden Pali Sigjeci dhe Todaro Sigjeci,<sup>5</sup> me sa duket të ardhur nga fshati Sigjeç; në fshatin Sakoli

---

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Kadastra e Shkodrës, fl. 50/a.*

5) *Po aty, fl. 76/b.*

kryefamiljarët Gjergj Mesi apo Pelegrin Mesi<sup>1</sup> nga fshati Mes, Martin Gramshi<sup>2</sup> nga fshati Gramsh; në fshatin Ndreshkije Nikolla Kuçi<sup>3</sup> nga fshati Kuç; në fshatin Dajç Vitan Krueti<sup>4</sup> nga fshati Krueti dhe Andrea Kakarriqi<sup>5</sup> nga fshati Kakarriq; në fshatin Samrish Nikolla Reçi<sup>6</sup> nga fshati Reç. Raste të tilla ka edhe të tjera në kadastër.

Popullsia braktiste fshatrat për arsye politike ose ekonomike, të cilat rrallë mund të hetohen në regjistrat. Kështu p.sh. fshati Radosha i Pejës, para vitit 1485, dokumentohet i banuar, kurse në vitin 1485 është i braktisur e i shkatërruar.<sup>7</sup> Banorët e tij, duke mos e duruar shtypjen dhe shfrytëzimin ishin ngritur kundër pushtuesit, i cili ishte hakmarrë në mënyrën më çnjerëzore, duke i varur disa ose duke i ngulur në humi disa të tjerë.<sup>8</sup> Braktisja e fshatrave bëhej edhe për arsye ekonomike. Fshatarët shpeshherë përpiqeshin të hapnin toka të reja, në territore më të përshtatshme për bujqësi, si rrjedhim braktisnin vendbanimet e vjetra dhe vendoseshin në ngulimet e reja.

Duke analizuar gjendjen e vendbanimeve të sanxhakut të Shkodrës arrijmë në përfundimin se në përgjithësi fshatrat e kishin vazhduar jetën nga njëri shekull në tjetrin. Një pjesë e atyre që ekzistonin në vitin 1417 dhe që u zhdukën në vitin 1485 ishin ripërtërirë përsëri më 1582. Ndërkohë një numër fshatrash ishin zhdukur ndërsa të tjerë ishin krijuar rishtas. Në këto grupe fshatrash vendin më të rëndësishëm e zinin vendbanimet që e kishin vazhduar ekzistencën e vet. Por kishte edhe fshatra të braktisura si rezultat i veprimit të faktorëve të brendshëm apo të jashtëm të karakterit ekonomik dhe politik.

Krahas dukurisë së zhdukjes vërtetohet edhe fenomeni i krijimit të fshatrave të reja, të cilat kishin epërsi në krahasim me numrin e fshatrave të zhdukura. Në pamje të parë këto dukuri të krijojnë përshtypjen sikur janë fenomene të

1) *Po aty*, fl. 85/b.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*, fl. 86/b.

4) *Po aty*, fl. 97/b.

5) *Po aty*.

6) *Po aty*, fl. 98/a.

7) Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 fl. 461.

8) *Po aty*.

kundërta që përjashtojnë njëri-tjetrin, por, në fakt, ato janë dëshmi të dinamikës së zhvillimit të vendbanimeve. Fshati edhe pse kaloi nga një pushtues tek tjetri nuk u zhduk, por e vazhdoi jetën e vet në rrjedhën e viteve.

Vazhdimësia e jetës së shumicës së fshatrave tregon se tashmë qe mbuluar me vendbanime shumica e nyjave në kushte ekonomike e gjeografike të përshtatshme për një banim sedentar të popullsisë. Nga ana tjetër, ripërtëritja e fshatrave të shkatërruara nga lufta dhe krijimi i vendbanimeve të reja dëshmon për shtimin e popullsisë, për rigjallërimin e forcave prodhuese që u krye gjatë shekullit XVI, pavarësisht nga faktorët pengues që krijoi sundimi osman.

Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria që karakterizoi fshatrat në krahinat e sanxhakut të Shkodrës, rruga e zhvillimit që ai ndoqi gjatë periudhës fillestare të pushtimit osman, e kushtëzuar kjo nga një varg arsyesh më shumë të karakterit politik në etapën e parë dhe më vonë kryesisht të karakterit ekonomik, dëshmojnë se fshati shqiptar nuk ishte mobil, se banorët e tij nuk ishin endacakë dhe as barinj ravgues.<sup>1</sup>

---

1) G. Shtadmüller. *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*. Weisbaden 1966, f. 141, 147, 154, 159.



## KREU II

### GJENDJA DEMOGRAFIKE NË KRAHINAT E SANXHAKUT TË SHKODRËS NË SHEK. XV-XVI

Studime demografike për periudhën para pushtimit osman të vendit vështirë se mund të ndërmerren për arsyen e thjeshtë se mungojnë regjistrat përkatës. I vetmi material që ekziston është «Regjistri i Kadastrës së Shkodrës dhe i Konçesioneve i vitit 1416-17», i cili përfshin një zonë të caktuar, Shkodrën me territoret përreth.

Kadastra venedikase regjistron 116 fshatra, prej të cilave dy ishin të pabanuar. Të 114 vendbanimet kishin gjithsej 1684 shtëpi.<sup>1</sup> Dendësia mesatare është afërsisht 15 shtëpi për vendbanim.

Të dhëna më të hollësishme në këtë drejtim na japin defterët kadastralë osmanë. Për të shqyrtuar disa probleme të demografisë në vendbanimet fshatare shqiptare të një zone të caktuar kemi marrë në analizë dy regjistra osmanë: Defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 dhe atë të vitit 1582.

---

1) Kolë Luka. «Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës të shek. XV». «Studime filologjike», 1976/2, f. 171.

## GJENDJA DEMOGRAFIKE MË 1485

Gjendja demografike për secilën krahinë dhe nahije sipas defterit të regjistrimit të vitit 1485 paraqitet si më poshtë:

Zona e ulët e Shkodrës<sup>1</sup> (1485)

Nënzona	Nahijet	Numri i fshatrave	Numri i shtëpive	Numri i beqarëve	Shtëpi të vejash	Shtëpi të veja	Numri mesatar i shtëpive për fshat.	Vërejtje	
								3	4
Nënzona I	Shkodra	82	1185	151	2	1187	14.48		
	Drishti	12	253	24	2	255	21.25		
	Bregu i Këndejmë	5	155	3		155	31		
	Bregu i Përtejme	5	63			63	12.6		
	Shuma:	104	1656	178	4	1660	15.96		
Nënzona II	Shestani	3	74			74	24.67		
	Anamali	8	33			33	4.13		
	Shuma:	11	107			107	9.73		
Nënzona III	Zhabjaku	18	307	7		307	17.06		
	Podgorica	7	95			95	13.57		
	Shuma:	25	402	7		402	16.08		
Nënzona I+II+III	Gjithsej:	140	2165	185	4	2169	15.49		

1) Në nxjerrjen e të dhënave jemi mbështetur te S. Pulaha: «Po-

### Malësia e Shkodrës

1	2	3	4	5	6	7	8	9
Kuçi	8	253	3		253	31.63		
Petrishpani	30	333			333	11.1		
Kelmendi (1497)	2	152	30	1	153	76.5		
Hoti	9	129			129	14.33		
Pipri (1497)	15	421	128	31	452	30.13		
Bjelopavliqi	3	159			159	53		
<b>Gjithsej:</b>		<b>67</b>	<b>1447</b>	<b>161</b>	<b>32</b>	<b>1479</b>	<b>22.07</b>	

### Krahina e Bihorit

Komnini	32	632	177	64	696	21.75	
Plava	15	1085	28	44	1129	75.27	
Izlarjeka	12	248	29	12	260	21.67	
Komarani	15	171		13	184	12.27	eflakë
<b>Gjithsej</b>	<b>74</b>	<b>2136</b>	<b>234</b>	<b>133</b>	<b>2269</b>	<b>30.66</b>	

*pullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI»; «Të dhëna onomas-tike mbi elementin shqiptar të krahinave të sanxhakut të Shkodrës në fund të shek. XV». «Studime historike», 1972, nr. 2. Duke i marrë të dhënat edhe një herë kemi bërë disa saktësime në lidhje me sasinë e banorëve të ndonjë fshati që jepen në studimin e lartpërmendur. P.sh. tek nahija e Bregut të Përtejme nga 64 në 63 shtëpi, tek nahija e Zhabjakut nga 6 në 7 beqarë, si dhe tek nahija e Podgoricës nga 89 në 95 shtëpi, sepse fshati Fupos nuk ka 1 shtëpi por 7 shtëpi. Po kështu në Malësinë e Shkodrës në nahijen e Kuçit nga 266 në 253 shtëpi, sepse fshati Brokina nuk ka 25 por 12 shtëpi. Po kështu në nahijen e Pejës është përfshirë fshati Boroshica i nahijes së Tergovishtës apo fshatrat Magjriça dhe Netrobishta të nahijes së Prizrenit, si dhe fshatrat Kolaniça, Dranofiça (Drenovci) dhe Dobridug që i takojnë nahijes së Vuçiternit, apo fshatrave të tjera që i përkasin nahijes së Suhogërlës si Palova, Krninça (Krnjina), Kërnina, Orlat (Urlat), Gorna Dren (Dreni), Radulovac (Radulovë). Lidhur me kra-*

**Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)**

1	2	3	4	5	6	7	8	9
	Peja dhe Suhogërria <sup>1</sup>	224	5037	1075	356	5393	24.08	
	Altun-ilia	51	916	357	102	1018	19.96	
	Gjithsej	275	5953	1432	458	6411	23.31	

Nga shqyrtimi analitik i nahijeve në veçanti për secilën zonë rezulton se Ultësira e Shkodrës ka 140 fshatra me 2165 shtëpi, 185 beqarë dhe 4 të veja. Dendësia mesatare është 15.49 shtëpi për fshat. Po ta vështrojmë këtë zonë më nga afër sipas pozitës gjeografike të terrenit do të dallonim tre nënzona:

Nënzonën e parë me nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Këndejmë dhe të Bregut të Përtejme që numëronte 104 fshatra me 1656 shtëpi, 178 beqarë dhe 4 të veja. Dendësia mesatare e shtëpive për fshat këtu ishte 15.96 shtëpi. Numrin më të madh të fshatrave dhe të shtëpive e shënonte nahija e Shkodrës, ndërsa dendësinë mesatare më të madhe të shtëpive për fshat e kishte Bregu i Këndejmë (31), ndërsa më të voglën Bregu i Përteimë (12.6).

Nënzonën e dytë me nahijet e Shestanit dhe të Anamalit, që kishin 11 fshatra me 107 shtëpi. Dendësia e shtëpive për fshat këtu ishte 9.73 për oind. Më e ulët kjo paraqitet në krahinën e Anamalit (4.13), ku fshatrat kishin një numër mjaft të kufizuar shtëpish (nga një deri në tetë). Kjo dukuri mund të shpjegohet jo aq me kushtet ekonomike të vendit, që pak a shumë ishin të njëjta me ato të viseve fqinje, sesa me ndonjë shpërngulje të popullsisë.

Nënzonën e tretë me nahijet e Zhabiakut dhe Podgoricës që kishin 25 fshatra me 402 shtëpi. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim këtu ishte 16.08 shtëpi. Nga të tria nënzonat, e dyta ishte ajo që kishte një popullsi më të rrallë.

Malësia e Shkodrës kishte gjithsej 67 fshatra me 1447 shtëpi, 161 beqarë dhe 32 të veja. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim këtu ishte 22.07 shtëpi. Më të madhe e

hinën e Bihorit e konkretisht me nahijen e Komaranit është lënë na përfshirë fshati Oplad me 8 shtëpi, ndërsa në nahijen e Izla Rjekës kemi 29 beqarë dhe 12 të veja dhe jo 28 e 7 siç jepen aty.

1) Nahijet e Pejës e të Suhogërlës i kemi llogaritur së bashku, sepse në regjistrimin e vitit 1582 ato nuk jepen më vete.

kishte dendësinë nahija e Kelmendit, e Bjelopavliqit, e Kuçit (deri në 76.5 shtëpi), ndërsa më të vogël nahija e Petrishpanit (11.1 shtëpi). Për periudhën nga viti 1485 deri 1497 dendësia mesatare e shtëpive për fshat në krahinën e Piprit është rritur nga 12.15 në 30.13 shtëpi. Kjo rrjedh nga fakti që në defterin e vitit 1485 nuk janë regjistruar një numër i caktuar katunesh, të cilat i gjejmë të regjistruara në vitin 1497. Kjo është arsyeja që shpjegon edhe shtimin e shtëpive nga 243 në 452. Pra këtu nuk është fjala thjesht për një rritje natyrore të popullsisë. Për nahijen e Kelmendit diçka konkrete për regjistrimin e vitit 1485 nuk mund të themi sepse nuk e kemi atë. Më 1497 kjo nahije shënon dendësinë më të madhe të shtëpive për vendbanim. Ajo kishte vetëm dy fshatra në të cilat qenë ngulitur pesë katune.

Nga përllogaritjet rezulton se në zonat më të thella të vendit fshatrat kishin një dendësi më të madhe familjesh. Kuptohet se aty popullsia përqendrohet në viset me kushte gjcografike të përshtatshme për banim, të cilat ishin të pakta për shkak të sipërfaqeve të kufizuara të tokave të punueshme. Pra qenë faktorët ekonomikë dhe gjeografikë ata që kufizonin krijimin e vendbanimeve të reja. Si rrjedhim fshati këtu mbante një popullsi më të dendur.

Krahas tyre ndikuan edhe faktorët politikë. Pushtimi osman i vendit dhe bashkë me të vendosja e regjimit feudal ushtarak bënë që një pjesë e popullsisë duke mos e duruar dot peshën e rëndë të sistemit të timarit, si dhe situatat e reja të krijuara, të braktiste trojet e veta dhe të mërgonte jashtë vendit. kurse një pakicë të tërhiqej në malësi.

Pjesa e Rrafshit të Dukagjinit e përbërë nga nahijet e Pejës, të Suhogërlës, dhe të Altun-ilisë kishte 275 fshatra me 5953 shtëpi, 1432 beqarë dhe 458 të veja. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim ishte 23.31. Nga nahijet e përfshira në këtë zonë dendësinë mesatare më të madhe të shtëpive për fshat e kishte Peja e Suhogërlla (24.08), ndërsa më të voglën Altun-Ilia (19.96). Në tërësi dendësia mesatare e numrit të shtëpive për fshat këtu është më e madhe se në Ultësirën dhe në Malësinë e Shkodrës. Ky fakt tregon se kjo zonë kishte kushte ekonomike më të favorshme për jetesë.

Fakti që në këtë zonë dendësia mesatare e numrit të shtëpive për fshat ishte më e madhe dhe gjendja ishte më e normalizuar se në Ultësirën e Shkodrës, shpjegohet kryesisht me faktorët politikë e konkretisht me faktin se pushtimi osman

ishite vendosur para disa dhjetëvjeçarëve dhe qysh atëherë zona e kishte marrë veten, vendi nuk kishte pësuar shkatërrime nga fushatat e ushtrive osmane.

Krahina e Bihorit kishte 74 fshatra me 2136 shtëpi, 234 beqarë dhe 133 të veja. Dendësinë mesatare të shtëpive për vendbanim e kishte 30.66 shtëpi. Më të madhe e kishte nahija e Plavës 75.27 shtëpi, ndërsa më të voglën nahija e Komaranit 12.27 shtëpi. Këto dy nahije kishin të njëjtin numër fshatrash (nga 15 fshatra), kurse numri i familjeve ishte i ndryshëm: Plava 1085, Komarani 171. Ashtu si Rrafshi i Dukagjinit edhe kjo krahinë nuk pësoi ndikimin shkatërrues të furisë osmane siç ndodhi me rrethin e Shkodrës.

## GJENDJA DEMOGRAFIKE MË 1582

Si paraqitet gjendja demografike pas afro një shekulli? Për këtë le t'i referohemi regjistrin të vitit 1582. Edhe për shek. XVI do të marrim në shqyrtim po ato zona që kemi marrë për shek. XV me qëllim që të konstatojmë ndryshimet demografike që kanë ndodhur duke kaluar nga njëri shekull në tjetrin. Në vitin 1582 Ultësira e Shkodrës ishte e ndarë në këto nahije: Shkodra, Dushman ili, Zabajana, Malet e Sheshtanit, Podgorica, dhe Zhabjaku. Ndërsa në vitin 1485 ajo numëronte tetë nahije, tani kishte vetëm gjashtë. Pavarësisht nga ndryshimi i numrit të nahijeve, në fakt ato kapin po të njëjtat treva si në regjistrimin e vitit 1485.

Duhet vënë në dukje se kufijtë e nahijeve nuk janë të dhënë një herë e përgjithmonë, ato në rrethana të caktuara historike kanë lëvizur.<sup>1</sup> Në regjistrimet osmane jo vetëm vërejmë fenomenin që fshatrat e një nahijeje në një regjistrim të mëvonshëm të kenë kaluar në një nahije tjetër, por vërehet edhe fakti që të mos përmendet fare emri i nahijes. Kështu, ndërsa në regjistrimin e vitit 1485, nga Rrafshi i Dukagjinit janë regjistruar nahijet e Pejës, të Suhogërlës dhe

---

1) Kështu shumë fshatra që në regjistrimin e vitit 1485 bënin pjesë në nahijen e Zhabjakut, në regjistrimin tjetër osman, në atë të vitit 1582, bëjnë pjesë në nahijen e Podgoricës, të tilla janë: Grila, Dajbaba, Goriçani, Peshtbani, Gruda, Tuzi. Raste të tilla ka edhe për nahije të tjera.

të Altun-Ilisë, në regjistrimin e vitit 1582 jepën vetëm nahijet e Pejës dhe Altun-Ilisë, sepse në nahijen e Pejës janë regjistruar edhe fshatrat e Suhogërlës. Pavarësisht nga ndryshimet në emërtime, e rëndësishme është se në defterët kadastralë janë regjistruar të gjitha fshatrat, duke hyrë në përberje të kësaj apo asaj nahije.

Gjendja demografike e sanxhakut të Shkodrës për krahina e nahije të veçanta në fund të shek. XVI paraqitet si më poshtë:

#### Zona e ulët e Shkodrës (1582)

Nahijet	Numri i fshatrave	Numri i shtëpive të krish-tera + myslimane	Numri beqarëve	Numri i të martuarve (benakë)*	Numri i shtëpive gjithsej + benakë	Numri mesatar i shtëpive për fshat	Vërejtje
1	2	3	4	5	6	7	8
Shkodra	139	4444	767	160	4604	33.12	
Dushman-ili	28	516	93	2	518	18.5	
Zabojana	55	1030	167	28	1058	19.24	
Shestani	7	164	51	—	164	23.43	
Podgorica	21	1111	264	5	1116	53.14	
Zhabjaku	16	356	5	2	358	22.38	
<b>Shuma:</b>	<b>266</b>	<b>7621</b>	<b>1347</b>	<b>197</b>	<b>7818</b>	<b>29.39</b>	

#### Malësia e Shkodrës

Hoti	8	283	84	—	283	35.38	
Bjelopavliqi	6	443	—	—	443	73.83	
Pipri	16	503	—	—	503	31.43	
Kelmendi	3	70	—	—	70	23.33	
Kuçi	12	271	—	—	271	22.58	
Petrishpani	36	792	—	—	792	22	
<b>Shuma:</b>	<b>81</b>	<b>2362</b>	<b>84</b>	<b>—</b>	<b>2362</b>	<b>29.16</b>	

(\*) Benakë — kryefamiljarë që nuk zotërojnë tokë, por përbëjnë shtëpi më vete.

Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë) (1582)

1	2	3	4	5	6	7	8
Peja	252	5763	1436	95	5858	23.25	
Altun-Ilija	42	828	241	27	855	20.36	
Shuma:	294	6591	1677	122	6713	22.83	

Krahina e Bihorit

Budimile (Komnin)	32	715		715	22.34
Komarane	23	405		405	17.61
Plava	18	993		993	55.17
Izla Rjeka	13	353		353	27.15
Shuma:	86	2466		2466	28.67

Ultësira e Shkodrës<sup>1</sup> sipas regjistrimit të vitit 1582 kishte 266 vendbanime me 7621 shtëpi, 1347 beqarë dhe 197 benakë. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim ishte 29.39 shtëpi. Nga nahijet që bëjnë pjesë në zonën e ulët të Shkodrës dendësinë mesatare më të madhe e kishte Podgorica (53.14) dhe nahija e Shkodrës (33.12).

Malësia e Shkodrës<sup>2</sup> shënonte 81 vendbanime me 2362 shtëpi dhe 84 beqarë. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim ishte mjaft e lartë: 29.16. Në shek. XVI për këtë zonë dendësinë mesatare më të madhe e kishte nahija e Bjelopavliqit (73.83) e ndjekur nga Hoti (35.38) e Pipri (31.43). Edhe në Malësinë e Shkodrës konstatohet shtim i mirë i popullsisë si dhe një vazhdimësi jete.

Pjesa e regjistruar nga Rrafshi i Dukagjinit kishte 294 fshatra me 6591 shtëpi, 1677 beqarë, 122 benakë. Dendësinë

1) Në Ultësirën e Shkodrës nuk kemi përfshirë nahijet e Merkodit e të Krajnës, edhe pse tani në regjistrimin e vitit 1582 na jepen së bashku me vendbanimet.

2) Në Malësinë e Shkodrës nuk kemi llogaritur nahijen e Ivražgencit meqë ajo nuk qe përfshirë në regjistrimin e vitit 1485, ku përmendet vetëm fshati me të njëjtin emër në kuadrin e nahijes së Bjelopavliqit.



mesatare të shtëpive për vendbanim e kishte 22.83 shtëpi. Më të madhe këtë e kishte nahija e Pejës. Në zona fushore situata paraqitej disi më ndryshe në krahasim me malësinë ku kërkohet përqendrim popullsisë. Popullsia në këto zona në brendësi të vendit, në rrafshnaltat, në pllajat është shumë më e madhe sesa ajo e malësisë së vendit. Nga përlllogaritjet e bëra si për shek. XV, ashtu edhe për shek. XVI del se popullsia e Ultësirës së Shkodrës dhe ajo e Rrafshit të Dukagjinit është shumë më e madhe se ajo e Malësisë së Mbi-shkodrës dhe e krahinës së Bihorit.

Krahina e Bihorit kishte 86 vendbanime me 2466 shtëpi. Dendësia mesatare e shtëpive për vendbanim ishte 28.67 shtëpi. Dendësinë më të madhe e kishte nahija e Plavës (55.17), ashtu si në vitin 1485. Ndërsa më të voglën vazhdoi ta kishte nahija e Komaranit (17.61), ashtu si edhe në shek. XV (12.27).

Siç del edhe nga tabelat në zonat malore ku ndihej mungesa e tokave të punueshme, kishte një sasi të vogël vendbanimesh për arsye se mundësia për krijimin e fshatrave të reja ishte tepër e paktë. Krejt ndryshe paraqitej gjendja në nahijet me territore të rrafshta, ku vetë kushtet ekonomike dhe gjeografike ishin të tilla që lejonin krijimin e fshatrave të reja.

Sipas kushteve ekonomike dhe pozitës gjeografike, nahije të veçanta përfshinin sasi të ndryshme vendbanimesh. Kështu në zonën e ulët të Shkodrës, nahija e Shkodrës përfshinte 139 vendbanime, ndërsa nahija e maleve të Shestanit vetëm 7. Fshatrat nuk ishin të përhapura njëllor në të gjithë territorin; atje ku kushtet ekonomike e gjeografike ishin më të përshtatshme numri i vendbanimeve ishte më i madh, ndërsa atje ku këto mungonin shtimi i numrit të vendbanimeve ishte i kufizuar. Kështu zona e Malësisë së Shkodrës dhe krahina e Bihorit përfshinin një numër më të paktë fshatrash, kurse nahijet e Ultësirës së Shkodrës dhe të Rrafshit të Dukagjinit një numër më të madh. Ishin kushtet e favorshme ekonomike për zhvillimin e bujqësisë dhe pozita gjeografike ato që përcakttonin situatën demografike. Nga të dhënat e tabelave del se përqendrimi më i madh i popullsisë ishte në rrafshnaltat, në luginat e lumenjve e në viset kodrinore.

## SHTIMI I VENDBANIMEVE DHE I POPULLSISE NGA SHEK. XV NE SHEK. XVI

Për të parë më qartë se si paraqitet shtimi i vendbanimeve dhe i popullsisë duke kaluar nga shek. XV në shek. XVI po japim më poshtë të dhënat në formë të krahasuar:

### Uitësira e Shkodrës Sasia e fshatrave

Nahijet		Viti		Shtesa e fshatrave	Përqindja e rritjes së fshatrave nga viti 1485 në 1582
1485	1582	1485	1582		
1		2	3	4	
Shkodra		62	139	57	69.51
Drishti-Dushman-ili		12	28	16	133.33
Bregu i Këndejmë		5			
Bregu i Përtejme	Zabojana	5	55	37	205.56
Anamali		8			
Shestani		3	7	4	133.33
Zhabjaku		18	16	pakësim	kanë kaluar në
Podgorica		7	21	14	Podgoricë 200
Uitësira e Shkodrës		140	266	126	90

### Malësia e Shkodrës

Kuçi	8	12	4	50	
Petrishpani	30	36	6	20	
Kelmendi	2	3	1	50	
Hoti	9	8	pakësim		
Pipri	15	16	1	6.67	
Bjelopavliqi	3	6	3	100	
Malësia e Shkodrës		67	81	14	20.89

### Pjesa nga Rrafshi i Dukagjinit

Peja dhe Suhogërla	224	252	28	12.5	
Altun-Ilia	51	42	pakësim	—	
Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)		275	294	19	6.91

### Krahina e Bihorit

1	2	3	4	5
Komnini	32	32	—	—
Plava	15	18	3	20
Izla Rjeka	12	13	1	8.33
Komarani	15	23	8	53.33
<b>Krahina e Bihorit</b>	<b>74</b>	<b>86</b>	<b>12</b>	<b>16.21</b>

### Sanxhaku i Shkodrës

Sanxhaku i Shkodrës (gjithsej)	558	727	171	30.75
--------------------------------	-----	-----	-----	-------

### Ullësira e Shkodrës Sasia e shtëpive

Nahijet		Viti		Shtresa e shtëpive	Përqindja rritjes së shtëpive nga viti 1485 në 1582.
1485	1582	1485	1582		
1		2	3	4	
Shkodra		1187	4604	3417	287.87
Drishti — Dushman-ili		255	518	263	103.14
Bregu i Këndejmë	} Zabojana	155	1058	807	321.51
Bregu i Përtejme		63			
Anamali		33			
Shestani		74	164	90	121.62
Zhabjaku		307	358	51	16.61
Podgorica		95	1116	1021	1074.74
<b>Ullësira e Shkodrës</b>		<b>2169</b>	<b>7818</b>	<b>5649</b>	<b>260.44</b>

## Malësia e Shkodrës

1	2	3	4	5
Kuçi	253	271	18	7.11
Petrishpani	333	792	459	137.84
Kelmendi	153	70	pakësim	
Hoti	129	283	154	119.38
Pipri	452	503	51	11.28
Bjelopavliqi	159	443	284	179.75
<b>Malësia e Shkodrës</b>	<b>1479</b>	<b>2362</b>	<b>883</b>	<b>59.70</b>
<b>Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)</b>				
Peja dhe Suhogërla	5393	5858	465	8.62
Altun-ilia	1018	855	pakësim	
<b>Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)</b>	<b>6411</b>	<b>6713</b>	<b>302</b>	<b>4.71</b>
<b>Krahina e Bihorit</b>				
Komnini	696	715	19	2.73
Flava	1129	993	pakësim	
Izla Rjeka	260	353	93	35.77
Komarani	184	405	221	120.11
<b>Krahina e Bihorit</b>	<b>2269</b>	<b>2466</b>	<b>197</b>	<b>8.68</b>
<b>Sanxhaku i Shkodrës</b>				
<b>Sanxhaku i Shkodrës (gjithsej)</b>	<b>12323</b>	<b>19359</b>	<b>7031</b>	<b>57.03</b>

Duke kaluar nga shek. XV në shek. XVI, sanxhaku i Shkodrës i marrë në tërësi pati një rritje të sasisë së vendbanimeve (171), si dhe një shtesë të mirë të shtëpive (7031). Edhe secila zonë e marrë në veçanti pati rritje si të sasisë së vendbanimeve, ashtu edhe të numrit të shtëpive. Numri

i fshatrave u shtua, ndonëse në mënyrë jo të njëtrajtëshme, si në viset fushore, ashtu dhe në ato kodrinore dhe malorë. Pati zona ku shtimi kishte qënë i konsiderueshëm dhe zona ku ai ishte më i vogël. Ultësira e Shkodrës pati një rritje prej 126 vendbanimesh dhe 5649 shtëpish. Kjo është zona që ka rritjen më të madhe në krejt sanxhakun e Shkodrës. Shtim vendbanimesh dhe popullsie (dyfishim i sasisë së shtëpive) nuk mund të shpjegohet vetëm me shtimin natyror të popullsisë. Ai është i lidhur patjetër edhe me lëvizjet e popullsisë, me faktin se një sasi banorësh kishin zbritur nga Malësia dhe kishin zënë vend në fushë,<sup>1</sup> aty ku gjetën toka të lira e të mbetura bosh, me qëllim që ta siguronin me lehtësi jetën e tyre. Ndryshe nuk ka si shpjegohet një shtim aq i madh i asaj popullsie të paktë të mbetur aty në fillimet e pushtimit osman. Kjo rritje tregon qartë se pas mbarimit të luftimeve, gradualisht gjendja ishte stabilizuar, se popullsia e shpërndarë në pjesën më të madhe ishte kthyer në vendbanimet dhe kishte filluar, ndonëse në kushte të reja politike, jetën normale. Ekzistenca e tokave bujqësore të lira pas shponullimit që ndodhi në shek. XV, ishte një faktor që tërhohte aty popullsinë e viseve fqinje.

Në Malësinë e Shkodrës duke kaluar nga shek. XV në shek. XVI kemi një shtesë prej 14 vendbanimesh dhe prej 883 shtëpish. Në këtë zonë kemi të bëjmë përgjithësisht me një shtesë natyrore të popullsisë.

Nahijet e Kelmendit dhe të Pjprit shtohen me nga 1 vendbanim, e Bjelopavliqit me 3 vendbanime, e Kucit me 4 dhe ajo e Petrishpanit me 6, ndërsa nahija e Maleve të Hotit ka pakësim në numrin e vendbanimeve. Në Nahijen e Kelmendit vihet re edhe një pakësim i numrit të shtëpive nga 153 në 70. Shtimi jo i madh i popullsisë si në Pinër, Kuc, Hot, ose pakësimi i saj si në Kelmend, ishte pasoi e lëvizjes së banorëve nga trevat malore në ato fushore, nga Malësia e Shkodrës në Ultësinë e saj.

Pjesa e Rrafshit të Dukagjinit në kalimin nga regjistrimi i vitit 1485 në atë të vitit 1582 ka një shtesë prej 19 vendbanimesh dhe 382 shtëpish, e cila ka të bëjë thjesht me një shtim natyror të popullsisë. Shtimi i paktë i numrit

---

1) S. Pulaha, *Kontribut për studimin e ngulitjes së katuneve dhe krijimin e fiseve në Shqipërinë e Veriut në shek. XV-XVI*. «Studime historike», 1975/1.

të shtëpive në këtë zonë, edhe pse kushtet ishin të favorshme, tregon se këtu ka pasur përqendrim popullsisë që në shek. XV. Nahija e Pejës ka një rritje prej 28 vendbanimesh dhe 465 shtëpish, ndërsa nahija e Altun-ilisë ka rënie si në numrin e vendbanimeve, ashtu edhe në sasinë e shtëpive. Për popullsinë e këtyre trevave duhet pasur parasysh se humbja e pozitës sunduese të shtetit serb nuk kaloi pa lënë gjurmë në gjendjen demografike. Në kushtet e shkatërrimit përfundimtar të aparatit shtetëror serb dhe përforcimit të administratës osmane është e natyrshme që të ketë pasur ikje të feudalëve serbë që përbënin këtu më parë shumicën e klasës feudale, si dhe të elementëve nga pakica serbe, meqenëse tashmë për ta ishin krijuar kushte jo të favorshme me rënien e shtetit serb, me dobësimin e pozitës mbizotëruese të kishës ortodokse serbe dhe përhapjen e procesit të islamizimit.<sup>1</sup> Ndryshe nga sa ndodhi në Ulëtisrën dhe Malësinë e Shkodrës, në këto zona kemi një rritje më të madhe të numrit të vendbanimeve (6.91<sup>0</sup>%) në krahasim me shtimin e sasisë së shtëpive (4.71<sup>0</sup>%).

Në krahinën e Bihorit numri i vendbanimeve ishte shtuar 16.21<sup>0</sup>% dhe sasia e shtëpive 8.68<sup>0</sup>%. Edhe këtu përcindia e shtimit të shtëpive është më e vogël sesa ajo e vendbanimeve.

Si nërfundim në të gjitha zonat e sanxhakut të Shkodrës nati shtim të numrit të shtëpive e të vendbanimeve, navarësisht nga specifikat e veranta të shtimit për çdo zonë, ku ndikimi i faktorëve objektivë kishte nënë i ndryshëm dhe rrjedhimisht kishte bërë që përcindiet e shtimit të ndryshonin nga njëri vend në tjetrin, dhe të mos ishin unike për gjithë trevat.

Zbulimi i gjendjes demografike duhet parë e studiuar në tërë kompleksitetin e vet. Ajo bëhet edhe më e qartë në të shqyrtojmë nëpërmjet materialit që zotërojmë edhe dendësinë e popullsisë në raport me sipërfaqen e vendit. Sipas të dhënave të defterëve të viteve 1485 dhe 1582 dendësia paraqitet si më poshtë:

---

1) S. Pulaha, *Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shek. XV-XVI*, në «Studime historike», 1983, nr. 3.

### Sanxhaku i Shkodrës

	1485			1582		
	Sasia e shtëpive	Sipërfaqja në km <sup>2</sup>	Shtëpi për km <sup>2</sup>	Sasia e shtëpive	Sipërfaqja për km <sup>2</sup>	Shtëpi për km <sup>2</sup>
Ultësira e Shkodrës	2169	930	2.3	7818	930	8.4
Malësia e Shkodrës	1479	750	2	2362	750	3.1
Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	6411	1260	5.1	6713	1260	5.3
Krahina e Bihorit	2269	590	3.8	2466	590	4.2
Për gjithë sanxhakun e Shkodrës	12328	3530	3.5	19359	3530	5.5

Në shek. XV dendësinë më të madhe të shtëpive për km<sup>2</sup> e kishte Rrafshi i Dukagjinit (5.1 shtëpi për km<sup>2</sup>), ndërsa më të vogël Malësia e Shkodrës (2 shtëpi për km<sup>2</sup>). Ultësira e Shkodrës kishte një dendësi mesatare të ulët (2.3 shtëpi për km<sup>2</sup>).

Në shek. XVI, në kushtet e stabilizimit të gjendjes politike dhe ekonomike nën sundimin osman, dendësia e popullsisë ishte rritur në të gjitha zonat. Rritje më e madhe konstatohet në Ultësirën e Shkodrës (8.4 shtëpi për km<sup>2</sup>). Pas saj vinin Rrafshi i Dukagjinit (5.3 shtëpi për km<sup>2</sup>), krahina e Bihorit (4.2 shtëpi për km<sup>2</sup>). Dendësinë mesatare më të ulët vazhdoi ta kishte Malësia e Shkodrës. Dendësia e popullsisë nuk kishte një pamje unitare në krejt sanxhakun e Shkodrës, diku ishte më e madhe dhe diku më e vogël, në përputhje me kushtet ekonomike e gjeografike të terrenit dhe herë-herë dhe me rrethanat politike.

Më poshtë po japim të dhënat për shtimin e fshatrave dhe të shtëpive nga shek. XV në shek. XVI dhe në mënyrë më të hollësishme gjendjen për fshatrat që patën shtim ose pakësim popullsie.

Fshatra që vazhduan jetën në shek. XV deri në shek. XVI

Nahijet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Shkodra	Sasia e fshaduan jetën në shek. XV-XVI	69	56	872	2790	1918	13	398	288	110	11
Dushman-ili	Sasia e fshaduan jetën në shek. XV	9	5	67	157	90	4	68	44	24	
Zabojana	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	18	18	160	617	457	—	—	—	—	
Shestani	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	3	2	31	71	40	1	43	23	20	
Podgorica	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	12	11	249	1020	771	1	15	11	4	
Zhabjaku	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	10	8	106	288	182	2	22	12	10	
Uitësira e Shkodrës	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	121	100	1485	4943	3458	21	546	378	168	
Hoti	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	8	7	119	266	147	1	20	17	3	
Bjelopavliqi	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	1	1	35	127	92	—	—	—	—	
Pipri	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	4	3	95	129	34	1	39	19	20	
Kelmendi	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	2	—	—	—	—	2	152	70	82	
Kuçi	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	8	4	52	86	34	4	213	126	87	
Malësia e Shkodrës	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	23	15	301	608	307	8	424	232	192	
Peja-Suhogërja	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	177	88	1859	2831	972	89	2687	1656	1031	
Altun-ilia	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	42	22	376	589	213	20	488	333	155	
Brafshi i Dukagjinit (një pjesë)	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	219	110	2235	3420	1185	109	3175	1989	1186	
Komnini	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	27	13	267	409	142	14	397	236	161	
Komarani	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	17	16	161	314	153	1	25	10	15	
Plava	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	14	3	192	239	47	11	894	454	440	
Izla Rjeka	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	12	7	115	183	68	5	140	108	32	
Krahina e Bihorit	Sasia e shtëpive të fshaduan jetën në shek. XVI	70	39	735	1145	410	31	1456	808	648	
Shuma:		433	264	4756	10116	5360	169	5601	3407	2194	



Pjesa më e madhe e vendbanimeve e kishin vazhduar jetën. Kështu në Ultësirën e Shkodrës nga 140 fshatra që përmendëm në regjistrimin e vitit 1485 ruajtën vijueshmërinë e tyre në shek. XVI 121 prej tyre, në Malësinë e Shkodrës nga 37 fshatra<sup>1</sup> 23, në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit nga 275 më 219, në krahinën e Bihorit nga 74 fshatra në 70. Krahas fshatrave që vazhduan jetën pati edhe vendbanime të shek. XV, të cilat në shek. XVI kthehen në truallishte (mezraa). Të tilla janë Manes (me 3 shtëpi), Mosil (me 4 shtëpi), Poshtërkuzë (me 4 shtëpi) në nahijen e Shkodrës; Gorica (me 2 shtëpi) në nahijen e Zabojanës; Bobod (me 5 shtëpi) në nahijen e Podgoricës; Bushat (me 1 shtëpi), Vranina (me 2 shtëpi) në nahijen e Zhabjakut; Istrahaliq (me 63 shtëpi) në nahijen e Piprit; Zahaq (me 5 shtëpi), Drovdil (me 6 shtëpi), Dolina Kalicani (me 3 shtëpi), në nahijen e Pejës; Shushica (me 33 shtëpi). Pustina Joshaniça (Joshanica) (me 10 shtëpi), Gorna Nekrovac (me 4 shtëpi) në nahijen e Suhogërlës; Kamenica (me 9 shtëpi), Dobroshi i vogël (me 6 shtëpi), Bredad (me 9 shtëpi) dhe Rogam (me 8 shtëpi) në nahijen e Altun-ilisë. Në përgjithësi në shek. XVI janë bërë të pabanuara ato vendbanime që në shekullin e mëparshëm në bazë të regjistrimit të vitit 1485 kishin një numër të kufizuar shtëpish. Ky fakt le të kuptohet se fshatarët i braktisnin ato dhe vendoseshin gjetiu, ku tokat ishin më të mira. Në braktisjen e vendbanimeve ka pasur edhe ndonjë arsye tjetër. P.sh. për fshatin Istrahaliq të nahijes së Piprit (me 63 shtëpi), arsye ishte largimi i banorëve nga Malësia dhe vendosja e tyre në fushë. Shkurt mund të thuhet se dukuria e braktisjes së disa vendbanimeve në shek. XVI ishte pasojë e veprimit të faktorëve ekonomikë.

Numri i fshatrave që e vazhduan jetën nga shek. XV në shek. XVI për krejt sanxhakun e Shkodrës, pa përfshirë këtu nahijet e Petrishpanit e të Ivrazha Grencit, për të cilat kemi folur më sipër, arrin në 433. Nga këto 264 fshatra janë vendbanime që e rrisin numrin e shtëpive dhe 169 që e pakësojnë atë. Në lidhje me pakësimin e sasisë të shtëpive brenda fshatit duhet të mos lihet në harresë edhe fakti se ka fshatra që si rezultat i zmadhimit të tyre me

1) Pa përfshirë këtu Pietërshpanin me 30 vendbanime, pasi sasinë e shtëpive për fshat të tij nuk e kemi në shek. XVI për të bërë krahasimin.

kalimin e kohës degëzohen në dy fshatra më vete, dhe fillimisht sasia e numrit të shtëpive të secilit prej këtyre të marra veças ishte më e vogël sesa e të parit. Fshatrat që vazhduan jetën në pjesën më të madhe e kanë rritur sasinë e shtëpive e në mënyrë të veçantë vendbanimet e Ultësirës së Shkodrës. Këtu numërohen 121 fshatra që patën vazhdimësi, prej të cilave 100 kishin rritje të numrit të shtëpive dhe vetëm 21 kishin pakësim.

Krahas rritjes së numrit të vendbanimeve duke kaluar nga shek. XV në shek. XVI ishte rritur edhe numri i shtëpive. Në fshatrat që vazhduan jetën nga njëri shekull në tjetrin në krejt sanxhakun e Shkodrës sasia e shtëpive nga 10357 arrin në 13523, pra kemi një rritje prej 3166 shtëpish. Rritjen më të madhe, ashtu si edhe për vendbanimet, e shënon Ultësira e Shkodrës. Këtu fshatrat që patën vazhdimësi nga 2031 shtëpi arritën në 5321. Për sa u përket fshatrave që kanë vazhdimësi dhe që rrisin numrin e shtëpive në krejt sanxhakun e Shkodrës sasia e shtëpive të shtuara nga regjistrimi i vitit 1485 në atë të vitit 1582 arrin në 5360, kurse për fshatrat që kanë rënie në numrin e shtëpive sasia e shtëpive të pakësuara është 2194. Pra sasia e shtëpive të shtuara në shek. XVI është gati dy herë e gjysmë më e madhe sesa sasia e shtëpive të pakësuara. Nahija e Kelmendit në krejt sanxhakun e Shkodrës është e vetmja nahije që nuk ka asnjë vendbanim që të rrisë numrin e shtëpive. Sipas regjistrimit të vitit 1497 ajo kishte 2 fshatra, që në shek. XVI e pakësojnë numrin e shtëpive (nga 152 shtëpi mbetën 70). Ky pakësim i popullsisë ishte pasojë e lëvizjes së saj nga Malësia në Fushë. Në asnjë nahije të zonave të tjera të sanxhakut të Shkodrës nuk vërehet një fenomen i tillë.

Pavarësisht nga specifika e nahijeve të veçanta, në përgjithësi, në krejt sanxhakun e Shkodrës, përsa u takon fshatrave që e vazhdojnë jetën nga shek. XV në shek. XVI, sasia e fshatrave që kanë rritje të numrit të shtëpive është më e madhe në krahasim me fshatrat që e pakësojnë numrin e shtëpive. Po kështu sasia e shtëpive që shtohen në kuadrin e vendbanimeve është më e madhe, sesa sasia e shtëpive që pakësohen. Shtimi i numrit të shtëpive brenda fshatit sjell me vete shtimin e banorëve, me fjalë të tjera rritet popullsia. Nga shqyrtimi i materialit në tërësi lidhur me

vendbanimet rezulton se në të gjitha zonat e sanxhakut të Shkodrës kemi pasur shtim të numrit të shtëpive dhe bashkë me të shtim të popullsisë në përgjithësi.

Duke nxjerrë në pah gjendjen e vendbanimeve, vazhdimësinë e tyre, shtimin e numrit të shtëpive brenda fshatit, krijimin e vendbanimeve të reja, si dhe zhdukjen e disave nën veprimin e faktorëve ekonomikë, politikë e shoqërorë, zbulohet në mënyrë të qartë rruga që ndoqi zhvillimi i tyre. Edhe pse pushtimi osman solli pengesa e vështirësi të cilat e ngadalësuan dhe e frenuan zhvillimin e tyre në momente të caktuara, ato nuk ngelën në vend por përkundrazi ecën përpara. Në fund të shek. XVI forcat njerëzore ishin rigjallëruar. Pushtimi nuk mund ta ndalte këtë proces, ashtu si dhe gjithë zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të vendit.

Krahas fshatrave edhe qytetet në këtë zonë ecën në rrugën e zhvillimit. Edhe ato i ndjenë pasoiat negative të pushtimit osman, në mënyrë të vecantë Shkodra, së cilës iu desh t'u bënte ballë dy rrethimeve të njëpasnjëshme të forcave ushtarake të Perandorisë Osmane. Këto pasoja si dhe emigracioni në Itali e gjetkë u shfaqën edhe në aspektin demografik. Në fillimet e pushtimit qytetet ishin shpopulluar dhe kishin një numër shumë të vogël banorësh. Vetëm pas kalimit të një shekulli, me rigjallërimin e jetës ekonomike ato e rimarrin veten dhe popullsia e tyre shtohet. Sipas regjistrimeve osmane sasia e banorëve paraqitet e tillë.<sup>1</sup>

Qytetet	Sasia e shtëpive		Shtimi në përqindje
	1485	1582	
1. Shkodra	80	282	252.5
2. Peja	133	158	14.4
3. Drishti	16	35	118.7
4. Zhabjaku	30	58	93.3
5. Meduni	15	11	26.7 (pakësim)

Popullsia qytetare ishte e paktë në krahasim me atë të fshatrave. Numri i qyteteve në shek. XV, XVI qe i kufizuar.

1) Të dhënat janë nxjerrë nga S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, f. 651-653.

Nga i gjithë sanxhaku Shkodra dhe Peja kishin një sasi të konsiderueshme shtëpish, kurse qytetet e tjera ishin të vogla, me një numër të kufizuar familjesh. Duke i ndjekur qytetet nga shek. XV në shek. XVI konstatojmë se ato ishin rritur me shpejtësi nga pikëpamja demografike.

### KREU III

## EKONOMIA BUJQËSORE NË TREVAT E SANXHAKUT TË SHKODRËS GJATË SHEK. XV

### 1. KULTURAT BUJQËSORE DHE VENDI I TYRE NË PRODHIMIN E PËRGJITHSHËM

Siç e kemi theksuar regjistrat kadastralë na japin një pasqyrë të hollësishme të detyrimeve në natyrë dhe në të holla që nxirreshin nga çdo fshat. Për periudhën e sundimit venedikas në përgjithësi shlyerja e detyrimeve bëhej në mënyrë fikse nga çdo shtëpi, pjesërisht në të holla e pjesërisht në prodhime bujqësore, sikurse gruri, meli, rrushi, që ishin kulturat më të përdorshme. Megjithatë kjo nuk na lejon të nxjerrim tërësinë dhe shumëllojshmërinë e kulturave bujqësore që mbilleshin gjatë kësaj kohe në zonën e Shkodrës.

Në dallim nga periudha e sundimit venedikas, pas pushtimit osman, fshatarësia i shlyente detyrimet në natyrë në bazë të sistemit të së dhjetës së prodhimeve bujqësore. Kjo ka krijuar mundësi që në defterin kadastral osman, siç është ai i vitit 1485, të gjenden të regjistruara të dhjetat që parashikoheshin të vilte spahiu për çdo kulturë bujqësore

duke dhënë sasinë e tyre në peshë dhe vlerën e shprehur në akçe. Nëpërmjet listës së gjatë të tatimeve sillen dëshmi për kulturat bujqësore që mbilleshin e përdroreshin nga fshatari ynë. Gjithashtu në bazë të masës së detyrimit që paguante fshatari në njërin apo tjetrën kulturë na jepet mundësia të hetojmë për vendin që zenë kulturat bujqësore në veçanti, si dhe në raport me njëra-tjetrën.

Këto të dhëna e bëjnë defterin osman të vitit 1485 shumë të rëndësishëm për temën në studim. Megjithatë edhe në këtë burim vërehen mangësi. Ka raste që për fshatra të tëra, ndonjëherë edhe për nahije të tëra, që paguanin rentën feudale në formë fikse në bazë të sistemit të florixhinjve, të derbendxhinjve dhe të vllëhëve (eflak) në defter nuk janë shënuar të dhjetat nga kulturat bujqësore, por vetëm shuma e detyrimit fiks që i paguhej spahiut. Si rrjedhim nuk jepen të dhëna për kulturat bujqësore. Të tilla janë në *Ultësirën e Shkodrës*: nahija e Bregut të Përtejme, e Shestanit, krahina e Anamalit dhe e maleve Mjet, e Podgoricës dhe e Zhabjakut me përjashtim të fshatit Dajbaba; në *Malësinë e Shkodrës*, nahija e Kuçit, e Petrishpanit, e Hotit, Bjelopavliqit, e Komaranit etj. Për këto zona nuk mund të bëhen analiza të veçanta, prandaj edhe nuk i kemi përfshirë në përlogaritjet tona.

Mangësi tjetër është edhe fakti se për një varg fshatrash nuk është regjistruar më vete çdo kulturë bujqësore, por janë regjistruar së toku dy a më shumë kultura. P.sh. taksa e perimeve ose taksa e frutave, pa dhënë të zëbra të veçanta për frutave që përfshinin. Të dhënat e defterit bëjnë fjalë edhe për fshatra, tokat e të cilëve punoheshin e mbilleshin nga banorë të jashtëm që herë i numërojnë kulturat bujqësore e herë jo. Me gjithë kufizimet që paraqesin, këto burime japin mundësi që të studiohet ekonomia bujqësore në fshat për pjesën më të madhe të vendit.

\* \* \*

Së pari le të njihemi sipas zonave të veçanta, me llojin e kulturave bujqësore që prodhoheshin dhe me vendin që zinin ato në prodhimin e përgjithshëm dhe në atë bujqësor në

veçanti. Këtu do të përpiqemi të zbulojmë nëpërmjet raportit të të ardhurave të çdo kulture bujqësore me sasinë totale të të ardhurave të rentës në dobi të feudalëve të veçantë spahinj, të cilat fshatari i siguronte nga të ardhurat e bujqësisë e të blegtorisë në tërësi, si dhe të raportit me pjesën e rentës që feudali siguronte vetëm nga prodhimet bujqësore (e dhjeta).\* Për t'i parë ato më nga afër dhe në lidhje të ngushtë me terrenin, kemi ndjekur po atë ndarje të sanxhakut në katër zona: Ultësira e Shkodrës, Malësia e Shkodrës, Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë e tij) dhe krahinë e Bihorit, siç vepruam edhe për ndriçimin e gjendjes demografike. Ultësirën e Shkodrës për studim më të thellë e kemi ndarë në dy nënzona në përputhje me veçoritë e terrenit. Nënzona e ulët e Shkodrës që përfshin Shkodrën, Drishtin, Bregun e Këndejmë dhe Bregun e Përtejme dhe nënzonën e dytë që përfshin nahijet e Merkodit, Krajës, Shestanit, Anamalit dhe malet Mjet.

**Ultësira e Shkodrës.** Në pjesën me terren tërësisht fushor të kësaj krahine, të përbërë nga nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Përtejme e të Këndejmë, prodhimet kryesore bujqësore nga drithërat ishin, gruri, thekra, meli, elbi, okra etj., nga perimet: batha, thjerrëza, qepa, spinaqi etj.; nga frutat kumbulla, fiqtë, gështenjat, arrat etj.; dhe në mënyrë të veçantë rrushi, i cili jo vetëm përdorej si frut i freskët, por edhe përpunohej duke nxjerrë prodhime të ndryshme si verë, musht, raki, Vendin kryesor midis prodhimeve e zinin drithërat. Kjo duket nga fakti se të ardhurat nga e dhjeta e tyre (78112.5 akçe) zinin rreth 45.01 për qind të rentës në dobi të spahiut (173551.5 akçe) dhe 59.44 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore (131408.5 akçe).

Në këtë zonë gruri përbënte kulturën më të rëndësishme që kishte shtrirjen dhe përdorimin më të madh. Të ardhurat prej tij ishin më të mëdha se ato nga drithërat e tjera të marra së bashku, nga perimet, nga pemëtaria, nga rrushi dhe prodhimet e tij, nga bimë të ndryshme për prodhim zejtar, nga kullotat.

Raporti i kulturave bujqësore në nënzonën e parë të Ultësirës së Shkodrës më hollësisht paraqitet si më poshtë:

---

\*) Tabelat që pasqyrojnë hollësisht vendin e kulturave në prodhimin bujqësor në përgjithësi do t'i japim në paragrafin e dytë të këtij kapitulli, ku do të paraqitim vendin që zinte çdo grup kulture në prodhimin bujqësor.

## Ulësira e Shkodrës

### Nahijet e Shkodrës, e Drishtit, e Bregut të Këndejmë

Nr.	Drithërat	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi në prodhimin bujqësor të zonës (131408,5 akçe)	Vendi që zë në rentën spahiore (173551.5 akçe)	Vendi që zë në grup-kulturë.
1	2	3	4	5	6
1. Grurë		41 932	31.91	24.16	53.68
2. Thekër		1 385	1.05	0.80	1.77
3. Elb dhe tagji etj.		33 012.5	25.2	19.02	42.26
4. Mel		510	0.38	0.29	0.65
5. Tagji		1 273	0.96	0.73	1.63
<b>Shuma:</b>		<b>78 112.5</b>	<b>59.44</b>	<b>45.01</b>	
<b>Perime</b>					
1. Perime		1 977	1.50	1.14	45.76
2. Bathë dhe kumbulla		1 074	0.82	0.62	24.86
3. Bathë		905	0.69	0.52	20.95
4. Thjerrëza		360	0.27	0.21	8.33
5. Qepë dhe spinaq		4	0.003	0.002	0.09
<b>Shuma:</b>		<b>4 320</b>	<b>3.29</b>	<b>2.49</b>	
<b>Fruta</b>					
1. Ullinj		300	0.22	0.17	56.28
2. Kumbulla		120	0.09	0.07	22.51
3. Fiq		100	0.08	0.06	18.76
4. Gështenja		10	0.008	0.006	1.88
5. Arra		3	0.003	0.002	0.56
<b>Shuma:</b>		<b>533</b>	<b>0.41</b>	<b>0.31</b>	



1	2	3	4	5	6
1. Musht		41 210	31.36	23.74	95.80
2. Taksa e govatës		1 505	1.14	0.87	3.50
3. Taksa e fuçisë		300	0.22	0.17	0.70
<b>Shuma:</b>		<b>43 015</b>	<b>32.73</b>	<b>24.79</b>	

Bimë të ndryshme për  
prodhim zejtar:

1. Liri	1 193	0.91	0.69
---------	-------	------	------

Nga ekonomitë personale të feudalëve (hasa)

1	2	3	4	5	6
1. Vreshta hasa		3210	2.44	1.85	
2. Fiq hasa		525	0.39	0.30	
3. Ullinj hasa		300	0.22	0.17	
4. Mullinj uji hasa		200	0.2	0.11	
<b>Shuma:</b>		<b>4235</b>	<b>3.22</b>	<b>2.44</b>	

Shuma e prodhimit bujqësor 131408.5 akçe

Kullota:

1. Taksa e barit	5463.5	3.15	99.63
2. Livashi	20	0.01	0.36
<b>Shuma:</b>	<b>5483.5</b>	<b>3.16</b>	

1	Taksa të ndryshme në natyrë	3	4	5	6
1.	Taksa e druve	2191		1.26	
2.	Taksa e bletëve	1535		0.88	
3.	E dhjeta e peshkut	300		0.17	
Shuma:		4026		2.32	

1	Taksa të ndryshme në të holla:	3	4	5	6
1.	Bidati i derrave	978.5		0.58	
1.	Nijabeti dhe taksa e gjerdekut	1331		0.77	
1.	Ispexhe	30324		17.47	

Renta spahiore gjithsej 173551.5 akçe

Në nënzonën e Ultësirës së Shkodrës (nahijet e Merkodit e të Krajës) që karakterizohet nga një terren fushor dhe kodrinor, të ardhurat nga e dhjeta e drithërave (5630 akçe) zinin 25.4 për qind të rentës spahiore (22 118 akçe), dhe 46.21 për qind të të ardhurave të prodh. bujqësore (12184 akçe), kurse të ardhurat nga prodhimet e rrushit (6164) zinin 27.9 për qind të saj. Pra të ardhurat nga prodhimet e rrushit zinin vendin e parë, kurse ato nga drithërat zinin vendin e dytë. Më hollësisht raporti i kulturave bujqësore në këtë nënzonë paraqitet si më poshtë:

## Ultësira e Shkodrës

### Nahijet e Merkodit dhe të Krajës

Nr.	Drithëra	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta	Vendi në prodhimin bujq. të zonës (12184 akçe)	Vendi që zë në rentën spahiore 22118	Vendi që zë në grup-kulturë
1	2	3	4	5	6
1.	Grurë	2800	22.98	12.66	49.73
2.	Thekër	1550	12.72	7.01	27.53
3.	Elb dhe tagji etj.	1280	10.50	5.79	22.74
<b>Shuma:</b>		<b>5630</b>	<b>46.21</b>	<b>25.45</b>	
<b>Perime</b>					
1.	Perime	280	2.30	1.26	
<b>Fruta</b>					
1.	Fiq	60	0.49	0.27	
<b>Prodhime rrushi</b>					
1.	Musht	5464	44.85	24.7	88.64
2.	Taksa e govatës	700	5.74	3.16	11.36
<b>Shuma:</b>		<b>6164</b>	<b>50.59</b>	<b>27.87</b>	
<b>Bimë të ndryshme për prodhim zejtar</b>					
1.	Liri	50	0.41	0.23	
<b>Shuma e prodhimit bujqësor 12184 akçe</b>					

Kullota	3	4	5	6
1. Taksa e barit	1420		6.42	
Taksa të ndryshme në natyrë				
1. Taksa e druve	564		2.55	
1 Taksa të ndryshme në të holla				
1. Bidadi i derrave	100		0.45	
1. Ispenxhe	7850		35.49	
Renta spahiore gjithsej: 22118				

Të dhënat që parashtruan na japin një tablo mjaft të qartë të kulturave bujqësore për Ultësirën e Shkodrës të marrë në tërësi. Fshatari bujk i kësaj zone ishte njohës i shumë kulturave bujqësore. Si trashëgimtar i strukturës së vendeve të caktuara për çdo lloj kulture, që ekzistonte nga e kaluara e lashtë dhe me përvojën e nxjerrë nga puna e përditshme ai dinte të përcaktonte jo vetëm vendin e kulturave të veçanta sipas terrenit, por edhe sasinë për plotësimin e nevojave të veçta dhe të kërkesave të tregut.

Në Ultësirën e Shkodrës të marrë në tërësi vendin kryesor midis kulturave bujqësore e zinin drithërat. Të ardhurat prej këtyre (84107.5 akçe) formonin afro 42.57 për qind të të ardhurave në rentën spahiore dhe 58.25, për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor (144383.5 akçe). Në vetë drithërat vendin më të rëndësishëm e zinte gruri. të ardhurat prej të cilit (44972 akçe) formonin më shumë se gjysmën e të ardhurave nga drithërat. dhe afro 22.6 për qind të të ardhurave totale të rentës spahinore e 30 për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor.

Pas drithërave vend të rëndësishëm zinte vreshtaria. Në zona të veçanta rrushi kishte një përdorim të gjerë, jo vetëm si frut i freskët, por edhe për prodhime të tjera si musht, verë, raki. Në krahina të veçanta të ardhurat nga vreshtat ua kalonin atyre të drithërave si p.sh. në nahijet e Merkodit, të Krajës e të Zhabjakut. Të dhëna më të hollësishme për kulturat bujqësore në veçanti për tërë Ultësirën e Shkodrës japin tabelat më poshtë:

### Ultësira e Shkodrës

(Nënzona e I + II)

Nr.	Drithërat	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi në prodh. bujq. të zonës (143592.5 akçe)	Vendi që zë në rentën spahiore 195669.5 akçe	Vendi që zë në grup-kulturë
1	2	3	4	5	6
1.	Grurë	44732	31.15	22.86	53.42
2.	Thekër	2935	2.04	1.50	3.50
3.	Elb dhe tagji etj.	34292.5	23.88	17.53	40.95
4.	Mel	510	0.35	0.26	0.61
5.	Tagji	1273	0.89	0.65	1.52
Shuma:		83742.5	58.32	42.80	100%
Perime					
1.	Perime	2257	1.57	1.15	49.06
2.	Bathë dhe kumbulla	1074	0.74	0.55	23.35
3.	Bathë	905	0.63	0.46	19.67
4.	Thjerrëza	360	0.25	0.19	7.83
5.	Qepë, spinaq	4	0.003	0.002	0.08
Shuma:		4600	3.20	2.35	100%

Fruta	3	4	5	6
1. Ullinj	300	0.20	0.15	50.59
2. Kumbulla	120	0.08	0.06	20.24
3. Fiq	160	0.11	0.09	28.98
4. Gështenja	10	0.007	0.005	1.60
5. Arra	3	0.002	0.001	0.50
<b>Shuma:</b>	<b>593</b>	<b>0.41</b>	<b>0.3</b>	<b>100%</b>

#### Prodhime rrushi

1. Musht	46674	32.50	23.85	94.91
2. Taksa e govatës	2205	1.53	1.13	4.48
3. Taksa e fuçisë	300	0.20	0.15	0.61
<b>Shuma:</b>	<b>49179</b>	<b>34.25</b>	<b>25.13</b>	<b>100%</b>

#### II. Bimë të ndryshme për prodhim zejtar

1. Liri	1243	0.86	0.63	
Nga ekonomitë personale të feudalëve (hasa)				
1. Vreshta (hasa)	3210	2.23	1.64	75.80
2. Fiq (hasa)	525	0.36	0.26	12.40
3. Ullinj (hasa)	300	0.20	0.15	7.08
4. Mëllinj uji (hasa)	200	0.14	0.01	4.72
<b>Shuma:</b>	<b>4235</b>	<b>2.94</b>	<b>2.16</b>	<b>100%</b>

#### Shuma e prodhimit bujqësor 143592.5 akçe

##### Kullota

1. Taksa e barit	6883.5		3.51	99.7
2. Eivadhi	20		0.01	0.3
<b>Shuma:</b>	<b>6903.5</b>		<b>3.52</b>	<b>100%</b>

1	Taksa të ndryshme në natyrë	3	4	5	6
1.	Taksa e druve	2755		1.41	60.02
2.	Taksa e bletëve	1535		0.78	33.44
3.	E dhjeta e peshkut	300		0.15	6.54
Shuma:		4590		2.34	100%

Taksa të ndryshme në të hojla

1.	Bidati i derrave	1078.5		0.55	
2.	Nijabeti dhe taksa e gjerdekut	1331		0.68	
Ispenxhe		38174		19.51	

Renta spahiore gjithsej 195669.5 akçe

**Në Malësinë e Shkodrës** me një terren kodrinor e kryesisht malor të përfshirë në nahijet e Kelmendit dhe Piprit<sup>1</sup> banorët krahas blegtorisë merreshin edhe me bujqësi. Kjo dëshmohet nga fakti se për çdo vendbanim në defterin e 1485 krahas taksës së dhurve, e cila zinte një vend të rëndësishëm në rentën feudale, janë dhënë edhe të ardhurat nga prodhimet e atyshme bujqësore. Nga këto del se mbilleshin një numër shumë i kufizuar kulturash, ndryshe nga sa paraqitej gjendja në zonën e ulët të Shkodrës, gjë që kushtëzohej nga terreni malor i vendit dhe mungesa e tokave të punueshme. Nga drithërat kultivoheshin kryesisht gruri dhe elbi. Në një masë

1) Për trevat e tjera të kësaj malësie të përfshira në nahijen e Pjetër Spanit, renta ishte shlyer në formë globale (përfshihen në statusin e florixhinjve), gjë që nuk jep mundësi t'i shqyrtojmë kulturat që mbilleshin aty.

të vogël rrushi, gjë që kuptohet nga të ardhurat e pakta që vinin nga taksa e mushtit. Në të ardhurat nuk përmenden perimet, drurët frutorë etj. Më hollësisht kulturat bujqësore për këtë zonë po i paraqesim më poshtë:

**Malësia e Mbishkodrës**  
(Nahijet e Kelmendit dhe të Piprit 1497)

Nr.	Drithëra	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në të ardhura nga bujqësia 1834 akçe	Vendi që zë rentën spa-hiore 22499 akçe, pa taksën e dhëve	Vendi që zë në grup-kulturë
1	2	3	4	5	6
1. Grurë		708	38.60	3.15	41.31
2. Elb		691	37.68	3.07	40.32
3. Tagji		315	17.17	1.40	18.38
<b>Shuma:</b>		<b>1714</b>	<b>93.46</b>	<b>7.62</b>	
<b>Prodhime të rrushit</b>					
1. Musht		120	6.54	0.53	
<b>Shuma e prodhimit bujqësor 1834 akçe</b>					
<b>Taksa të ndryshme në natyrë</b>					
1. Taksa e bletëve		23		0.1	
<b>Taksa të ndryshme në të holla</b>					
1. Bidati i egërsirave		16		0.07	
2. Mullinj guri		60		0.27	
<b>Shuma:</b>		<b>76</b>		<b>0.34</b>	



Taksa të ndryshme dhe gjoba në të holla

1.Nijabeti, taksa e martesës  
dhe badihavatë

2023

8.99

1	2	3	4	5	6
---	---	---	---	---	---

1. Ispenxhe

18543

82.42

Blegtoria

1. Taksa e dhenve

1901

8.45

Renta spahiore gjithsej 22499 akçe

Në Rrafshin e Dukagjinit, ku përfshiheshin nahijet e Pejës, të Suhogërlës dhe të Altun-ilisë, me toka mjaft pjellore, kishte një shumëllojshmëri kulturash. Mund të thuhet se kjo zonë ka llojshmërinë më të madhe të kulturave bujqësore në krahasim me trevat e tjera. Nga drithërat kultivohej gruri, thekra, elbi, okra, ujemi etj., nga perimet: qepa, spinaqi, bathët, thjerrëza, burçaku, dhe perime të tjera; nga pemët: gështenja, arrat, kumbulla, qershitë; mollët etj.

Në këtë zonë vendin më kryesor e zinin drithërat, prej të cilave vileshin shumë të ardhura (290 329 akçe) që formonin 28.8 për qind të të ardhurave të rentës spahiore (923 338 akçe) dhe 44.32 për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor (655053 akçe). Në to kultura më e përhapur ishte gruri që zinte 46.75 për qind të të ardhurave nga drithërat, thekra 17 për qind, elbi 16.2 për qind, tagji e okër 12 për qind, mel 6.5 për qind etj. Të ardhurat nga gruri ishin disa herë më të mëdha sesa nga çdo kulturë tjetër e marrë në veçanti. Pas drithërave më tepër ishte e zhvilluar vreshtaria. Nga prodhimet e rrushit nxirreshin 27.7 për qind (278 530 akçe) e të ardhurave totale të rentës spahiore. Shumëllojshmëria e kulturave bujqësore në këtë zonë, dëshmon për një nivel relativisht të lartë të zhvillimit të bujqësisë për kohën. Më hollësisht po paraqesim raportin e kulturave bujqësore për këtë zonë:

Nr.	Drithërat	Sasia e të ardhurave nga e dhjetat	Vendi që zë në të ardhurat nga bujqësia, 655053 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 923338 akçe	Vendi që zë në grup-kulturë
1	2	3	4	5	6
1.	Grurë	135 739	20.72	14.70	46.75
2.	Thekër	49 342	7.53	5.34	16.99
3.	Elb dhe të tjera	47 245	7.21	5.11	16.27
4.	Tagji dhe okër	34 897	5.32	3.77	12.02
5.	Tagji dhe të tjera	662	0.10	0.07	0.23
6.	Mel	18 985	2.89	2.06	6.54
7.	Ujem	944	0.14	0.10	0.32
8.	Grurë nga të jashtmit	360	0.05	0.04	0.12
9.	Thekër nga të jashtmit	280	0.04	0.03	0.10
10.	Elb nga të jashtmit	128	0.01	0.01	0.04
11.	Okër nga të jashtmit	28	0.004	0.003	0.01
12.	Të dhjetat nga të jashtmit	1719	0.26	0.19	0.59
Shuma:		290329	44.32	31.44	

#### Perime

1.	Perime	6665	1.01	0.72	64.30
2.	Spinaq dhe qepë	1271	0.19	0.14	12.26
3.	Thjerrëza	972	0.14	0.10	9.38
4.	Burçak	847	0.12	0.09	8.17
5.	Bathë	561	0.08	0.06	5.41
6.	Spinaq	50	0.007	0.005	0.48
Shuma:		10366	1.58	1.12	

1) Të dhjetat nga prodhimet bujqësore prej të jashtëmëve janë zakonisht të ardhurat që fshatarët e një timari jepnin për tokat që punonin në fshatrat e përfshira në një timar tjetër.

1	Fruta	3	4	5	6
1.	Frutat	4231	0.64	0.46	44.90
2.	Gështenja	1769	0.27	0.19	18.77
3.	Arra	1662	0.25	0.18	17.64
4.	Kumbulla	1561	0.23	0.17	16.56
5.	Qersh	151	0.02	0.02	1.60
6.	Mollë	50	0.008	0.005	0.53
Shuma:		9424	1.43	1.02	

Prodhime të rrushit

1.	Musht	256 695	39.18	27.80	92.16
2.	Taksa e govatës	17 193	2.62	1.86	6.17
3.	Taksa e fuçisë	4 092	0.62	0.44	1.47
4.	Vreshta të manastirit	250	0.04	0.03	0.09
5.	E dhjeta e mushtit nga të jashtërit	300	0.04	0.03	0.11
Shuma:		278 530	42.52	30.17	

Bimë të ndryshme për prodhime zeytare

1.	Liri	10 810	1.65	1.17	
2.	Qoqel	2 162	0.33	0.23	
3.	Zagrafan	35	0.005	0.003	
Shuma:		13 007	1.98	1.41	

1	Nga ekonomia personale e feudalit (hassa)	3	4	5	6
---	---	---	---	---	---

1.	Grurë hasa	420	0.064	0.04	
2.	Elb dhe të tjera hasa	14	0.002	0.001	
3.	Perime hasa	20	0.003	0.002	
4.	Vreshta hasa	34 522	5.27	3.74	
5.	Tokë hasa	3 806	0.58	0.41	
6.	Livadhe hasa	3 890	0.59	0.42	
7.	Kallamishte hasa	130	0.02	0.01	

1	2	3	4	5	6
8. Drurë frutorë hasa		575	0.09	0.06	
9. Gështenja hasa		2 050	0.31	0.22	
10. Arra hasa		652	0.099	0.07	
11. Qershhi hasa		110	0.016	0.01	
12. Dardhë hasa		8	0.001	0.0009	
13. Mullinj hasa		7 200	1.09	0.78	
<b>Shuma:</b>		<b>53 397</b>	<b>8.15</b>	<b>5.78</b>	

Shuma e prodhimit bujqësor 655053 akçe

Kullota

1. Taksa e barit	27 508		2.98
2. Livadhe	60		0.006
3. Taksa e barit nga të jashtmit	115		0.01
<b>Shuma:</b>	<b>27 683</b>		<b>3.00</b>

Taksa të ndryshme në natyrë

1. Taksa e druve	11 170		1.21
2. Taksa e blëtëve	6 163		0.07
<b>Shuma:</b>	<b>17 333</b>		<b>1.88</b>

1	Taksa të ndryshme në të holla	3	4	5	6
1. Bidati i derrave		6 571		0.71	
2. Baxhi i pazarit dhe taksa e miroponit		300		0.03	
3. Manastir		174		0.02	
4. Qymyr		15		0.002	
5. Taksa e deqlanit		30		0.003	
6. Mullinj të rajave		7 772		0.84	
7. Mullinj dërstile		525		0.06	

1	2	3	4	5	6
8. Mullinj të shkatërruar		350		0.04	
9. Baxhi i verës nga të jashtmit		210		0.02	
<b>Shuma:</b>		<b>15 947</b>		<b>1.73</b>	

Taksa të ndryshme dhe gjoba në të holla

1. Nijabeti dhe baxhi i pazarit dhe badihavatë	18 424	1.99
2. Taksa e gjerdekut	395	0.04
<b>Shuma:</b>	<b>18 819</b>	<b>2.04</b>

1. Ispenxhe	188 503	20.41
-------------	---------	-------

Renta spahiore gjithsej 923338 akçe

Në Krahinën e Bihorit,<sup>1</sup> me nahijet e Komninit, të Plavës, të Izla Rjekës, kultivoheshin më tepër drithërat, ndonëse terreni ishte më pak i përshtatshëm për bujqësi se ai i Ultësirës së Shkodrës dhe i Rrafshit të Dukagjinit. Të ardhurat prej tyre (63136 akçe) zinin 40.7 për qind të shumës totale të të ardhurave të rentës spahiore (155 248 akçe) dhe 92.71 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore (68 103 akçe). Nga drithërat kultivoheshin: gruri, thekra, elbi, meli, okra etj. Midis tyre vendin kryesor e zinte gruri, meqë prej tij nxirreshin 39.9 për qind e të ardhurave nga drithërat.

Ndryshe nga Ultësira e Shkodrës dhe Rrafshi i Dukagjinit, në këto zona vreshtaria kishte pasur një përhapje tepër të vogël dhe të ardhurat prej prodhimeve të rrushit zinin

1) Kemi lënë jashtë shqyrtimit nahijen e Komaranit, meqenëse fshatarët e shlyenin rentën feudale me pagesë fikse (përfshihen në statusin e eflakëve). Si rrjedhim në defterin e regjistrimit të vitit 1485 nuk janë shënuar të ardhurat nga e dhjeta për secilën kulturë bujqësore.

vetëm 0.03 për qind të rentës spahiore dhe 0.07 për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor. Siç duket kushtet natyrore të atjeshme kanë qenë të papërshtatshme për kultivimin e vreshtarisë.

Krahina e Bihorit duhet të ketë qenë një zonë e pasur me pyje, gjë që dëshmohet nga të ardhurat e shumta nga taksa e druve, (zë 2.6 për qind të rentës spahiore), si dhe në kullota (të ardhurat nga taksa e barit zinin 6.6 për qind të rentës spahiore). Më poshtë po paraqesim më hollësisht raportin e kulturave bujqësore në këtë zonë.

Nr	Drithëra	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në të ardhura nga bujqësia 68103 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 149707 akçe	Vendi që zë në grup-kulturë
1	2	3	4	5	6
1. Grurë		25 200	37.00	16.83	39.91
2. Thekër		12 160	17.85	8.12	19.26
3. Elb		5 969	8.76	3.99	9.45
4. Tagji, okër dhe të tjera		14 407	21.15	9.62	22.82
5. Mel		5 400	7.92	3.61	8.55
	Shuma:	63 136	92.70	42.17	
<b>Perime</b>					
1. Taksa e perimeve		2 147	3.15	1.43	91.09
2. Thjerrëza		180	0.26	0.12	7.64
3. Burçak		20	0.03	0.01	0.85
	Shuma:	2 347	3.44	1.57	
<b>Fruta</b>					
1. Kumbulla		30	0.04	0.02	65.22
2. Taksa e frutave		16	0.03	0.01	34.78
	Shuma:	46	0.07	0.03	

1	2	3	4	5	6
<b>Prodhime të rrushit</b>					
1. Musht		40	0.06	0.03	81.63
2. Taksa e govatës		9	0.01	0.006	18.37
<b>Shuma:</b>		<b>49</b>	<b>0.07</b>	<b>0.03</b>	
<b>Bimë të ndryshme për prodhim zejtar</b>					
1. Liri		2 105	3.10	1.41	
<b>Nga objektet e ekonomive personale të feudalëve (hassa)</b>					
1. Livadhe hasa		420	0.62	0.28	
<b>Shuma e prodhimit bujqësor 68183 akçe</b>					
<b>Kullota</b>					
1. Taksa e barit		9 942		6.64	
<b>Taksa të ndryshme në natyrë</b>					
1. Taksa e druve		3 908		2.61	
2. Taksa e bletëve		1 870		1.25	
<b>Shuma:</b>		<b>5 778</b>		<b>3.86</b>	
<b>Taksa të ndryshme në të holla</b>					
1. Bidati i derrave		1 341		0.90	
2. Mullinj të rajave		1 895		1.27	
<b>Shuma:</b>		<b>3 236</b>		<b>2.16</b>	
<b>Taksa në ndryshme dhe gjoba në të holla</b>					

---

1. Nijabeti, kësti i pa-  
zarit, badihvatë dhe  
xhyrmi xhinajeti

6 714

4.48

---

1. Ispenxhe

55 934

37.36

---

Renta spahiore gjithsej 149707 akçe

---

Më lart parashtruam të dhënat e regjistrimit kadastral të vitit 1485 për kulturat bujqësore dhe vendin që zinte secila në prodhimin e përgjithshëm dhe në atë bujqësor sipas zone kryesore që përbënin sanxhakun e Shkodrës. Më poshtë do të trajtojmë kulturat bujqësore për gjithë sanxhakun e Shkodrës, duke krahasuar përhapjen dhe vendin që zinin ato në secilën zonë.

*Drithërat*, kulturat e drithërave kishin një përhapje të gjerë në krahinat e sanxhakut të, Shkodrës duke zënë vendin kryesor e më të rëndësishëm në ekonominë bujqësore. Të ardhurat prej tyre formonin 31-42 për qind të të ardhurave të rentës spahiore. Midis tyre vendin më kryesor e zinte gruri. Kjo dëshmohet nga fakti se të ardhurat prej tij formonin nga 14-23 për qind të të ardhurave totale të rentës spahiore. Pas tij vinin elbi, thekra, okra, meli. Nga të dhënat del se sasi më të mëdha drithërash ishin prodhuar më 1485 në Rrafshin e Dukagjinit (vileshin 290 329 akçe të ardhura) pastaj në Ultësirën e Shkodrës 83742.5 akçe të ardhura)<sup>1</sup> dhe në krahinën e Bihorit (63 136 akçe të ardhura), kurse në Kelmend e në Pipër tepër pak (1714 akçe të ardhura).

Më poshtë po japim më hollësisht të dhëna mbi vendin që zinte çdo kulturë prej drithërave në gjithë sanxhakun:

---

1) Sasia e prodhimit të drithërave në këtë zonë duhet të ketë qenë më e madhe, sepse në përllëgaritjet tona nuk kemi përfshirë fshatrat që paguanin detyrimet në formë globale.





Kultura e grurit zinte vendin kryesor midis drithërave dhe kishte përhapjen më të gjerë në krahasim me kulturat e tjera bujqësore. Kjo duket qartë nga vendi i parë që të ardhurat nga e dhjeta e grurit zinin në listën e gjatë të detyrimeve që i shlyente çdo fshat<sup>1</sup>, si dhe nga sasia e tyre më e madhe në krahasim me detyrimet e tjera. Gruri ishte një kulturë masive e përhapur në të gjitha fshatrat e trevave që përfshiheshin në sanxhakun e Shkodrës, gjë që vërtetohet nga fakti se në regjistrimin e vitit 1485 janë shënuar të ardhura nga e dhjeta prej tij për secilin fshat. Madje, të dhëna të drejtpërdrejta dëshmojnë se kishte fshatra që prodhonin sasira më të mëdha gruri në krahasim me fshatrat e tjera dhe ishin të specializuara për këtë kulturë.

Krahas grurit burimet dokumentare japin të dhëna edhe për kulturën e melit. Nga Kadastra e Shkodrës del se meli në shek. XV kishte një përhapje të gjerë. Kjo duket qartë edhe nga një përlogaritje fare e vogël. Nga 116 fshatra që regjistron Kadastra e Shkodrës në 101 kultivohej meli dhe vetëm në 15 prej tyre nuk përmendet kjo kulturë.

Një kulturë tjetër më përhapje të gjerë ishte dhe thekra. Në defterin e vitit 1485 ajo zakonisht gjendet e regjistruar menjëherë pas grurit. Në të ardhurat nga drithërat, të ardhurat nga thekra zinin në Ultësirën e Shkodrës 3.5 për qind, në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit 17 për qind, në krahinën e Bihorit 19.3 për qind, ndërsa për nahijet e Kelmendit e të Piprit, thekra nuk dokumentohet fare. Zonat më të përshatshme për kultivimin e thekrës ishin ato kodrinore në brendësi të vendit. Më shumë ishte e kultivuar në trevën e Bihorit dhe pastaj në Rrafshin e Dukagjinit dhe më pak në Ultësirën e Shkodrës. Përgjithësisht në zonat fushore ishte e kufizuar. Në vise që ngërthenin një terren disi më të lartë dhe vende kodrinore siç qenë p.sh. nahijet e Merkodit dhe të Krajës brenda zonës së ulët të Shkodrës sasia e të ardhurave nga thekra ishte më e lartë në krahasim me nahijet e tjera të po kësaj zone; atje ajo zinte 27.5 për qind të të ardhurave të drithërave. Thekra ishte një kulturë që mbillej edhe në toka jo të pasura pasi është e kuptueshme që tokat më të mira ziheshin me grurë.

Kultura e elbit gjendet e dokumentuar në të gjitha zonat

---

1) S. Pulaha. *Defteri i Regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë 1974.

ë sanxhakut të Shkodrës fushore, kodrinore dhe malore. Për të dhënë mendime më të hollësishme për këtë kulturë është vështirë sepse për shumë fshatra në defterin e vitit 1485 ai nuk është regjistruar më vete, por së bashku me tagjinë dhe të tjera. Megjithëkëtë mendojmë se edhe në këto raste, në shumatat e dhëna, të ardhurat kryesore vinin nga elbi. Sipas tyre elbi në Ultësirën e Shkodrës jepte 46.9 për qind të të ardhurave nga drithërat, në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit 16.3 për qind, në Kelmend e Pipër 40.3, kurse në krahinën e Bihorit 9.4 për qind. Duke gjykuar nga këto të dhëna, del qartë se elbi kultivohej edhe në toka të thyera dhe të varfra me një klimë më të butë në krahasim me atë në të cilën rritet thekra. Në brendësi të vendit elbi gjendej në sasi më të pakta.

Tagjia, si ushqim i rëndësishëm për kafshët, përmendet në të gjitha viset e sanxhakut të Shkodrës. Dokumentacioni herë e regjistron më vete, dhe herë së bashku me elbin ose okren. Tagjia jepet me kultura të tjera, për ato fshatra në të cilat prodhohej në sasira të pakta. Vetëm për fshatrat e Kelmendit e të Piprit, tagjia është shënuar më vete dhe të ardhurat e saj zënë 18.4 për qind të të ardhurave të drithërave.

Në familjen e drithërave hasim edhe kultura të tjera si okër, ujem ndonëse këto kanë një përhapje më të vogël dhe një përdorim më të pakët.

Duhet pasur parasysh se në zhvillimin e bujqësisë dhe sidomos në kulturat e veçanta bujqësore kanë ndikuar një sërë faktorësh qofshin këta objektivë apo subjektivë. Përveç kushteve klimatike dhe llojit të terrenit ka luajtur rolin e vet edhe tradita, eksperiencia, përvoja e gjatë e fituar, të cilat kanë influencuar në rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Përhapja më e gjerë e drithërave dëshmohet jo vetëm nga vendi kryesor që zinin të ardhurat nga e dhjeta e tyre në rentën spahiore, por edhe nga eksportimi i madh i tyre në shek. XV, i cili le të kuptohet se prodhohej një sasi e madhe drithi mbi nevojat e domosdoshme të popullsisë për jetesë. Kjo duket qartë në dokumentacionin perëndimor. P.sh. «udhëzimi i rëndësishëm që iu dha proveditorëve dhe sindikëve të Venedikut, të cilët u nisën për Shqipëri (5 nëntor 1414), tregon mirë çfarë rëndësie kishte Shqipëria për Venedikun në pikëpamje të drithërave: «ata duhet të përpiqeshin që të gjitha

drithërat (veçanërisht gruri dhe meli) të transportoheshin vetëm në Venedik dhe në vendet venedikase, sepse në Shqipëri grumbullohej çdo vit sasi e madhe drithi, në vend të parë gruri».¹ Në këtë mënyrë Republika i kufizoi tregjet e eksportimit të drithit shqiptar duke e orientuar atë vetëm drejt Venedikut. Për më tepër ishin parashikuar edhe dënime për ata që do ta eksportonin drithin jashtë territoreve të Venedikut.² Ata që do të kapeshin duke vepruar në kundërshtim me vendimin e lartpërmendur do të gjobiteshin me 1000 dukate.³ Sinjoria duke vendosur monopolin në eksportimin e drithërave nga Shqipëria, përqendroi në duart e saj tepricat e drithit shqiptar. Një rrugë tjetër për t'ia arritur po këtij qëllimi që edhe politika e taksave, pagimi nga çdo familje i një modi drithë, dhe i taksës për bluarje etj.⁴

Në shek. XV Shqipëria e Veriut dhe në mënyrë të veçantë Shkodra përbënte një treg të rëndësishëm për eksportimin e drithërave. Megjithëse në grykën e Bunës ishin vënë roje për të mos lejuar nxjerrjen e grurit e të drithërave jashtë Shkodrës dhe rrethit të saj, mjaft të dhëna tregojnë se kryhej një farë eksporti edhe pse në situata të vështira.⁵

Fakti që nga rrethi i Shkodrës nën sundimin venedikas eksportohej një sasi e madhe drithërash përbën në të njëjtën kohë një argument bindës se Shqipëria e Veriut që një kultivuese dhe prodhuese e madhe drithërash. Kjo zonë konsiderohej njëra nga krahinat kryesore prodhuese të drithit (respektivisht tregjet) krahas Durrësit, Vregos e grykës së lumit Ishëm ku ishte orientuar tregtia e venedikasve. Në portet e Shqipërisë së Veriut dhe asaj të Mesme raguzianët ishin si të thuash transportuese ekskluzivë të drithërave në Venedik. e sidomos në vitet 1433, 1438, 1439 dhe 1442. Për shkak të monopolit total të Venedikut në eksportimin e drithërave raguzianët nuk mund të paraqiteshin në këtë rajon si tregtarë që do të eksportonin drithëra për llogari të tyre. Mirëpo kjo nuk do të thotë kurrsesi se në qytetin e Raguzës në atë kohë nuk kon-

1) B. Hrabak. *Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shekujt XIII, XIV, XV*, në: «Gjurmime albanologjike», 1970, nr. 2, f. 52.

2) AAV., VII (1970) 163. Coll. Not. 5, c 42 (40).

3) AAV. VI, 171, Sen. Mix., R ILIX, C. 36(35)t.

4) B. Hrabak, *Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shek. XIII XIV. XV*. në: «Gjurmime albanologjike», 1970, nr. 1-2, f. 53.

5) AAV. Sen Mix., T. VII, P. 50 C. 169 (168)t.

sumohej gruri dhe meli i Shqipërisë, sespe ai transportohej atje edhe nga shqiptarët.<sup>1</sup> Të dhënat faktike që flasin për një eksportim të madh drithërash nga tokat e Shqipërisë Veriore dëshmojnë se përveç sasive të drithit që i përkiste Republikës dhe tepricave të krerëve feudalë, një pjesë e madhe ishte padyshim nga tepricat për treg të fshatarësisë pasi ajo mbulonte nevojat e veta; kjo vetëkuptohet nga fakti se shqiptarët tregtonin drithëra.

Republika e Venedikut meqenëse kishte pushtuar qytetet kryesore të bregdetit, të cilat përbënin nyjet kyçe ku zhvillohej tregtia, patën mundësi më të mëdha për të vënë dorë mbi drithin shqiptar. Qeveritarët venedikas giatë tërë shek. XV i kushtuan kujdes të madh vjeljes së prodhimit të drithërave në rajonin pjellor përreth Shkodrës. Ata përpiqeshin t'i mbushnin me kohë depot e tyre, duke kërkuar nga shtetasit t'i sillnin detyrimet e drithit në kështjellën e Shkodrës.<sup>2</sup> Po kaq kujdes tregtarët venedikas u kushtuan tepricave në treg. Shteti u krijonte atyre kushte shumë të favorshme duke penguar sa më shumë tregtarët e tjerë, pa përjashtuar edhe vendasit.<sup>3</sup>

### *Vreshtaria*

Në ekonominë bujqësore të shek. XV, krahas drithërave të bukës, një vend të rëndësishëm, sipas defterit të vitit 1485, zinte kultura e rrushit. Popullsia e Shqipërisë së Veriut ishte marrë gjerësisht me kultivimin dhe përpunimin e rrushit. Këtë e faktojnë regjistrimet kadastrale që japin të dhëna mbi të dhjetën e verës, taksën për mushtin, taksën e kazanit, taksën e fuçisë etj. Shlyerja e këtyre detyrimeve si pushtuesit venedikas ashtu dhe atij osman dëshmon për zhvillimin e vreshtarisë e në të njëjtën kohë për një traditë të vjetër në kultivimin e rrushit, në përpunimin dhe nxjerrjen e nënprodukteve prej tij si musht, verë, etj., pa zënë në gojë përdorimin e tij si frut i freskët. Në këtë periudhë mendojmë se fshatarësia prodhonte edhe raki rrushi, ndonëse kjo nuk përmendet drejtpërdrejt në dokumentacionin e kohës. Megjithatë në regjistrin e vitit 1485 taksa e kazanit është një

---

1) B. Hrabak, *Eksportimi i drithërave nga Shqipëria e Veriut në shekujt XIII, XIV, XV*. në: «Gjurmime albanologjike», 1970, nr. 1-2, f. 55-56.

2) *Po aty*, f. 59.

3) L. Malltezi, *Rreth monopolit të shtetit venedikas mbi drithin në Shqipëri në shek. XV*, në: «Studime historike», nr. 1, 1986, f. 136.

dëshmi e tërthortë që tregon për prodhimin e rakisë. Me irteres është edhe fakti se në rrethin e Shkodrës kishte edhe fshatra të specializuara për kultivimin dhe përpunimin e rru-shit. Qysh në fillimet e shek. XV sipas Kadastrës venedikase p.sh. banorët e Koplikut e siguronin jetën vetëm me vreshtat dhe nuk kishin as tokë, as të ardhura të tjera.<sup>1</sup> Në këtë dokument detyrimi i verës paraqitet si nga më kryesorët, krahas atyre të grurit dhe të melit. Fshatra të specializuara në vreshtari, në të cilat të ardhurat prej saj zinin një vend më të madh në rentën spahiore sesa grup-kulturat e tjera bujqësore, në sanxhakun e Shkodrës sipas regjistrit të vitit 1485 janë:

#### Ullësira e Shkodrës

Nr.	Nahija e Shkodrës Fshatrat	Musht	Taksa e govatës	Taksa e fuçisë	Të ardhura nga vreshtat	Renta spahiore
1	2	3	4	5	6	7
1.	Lushtë	1838	110		1998	6505
2.	Dragovol	2250	120		2370	5475
3.	Rash	392	30		422	1198
4.	Koplik	7780		300	8080	17780
5.	Egjrish	1040	20		1060	3685
6.	Shëndbifsh	480			480	3500
7.	Kurtë	640	25		665	2741
8.	Baren	200	10		210	642
9.	Puleç (Puliç)	320	10		330	1346
10.	Ngrish	400	35		435	1575
11.	Kusmaç	480	10		490	1115
12.	Kuç	960	30		990	3040
13.	Poshtërkuzë	1280	95		1375	1841
14.	Podgorë	3930	100		4030	6235
15.	Karpent	140	10		160	459

#### Nahija e Drishtit

1.	Shëngjin ose Rashë	800	70		870	3379
2.	Rashë	720	30		750	1688
3.	Lepurosh	1200	25		1225	2638
4.	Rosek	72	10		82	493
5.	Grizhë	6400	260		6660	14813

#### Nahija e Merkodit

1.	Merkojeviq	1704	200		1904	10004
----	------------	------	-----	--	------	-------

1) I. Zamputi; Kad. e Shk. fl. 133/b,

1	2	3	4	5	6	7
<i>Nahija e Krajës</i>						
1. Krajë		3760	500		4260	12114
<i>Nahija e Zhabjakut</i>						
1. Dajbabë		400			400	1157

**Rrafshi i Dukagjinit**  
(Nahija e Pejës)

1	2	3	4	5	6	7
1. Pejë		8000	100		8100	30001
2. Bjelopolja e madhe		8200	415		8615	14210
3. Bjelopolja e vogël		4800	300		5100	8978
4. Boçoçë		3660	120		3780	6115
5. Radavçë		880	55		935	2467
6. Krivogllavë		800	50		850	1629
7. Brestjë		1100	70		1170	3806
8. Novoselë		1800	85		1185	4539
9. Petriçë		2400	165		2565	7334
10. Luzhiçë		1400	95		1495	4692
11. Virpnicë		980	95		1075	2835
12. Balic		440	45		485	1601
13. Jablanicë e madhe		3600	180		3780	6889
14. Manastiri Stasi		1800	50		1850	2788
15. Manastiri Kuzmiqani		100	5		105	137
16. Manastiri Shumeti Bogavac		380	20		400	457
17. Manastiri Mokri Dol		40	5		45	98
18. Manastiri Navor		800	30		830	1104
19. Manastiri Shumniç		400	10		410	484
20. Manastiri Tumeniçë		600	20		620	826
21. Manastiri Nova Qerkovë		850	25		885	1170
22. Manastiri Nikolla Çërkovë		460	5		465	523
23. Shabokë		2780	120		2900	4623
24. Vibarç		300	35		335	1523
25. Brestoviç		3400	250	300	3950	7106
26. Podi Salicë		1100	95		1195	5281
27. Jabllanicë e vogël		240	15		255	610
28. Pelçë		300	30		330	2332
29. Gjerbçishë		1100	34	50	1184	2937
30. Deçani dhe manastiri Deçani		5000	500		5500	12629

1	2	ε	4	5	6	7
31. Djekoviçë	560	110			670	6536
32. Bolen	1100	40			1140	1899
33. Gorna Lukë	4300	200			4500	9510
34. Popole	220	45			265	2491
35. Berkovë	4840	205			5045	11588
36. Isteniq	1300	135			1435	4341
37. Netrobishtë	800	45		25	870	3011
38. Buçovriq	240	25		5	270	379
39. Palovë	400	20		8	428	1113
40. Osterbaç	460	30			490	1861
41. Carnicë	580	50			630	3337
42. Rakosh	1080	80			1160	3909
43. Grabofçë	340	48			388	1498
44. Ciralug	300	55			355	1590
45. Jablaniçë	1200	100			1300	5034
46. Zhupë	2000	70			2070	3545
47. Susiçë	280	20			300	862
48. Usak (Osak)	200	15			215	1204
49. Dobriçadol	340	30			370	1899
50. Çërnovirhë	1600	160			1760	6832
51. Lubishtë	800	90			890	4414
52. Leshan	1100				1100	4351
53. Barale	1120	95			1215	4700
54. Kolanicë	900	100		26	1026	3956
55. Bobolucë	1140				1140	4199
56. Dolina Iglivokë	480	35			515	1926
57. Vardishtë	480	30			510	1477
58. Ceshkovë	880	30			910	2537
59. Vraniq	400	20			420	1605
60. Manastiri Ivrala	260	15			275	555
61. Isniq	400	50			450	1267
62. Cërmil	3200	200			3400	11852
63. Fshajan	3060	180			3240	9380
64. Kush (Kosh)	4920	190			5110	10815
65. Milgjen	1200	80			1280	3614
66. Vdosh	960	40			1000	1685
67. Lablat	400	40			440	2882
68. Dolina Petriç	1800	55			1855	3504
69. Oprashkë	800	30			830	2202
70. Bolovë	1000	40			1040	2996
71. Istranmesh	1030	75			1105	2351
72. Pomino Pole	4000	175			4175	11844
73. Bjeliçe	1320	75			1395	4421
74. Shtupul	900	55			955	2745
75. Baram	700	30			730	1477
76. Gorna Leoçinë	680	45			725	2468
77. Mostir	580	35			615	2572
78. Shumeniçë	180	5			185	485



1	2	3	4	5	6	7
79. Dolina Kaličan	500		10		510	893
80. Shikonë	2900		95	100	3095	5332
81. Shalnoviçë	1660		20		1680	5550
82. Bjelopolje	1900		105		2005	6182
83. Nemileviq	2200		85		2285	4224
84. Lezibabë	440		15		455	1014
85. Lubeliq	1800		40		1840	5653
86. Krninçë	1800		115	50	1965	60714
87. Veriq	500		50		550	2575
88. Çirun brak	700		60		760	2566
89. Studeniçë	260		45		305	1457
90. Ajdina Pole	1100		55	64	1219	4548
91. Nenadaniçë	1390		90		1390	3000
92. Çirna Lukë	400		65	16	481	2291
93. Dolina Bjeliçë	1160		75		1235	3874
94. Rakovac	800		90		890	3749
95. Rashkovaç	900		80	20	1000	2777
96. Vodojinë	1200		60	30	1290	2898
97. Lugjan	800		90	150	1040	3830
98. Klinë	1100		60	60	1220	4981
99. Isniq	500		49	10	559	1312
100. Prileoë	700		20	10	730	3315
101. Drodil	200		15		215	9240
102. Novoselë	340		10	10	360	981
103. Neglavkë	2000		100	160	2260	5921
104. Dronofiçë	1000		60		1060	3040

#### Nahija e Suhogërlës

1. Suhogërlë	7000	820			7820	22422
2. Cërkolez	3000	160			3160	7764
3. Oraçë (Vraçë)	3000	125			3125	5808
4. Shushicë	1920	120			2040	5275
5. Banë (Banjë)	4800	165			4965	9944
6. Rudnik	2000	120			2120	4833
7. Dolina Leoçinë	3000	100			3100	5188
8. Gorna Beliçë	4100	205	205		4510	10018
9. Gorna Jashanicë	4400	255	200		4855	1626
10. Dolina Jashanicë	7000	255	500		7755	10042
11. Zakovë	2000	90	200		2290	6354
12. Tuçep	4300	180	400		4880	10655
13. Gërebaniq	4600	110			4170	7708
14. Gjorgjovik	3820	250	100		4170	5686
15. Leskovec	4400	250	200		4850	11597
16. Klinaç	1940	115	100		2155	4280
17. Vokshiq	1200	70	130		1400	4715
18. Trepzë	3400	150	200		3750	7696
19. Dolina Krushevë	2000	60	30		2090	4276
20. Gjorgjoviq	7400	410	150		7960	10953

1.	2	3	4	5	6	7
----	---	---	---	---	---	---

### Nahija e Altun-ilisë

1. Lunik	800	150		950	5050
2. Sikuq (Siqveç)	640	70	8	718	3409
3. Butoshë	880	145		1025	4691
4. Shipçan	800	135		935	4336
5. Kovaç	600	25		625	1746
6. Miholan	760	65		825	2284
7. Gosturan	420	95		515	2376
8. Cernomile	500	50		550	1625
9. Stepanenelo	380	80		460	1646
10. Goran	540	65		605	2137
11. Shoshan	880	60		940	3099
12. Babnoç	800	95		895	2239
13. Poljë	2400	225		2625	6711
14. Shumë	500	70	30	600	2228
15. Dolini Buqan	340	50		390	1608
16. Nebonan	520	65		585	1623
17. Trobnosh	720	45		765	2088
18. Poçestë	300	15		315	978
19. Trajopolje	800	80		880	2123
20. Vuçidol	300	25	10	335	1316
21. Ternovë	160	10	10	180	721

Sipas të dhënave të regjistrit të vitit 1485, del se pas drithërave, rrushi ishte kultura më e përhapur; prej tij sigurohej një pjesë e madhe e rentës spahiore. Në zonën e ulët të Shkodrës të ardhurat nga rrushi dhe nënproduktet e tij zinin 25.1 për qind të rentës spahiore dhe 34.25 për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor, në zonën e Rrafshit të Dukagjinit 30.2 për qind dhe 42.52 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore të saj, kurse në krahinën e Bihorit dhe në viset e Malësisë së Kelmendit e Piprit ato ishin krejtësisht të pakta.

Në zonën e ulët të Shkodrës dhe në atë të Rrafshit të Dukagjinit që përbëjnë dy nga zonat më prodhuese e me rendimente më të larta për kohën, të ardhurat nga prodhimet e rrushit vijnë menjëherë pas drithërave. Këto ishin zonat më të rëndësishme bujqësore të sanxhakut të Shkodrës, që siguronin të ardhura më të mëdha se viset e tjera. Më hollësisht këto të ardhura paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Zona e ulët e Shkodrës		Malësia e Shkodrës		Rrafshi i Dukagjinit		Krahina e Bihorit					
	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në prodhimet e rrushit të sanxhakut 327878 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 195669.5 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në prodhimet e rrushit të sanxhakut 327878 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 923338 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në prodhimet e rrushit të sanxhakut 327878 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 149707 akçe		
Musht	46674	14.23	23.85	120	0.04	0.53	256695	78.29	27.80	40	0.01	0.03
Taksa e govatës	2205	0.67	1.13	—	—	—	17193	5.24	1.86	9	0.003	0.006
Taksa e fuçisë	300	0.09	0.15	—	—	—	4092	1.25	0.44	—	—	—
Vrështa të manastirit	—	—	—	—	—	—	250	0.08	0.03	—	—	—
E dhjeta e mushatit nga të jashtëmit	—	—	—	—	—	—	300	0.09	0.03	—	—	—
<b>Shuma:</b>	<b>49179</b>	<b>14.99</b>	<b>25.13</b>	<b>120</b>	<b>0.04</b>	<b>0.53</b>	<b>278530</b>	<b>84.94</b>	<b>30.17</b>	<b>49</b>	<b>0.01</b>	<b>0.03</b>

Rrushit ishte kultivuar në toka dhe zona me klimë të përshtatshme për të, prandaj nuk kishte pasur atë përhapje të gjerë në çdo fshat sikurse gruri. Numri i fshatrave që mbillnin e kultivonin rrushin ishte shumë më i vogël në krahasim me fshatrat që kultivonin drithërat. Ato gjenden kryesisht në vise kodrinore ku lagështia është më e paktë.

Vendi i rëndësishëm i kulturës së rrushit si një burim ekonomik me peshë, dokumentohet qysh nga fillimi i shek. XV nga Kadastra e Shkodrës ku janë regjistruar të gjitha tokat që ishin nën administrimin e Republikës së Venedikut.

Mbishkodra duke pasur terren të thyer kishte kushte më të favorshme për zhvillimin e vreshtarisë. Fshatra të Mbishkodrës si Kalldruni,<sup>1</sup> Kopliku,<sup>2</sup> Podgora,<sup>3</sup> Grizha,<sup>4</sup> luajtën një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Edhe pas 67 vjetësh, në regjistrin e vitit 1485 del se prodhimi i mushtit, në këto fshatra zë vendin e parë midis prodhimeve bujqësore e blegtorale. Fshati Koplik<sup>5</sup> paguante 7780 akçe për musht në një kohë kur renta totale nga të dhjetat e produkteve bujqësore ishte 17 780 akçe. Fshati Podgora<sup>6</sup> jepte 3930 akçe nga mushti kur renta spahiore kapte 6235 akçe gjithsej. Pra, më shumë se gjysmën e të ardhurave në këtë fshat përshtuesi e siguronte vetëm nga kjo taksë. Po kështu fshati Grizhë<sup>7</sup> paguante 6400 akçe nga mushti, kurse si rentë nga të dhjetat e prodhimeve bujqësore shlyente 14813 akçe. Raste si këto ka edhe të tjera në regjistrë. Një specializim i tillë lidhur me vreshtarinë ishte i trashëguar brez pas brezi, ndryshe nuk mund të shpjegohen të ardhurat aq të larta nga vreshtat.

Një fenomen i tillë nuk vihet re në fshatrat e Nënshkodrës. Kadastra e viteve 1416-1417 nuk regjistron aty as edhe një vreshtë. Vetëkuptohet se terreni kryesisht fushor nuk ishte i përshtatshëm për rrushin.

Vreshta kishin përqendruar në duart e tyre edhe in-

---

1) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 40/ab.

2) *Po aty*, fl. 45/ab.

3) *Po aty*, fl. 47/ab, 48/ab.

4) *Po aty*, fl. 60/ab.

5) S. Pulaha, *Regjistri i 1485*. f. 123-124.

6) *Po aty*, f. 155.

7) *Po aty*, f. 172.

stitucionet fetare.<sup>1</sup> Duke bërë fjalë për to, në kadastrën e Shkodrës paraqitet edhe procesi i punëve dhe i shërbimeve që u bëheshin vreshtave: «t'i mihin me shat, t'i krasisin dhe t'i punojnë të gjitha vreshtat. dhe t'i vjelin...».<sup>2</sup>

Shumë vreshta në malin përballë Shkodrës ishin në duart e zanatçinjve të ndryshëm si këpucarë,<sup>3</sup> kovaçë, ushtarakë, muratorë, hekurpunues etj.<sup>4</sup> Kultura e rrushit mbillej edhe në formën e pjergullave pranë drurëve frutorë.<sup>5</sup> Dokumentacioni i fillimit të shek. XV nuk i ka regjistruar pjergullat në atë masë që ishin në realitet, për arsye se në Kadastër janë regjistruar zakonisht arat dhe vreshtat, por jo pjergullat meqë ato nuk zinin sipërfaqe tokash më vete.

Fshatarët e zonës së Koplikut<sup>6</sup> e siguronin jetën kryesisht nëpërmjet prodhimit të verës, për të cilën pushtetit venedikas i shlyenin një detyrim sa të lartë<sup>7</sup> aq edhe të ngurtë, sepse bazohej në sistemin fiks. Ky ishte bërë për prodhuesit e rrushit burim trazirash e për më tepër edhe pengesë për zhvillimin e vreshtarisë, mbasi nga materialet del në mënyrë të qartë se shfrytëzimi i egër arrinte deri aty sa fshatari të hiqte dorë nga vreshtat.<sup>8</sup> Për këtë arsye në këto materiale hasen edhe vreshta të papunuara,<sup>9</sup> e të braktisura nga fshatarët. Ngurtësia e venedikasve kishte arritur deri aty sa trashëgiminë ta lejonin vetëm për ato familje që shlyenin detyrimet ndaj tyre.<sup>10</sup>

Luftërat e gjata të popullit tonë kundër pushtuesit osman, rrethimet e Shkodrës që shkatërruan vendin, dëmtuan edhe vreshtat. Sipas humanistit shqiptar Marin Barleti në

---

1) S. Pulaha. *Regjistri i 1485. Manastiri Stasi*. f. 233. *Manastiri Kuzmiseni*. f. 233. *Manastiri Shumeti Bogavec*. f. 233. *Manastiri Mokri Dol*. f. 234. *Manastiri Navor*, f. 234. *Manastiri Shumnic*. f. 234. *Manastiri Tumenica*. f. 234. *Manastiri Nova Çerkova*, f. 235. *Manastiri Nikolla Cër-kova*. f. 235. *Manastiri Deçani*. f. 417. *Manastiri Ivrala*. f. 25.

2) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 47/a.

3) *Po aty*, fl. 34/b, 35/a.

4) *Po aty*, fl. 31/b.

5) *Po aty*, fl. 106/b.

6) *Po aty*, fl. 45/a.

7) *Po aty*. Detyrimi për verën arrinte në 400 barë.

8) *Po aty*, fl. 45/b.

9) *Po aty*, fl. 61/b.

10) *Po aty*, fl. 142/b.

veprën «Rrethimi i Shkodrës» atje ku «ndodhej një kodër plot vreshta e ullishta» u vendosën shtatorret turke. Por edhe me vendosjen e pushtimit osman dhe zbatimin e regjimit feudal ushtarak të timareve u krijuan pengesa të tjera për vreshtarinë, veçanërisht pas shek. XV. Zhvillimi i procesit të islamizimit ndikoi fuqishëm në rënien e interesit për t'u marrë me shtimin e vreshtave, sepse vera në aspektin fetar ndalohej për besimtarët myslimanë. Megjithëkëtë popullsia e krahinave të sanxhakut të Shkodrës nuk i la mënjanë traditat e lashta të vreshtarisë.

### *Perime—Frutat*

Gjatë shkullit XV në ekonominë bujqësore zinte vend edhe kopshtaria. Në materialet e Kadastrës së Shkodrës të viteve 1416-17 herë pas here përmenden copa toke për kopësht<sup>2</sup> ose kopshte me shumë pemë e hardhi<sup>3</sup> apo me drurë frutorë të veçantë.<sup>4</sup> Kadastra e Shkodrës duke pasur për qëllim të regjistronte tokat, zakonisht nuk jep të dhëna të hollësishme. Ndonjë njoftim e marrim dhe nga ankesat e fshatarëve të veçantë. P.sh. një banor i fshatit Samrish ankohet pranë autoriteteve venedikase se atij duan t'i grabisin një copë tokë që e kishte kopësht.<sup>5</sup>

Edhe kopështi luante rol në jetën ekonomike të fshatarit, sepse nëpërmjet tij ai siguronte në një farë mase prodhime për vete dhe teprica për treg.

Ndërsa Kadastra venedikase e Shkodrës nuk na sjell njoftime lidhur me kulturat bujqësore që kultivoheshin në kopësht, në defterin e regjistrimit të vitit 1485, jepen të dhëna mbi kulturat e kopshteve, si perime e fruta që prodhonte fshatari ynë. Nga perimet ai kultivonte kryesisht: qepë, spinaq, bathë, thjerrëza, hudhra etj., Me të dhënat nëpërmjet taksave që i paguheshin spahinjve ne nuk jemi në gjendje të hedhim dritë mbi shumëllojshmërinë e hortikuturës e në mënyrë të veçantë për të gjitha perimet që për-

1) M. Barleti. *Rrethimi i Shkodrës*, bot. III, 1962, f. 41.

2) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 5/a, 102/b, 106'ab, 107/a, 130/b, 131/ab, 132/b, 144/b, 159/b, etj.

3) *Po aty*, fl. 106/ab.

4) *Po aty*, fl. 159/b.

5) *Po aty*.

doreshin në atë kohë. Në dokumentacion është shënuar vetëm sasia e akçeve që duhet të paguanin fshatra të veçanta për «taksën e perimeve», pa thënë se për cilat perime ishte fjala.

Sipërfaqja e tokave për kopësht ndryshonte nga njeri fshat tek tjetri për vetë faktin se sasia e detyrimeve që ato shlyenin ishte e ndryshme. Të ardhurat prej perimeve që kultivoheshin në Ultësirën e Shkodrës zinin 2.3 për qind të rentës spahiore dhe 3.20 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore. Në nahijet e Shkodrës, Drishtit dhe të Bregut të Këndejmë që ishin kryesisht vende fushore kultivoheshin më shumë. Të ardhurat prej tyre zinin 2.5 për qind të rentës spahiore dhe 3.28 për qind të të ardhurave nga prodhimi bujqësor. Edhe në nahijen e Merkodit dhe të Krajës feudalët siguronin të ardhura të mira nga kopshtet, që zinin 1.26 për qind të rentës spahiore dhe 2.30 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore, por në këtë nënzonë detyrimet nuk japin të dhëna mbi llojshmërinë e perimeve. Akoma më të vogla kanë qenë të ardhurat nga perimet në nahijen e Zhabjakut.

Krahina e Bihorit, ndonëse malore i kultivonte perimet, të cilat zinin 1.57 për qind të rentës spahiore dhe 3.44 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore. Këtu përmenden si kultura më vete vetëm thjerrëza dhe burçaku, kurse llojet e tjera që zenë vend më të madh përmbliohen të papërcaktuara së toku nën emërtimin taksa e perimeve. Në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit të ardhurat e kulturave perimore zënë 1.12 për qind të rentës spahiore dhe 1.58 për qind të të ardhurave nga prodhimet bujqësore. Me sa duket kërkesat për perime kanë qenë të pakta, prandaj vëmendja kryesore në këtë zonë përqendrohej në bimët e arave dhe të vreshtave. Malësia e Shkodrës përbën të vetmen zonë ku nuk dokumentohen fare perimet. Siç duket këtu kushtet e terrenit ishin të papërshtatshme, por edhe në rastet kur familjet fshatare mbillnin perime, ato prodhoheshin në sasi të pakta nga të cilat nuk mund të vilej detyrimi. Më hollësisht të ardhurat nga perimet po i japim si më poshtë:

Emërtimi	Zona e ulët e Shkodrës			Malësia e Shkodrës			Rrafshi i Dukagjinit			Krahina e Bihorit		
	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejt perimet e sanxhakut 17313 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 195669,5 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejt perimet e sanxhakut 17313 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 22499 akçe (pa takson e dhenve)	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejt perimet e sanxhakut 17313 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 923338 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejt perimet e sanxhakut 17313 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 149707 akçe
Perime	2257	13,04	1,15	—	—	—	6665	38,49	0,72	2147	12,40	1,43
Gepë, spinaq	4	0,02	0,002	—	—	—	1271	7,34	0,14	—	—	—
Spinaq	—	—	—	—	—	—	50	0,29	0,005	—	—	—
Thjerrëza	360	2,08	0,19	—	—	—	972	5,61	0,10	180	1,04	0,12
Bathë	905	5,22	0,46	—	—	—	561	3,24	0,06	—	—	—
Bathë dhe kumbulla	1074	6,20	0,55	—	—	—	—	—	—	—	—	—
Burçak	—	—	—	—	—	—	847	4,89	0,09	20	0,11	0,01
Shuma:	4600	26,56	2,35	—	—	—	10366	59,87	1,12	2347	13,55	1,57



Krahas kopshtarisë ishte e zhvilluar edhe pemëtaria por shumë më pak se ajo. Ndër pemët kryesore që dëshmohen nga dokumentacioni janë: gështenja, arra, kumbulla, qershia, molla, ulliri, fiku etj. Zona më e pasur paraqitet ajo e Rrafshit të Dukagjinit dhe zona e ulët e Shkodrës. Në krahinën e Bihorit dokumentohet vetëm kumbulla, me të ardhura gati dy herë më të mëdha sesa taksa e frutave, që përfshinte disa lloje drurësh frutorë. Siç duket kjo i përshtatej më mirë klimës së ftohtë të kësaj zone. Më hollësisht të ardhurat nga drurët frutorë po i paraqitim më poshtë:

### *Bimë industriale*

Një bimë e cila ka pasur përhapje të gjerë është edhe liri. Përdorimi në shkallë të gjerë i një kulture të tillë dëshmon për një nivel relativisht të zhvilluar të ekonomisë bujqësore. Është e kuptueshme që fshatarësia nuk prodhonte vetëm për t'u ushqyer, por ndonëse në përmasa shumë më të vogla, kultivonte edhe bimë që i shërbenin për të plotësuar nevoja të tjera të jetës sikurse veshmbathja. Liri mbillej në fshatrat e Ultësirës së Shkodrës, të Rrafshit të Dukagjinit dhe të krahinës së Bihorit dhe jo në malësitë e Kelmendit dhe të Piprit.

### *Kullotat*

Përveç sipërfaqes së tokave të punueshme fshatari zotëronte edhe livadhe. Nëpërmjet livadheve dhe taksës së barit shihet se fshatari ynë krahas bujqësisë i kushtonte kujdes edhe blegtorisë. Nga livadhet dhe taksa e barit shkonin në dobi të rentës spahiore nga zona e ulët e Shkodrës 6903.5 akçe, nga Rrafshi i Dukagjinit 27683 akçe, nga krahina e Bihorit 9942 akçe. Këto zinin respektivisht 3.5; 3; 6.6 për qind të rentës spahiore. Për Malësinë e Shkodrës regjistri nuk na jep asnjë të dhënë për taksën e barit dhe për livadhet.

Kulturat bujqësore dhe vendi që zinte secila në rentën spahiore të vjelë në krahinat e sanxhakut të Shkodrës në mënyrë të përgjithësuar paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Zona e ulët e Shkodrës			Malësia e Shkodrës			Rrafshi i Dukagjinit			Krahina e Bihorit		
	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejtë frutat e sanxhakut 10063 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 195669,5 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejtë frutat e sanxhakut 10063 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 22489 akçe (pa taksen e dhenve)	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejtë frutat e sanxhakut 10063 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 923338 akçe	Sasia e të ardhurave nga e dhjeta në akçe	Vendi që zë në krejtë frutat e sanxhakut 10063 akçe	Vendi që zë në rentën spahiore 149707 akçe
Fruta	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
Gështenja	10	0.10	0.005	—	—	—	4231	42.04	0.46	16	0.16	0.01
Arra	3	0.03	0.001	—	—	—	1769	17.57	0.19	—	—	—
Kumbulla	120	1.19	0.06	—	—	—	1662	16.51	0.18	—	—	—
Qershia	—	—	—	—	—	—	1561	15.51	0.17	30	0.30	0.02
Molla	—	—	—	—	—	—	151	1.50	0.02	—	—	—
Ulliri	300	2.98	0.15	—	—	—	50	0.50	0.005	—	—	—
Fiku	160	1.58	0.08	—	—	—	—	—	—	—	—	—
<b>Shuma:</b>	<b>593</b>	<b>5.89</b>	<b>0.30</b>	—	—	—	<b>9424</b>	<b>93.65</b>	<b>1.02</b>	<b>46</b>	<b>0.46</b>	<b>0.03</b>

Emërtimi	Zona e ulët e Shkodrës		Malësia e Shkodrës		Rrafshi i Dukagjinit		Krahina e Bihorit	
	Sasia e të ardhura nga e dhjeta në akçe	Vendi që ze në rentën spahiore 195669,5 akçe	Sasia e të ardhura nga e dhjeta në akçe	Vendi që ze në rentën spahiore 22499 akçe (pa taksa e dheneve).	Sasia e të ardhura nga e dhjeta në akçe	Vendi që ze në rentën spahiore 923338 akçe	Sasia e të ardhura nga e dhjeta në akçe	Vendi që ze në rentën spahiore 149707 akçe
Dritëra	83742,5	42,80	1714	7,62	290329	31,44	63136	42,17
Perime	4600	2,35	—	—	10366	1,12	2347	1,57
Fruta	593	0,30	—	—	9424	1,02	46	0,03
Prodhime të rrushit	49179	25,13	120	0,53	278530	30,17	49	0,03
Bimë të ndryshme për prodhim zejtar	1243	0,63	—	—	13007	1,41	2105	1,41
Kullota	6903,5	3,52	—	—	27683	3,00	9942	6,64
Hassatë	4236	21,16	—	—	53397	5,78	420	0,28
Taksa të ndryshme në natyrë	4590	2,34	23	0,1	17333	1,88	5778	3,86
Taksa të ndryshme në të holla	1078,5	0,55	76	0,34	15947	1,73	3236	2,16
Taksa të ndryshme dhe gjoha në të holla	1331	0,68	2023	8,99	18819	2,04	6714	4,48
Ispenxhe	38174	19,51	18543	82,42	188503	20,41	55934	37,36
Taksa e dheneve	—	—	1901	8,45	—	—	—	—

Shumëllojshmëria e kulturave bujqësore dhe shtrirja e tyre në të gjithë vendin, fakti që kryesisht mbi bujqësinë mbështetet sistemi i timarit, zhvillimi i vreshtarisë dhe i bimëve industriale, dëshmojnë për një vend kryesisht bujqësor me popullsi sedentare dhe aspak endëcake.

Që në fillimet e shek. XV, me të dhënat e Kadastrës së Shkodrës dokumentohet se popullsia dinte t'i shfrytëzonte kushtet natyrore të vendit, ajo ishte e prirur për rritjen e sipërfaqes së tokave të punueshme, duke hapur toka të reja në kurriz të sipërfaqeve pyjore e moçalorc. Thellimi i karakterit bujqësor ndikoi në kthimin e mjaft blegtorëve në bujq. Mbizotërimi i karakterit bujqësor të sanxhakut të Shkodrës do të duket shumë më qartë gjatë shek. XVI.

## 2. VENDI I GRUP-KULTURAVE NË PRODHIMIN BUJQËSOR

Interesi ekonomik i fshatarit nuk kishte qenë i njëjtë për të gjitha kulturat. Ishin nevojat ekonomike në përshtatje me kushtet konkrete të vendit që përcaktonin mbjelljen më shumë apo më pak të njërës apo tjetrës kulturë. Që mendimet tona të jenë sa më të sakta le të analizojmë vendin e veçantë që zinte çdo grup-kulturë në kuadrin e prodhimit bujqësor.

### Ullësiira e Shkodrës (nënzona I + II)

Nr.	Kulturat bujqësore	Sasia e të ardhurave në akçe	Vendi që zenë ato në të ardhurat nga prodhim. bujq. në %
1	2	3	4
1.	Drithëra	83742.5	58.32
2.	Perime,	4600	3.20
3.	Fruta	593	0.41
4.	Prodhime të rrushit	49179	34.25
5.	Bimë për prodhimet zejtare	1243	0.86
6.	Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)	4235	2.94

Shuma e prodhimit bujqësor: 143592.5

**Nënzona I (Nahijet e Shkodrës, Drishtit, Bregut të Këndejmë)**

1	2	3	4
1. Drithëra		78112,5	59,44
2. Perime		4320	3,28
3. Fruta		533	0,41
4. Prodhime të rrushit		43015	32,73
5. Bimë nër prodhime zeytare		1193	0,91
6. Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)		4235	3,22
Shuma e prodhimit bujqësor		131408,5	

**Nënzona c II (Nahijet e Merkodit dhe të Krajës)**

1	2	3	4
1. Drithëra		5630	46,21
2. Perime		280	2,30
3. Fruta		60	0,49
4. Prodhime të rrushit		6164	50,59
5. Bimë për prodhime zeytare		50	0,41
6. Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)		—	—
Shuma e prodhimit bujqësor:		12184	

**Krafi i Dukagjinit (nahijet e Pejës, Suhogëriës, Altun-iliës)**

1	2	3	4
1. Drithëra		290329	44,32
2. Perime		10366	1,50
3. Fruta		9424	1,43
4. Prodhime të rrushit		278530	42,52
5. Bimë për prodhimet zeytare		13007	1,98
6. Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)		53397	8,15
Shuma e prodhimit bujqësor:		655053	

**Krahina e Bihorit (nahijet e Komninit, Playës, Isla Rjekës)**

1	2	3	4
1. Drithëra		63136	92.70
2. Perimë		2347	3.44
3. Fruta		46	0.07
4. Prodhime të rrushit		49	0.07
5. Bimë për prodhimet zeytare		2105	3.10
6. Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)		420	0.62
Shuma e prodhimit bujqësor:		68103	

**Malësia e Shkodrës (nahijet e Kelmendit e të Piprit të vitit 1497)**

3			
1	2	3	4
1. Drithëra		1714	93.46
2. Perime		—	—
3. Fruta		—	—
4. Prodhime të rrushit		120	6.54
5. Bimë për prodhimet zeytare		—	—
6. Prodhimi bujqësor nga ekonomitë e feudalëve (hassa)		—	—
Shuma e prodhimit bujqësor:		1834	

Në Ultësirën e Shkodrës vendin kryesor, në kuadrin e prodhimeve bujqësore, e zinin drithërat. Ato kapnin më shumë se gjysmën e të ardhurave nga bujqësia 58.32% të prodhimit bujqësor. Pas tyre vinin vreshtat me 34.25% dhe perimet me 3.20%. Vendin më të vogël e kishin frutat, ato zinin vetëm 0.41% të të ardhurave nga prodhimet bujqësore.

Nahijet e Shkodrës, të Drishtit dhe të Bregut të Këndejmë përbënin zonën më bujqësore të Ultësirës së Shkodrës. Këtu të ardhurat nga drithërat shënonin 59.44%, nga prodhimet e rrushit 32.73%, nga perimet 3.29% të të ardhurave të prodhimit bujqësor. Këto vise kanë kushte gjeografike më të përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore. Në nahijet e Merkodit dhe të Krajës me një terren më të thyer, të ardhurat nga kulturat bujqësore ishin më të pakta. Aty

të ardhurat më të mëdha vinin nga prodhimet e rrushit, që arrinin në 50,59<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të prodhimit bujqësor. Pozita gjeografike e kësaj treve, me terren kodrinor krijonte kushte për kultivimin në masë të gjerë të vreshtave. Në këto nahije drithërat vinin pas nënprodukteve të rrushit, duke zënë 46.21<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të të ardhurave nga prodhimet bujqësore.

Rrafshi i Dukagjinit i Pejës, të Suhogërlës, dhe të Altun-ilisë) ishte gjithashtu një zonë që siguronte të ardhura të shumta nga bujqësia. Kjo ishte zona që kishte sipërfaqen më të madhe të tokave të punueshme, një specializim më të madh në kulturat bujqësore, si dhe një shumëllojshmëri më të pasur të tyre. Aty vendin më të madh në të ardhurat nga prodhimet bujqësore e zinin drithërat, ato arrinin në 44.52<sup>0</sup>/<sub>0</sub>, prodhimet e rrushit 42.52<sup>0</sup>/<sub>0</sub>, kurse frutat vetëm 1.43<sup>0</sup>/<sub>0</sub>.

Në krahinën e Bihorit, si një zonë e karakterizuar nga një terren malor, të ardhurat nga drithërat zinin 92.70<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të të ardhurave nga prodhimet bujqësore. Të ardhurat nga kulturat e tjera ishin të pakta, nga perimet 3.45<sup>0</sup>/<sub>0</sub>, nga bimët për prodhimet zejtare 3.10<sup>0</sup>/<sub>0</sub>, nga prodhimet e rrushit 0.07<sup>0</sup>/<sub>0</sub>, nga frutat 0.07<sup>0</sup>/<sub>0</sub> etj. Pozita gjeografike, terreni malor kanë influencuar domosdo në numrin e paktë të kulturave bujqësore. Fshatarësia duke e pasur të kufizuar sipërfaqen e tokave të punueshme, e përdori atë krvesisht për mbjelljen e drithërave, dhe shumë më pak për kulturat e tjera.

Në Malësinë e Shkodrës (nahiet e Kelmendit dhe të Pinrit të vitit 1497) të ardhurat nga bujqësia vinin vetëm nga drithërat dhe prodhimet e rrushit, duke zënë respektivisht 93.46<sup>0</sup>/<sub>0</sub> dhe 6.54<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të tyre.

Pra nënkuptohet se tokat e pakta të punueshme në këto anë fshatarët i përdornin krvesisht për drithërat dhe në një masë të vogël për vreshta. Kjo dhe mungesa e një shumëllojshmërie kulturash bënë që drithërat të zinin një vend të konsiderueshëm në të ardhurat nga prodhimet bujqësore. Me gjithë përqindjet e larta kjo nuk do të thotë kursesi se këtu mbilleshin e kultivoheshin më shumë drithëra se në zonat e tjera të sanxhakut të Shkodrës dhe se dega kryesore e ekonomisë ishte bujqësia. Kjo dëshmohet nga fakti se në këtë zonë, ashtu si në krahinën e Bihorit, sasia e të ardhurave nga drithërat e llogaritur në akce është shumë më e vogël sesa në zonat e tjera, të Ulëtisrës së Shkodrës e të Rrafshit të Dukagjinit.

Të ardhurat nga drithërat në Malësinë e Shkodrës ishin të larta në raport me të ardhurat nga bujqësia, por shumë më të ulëta në krahasim me rentën e vjelë nga spahiu, fakt që dëshmon se bujqësia zinte vend fare të vogël në ekonomi. Të dhënat që analizohen dëshmojnë se fshatarësia ishte marrë me bujqësi në të gjitha zonat e sanxhakut të Shkodrës, edhe pse diku bujqësia kishte një zhvillim më të madh dhe diku më të vogël. Me fjalë të tjera ajo nuk kishte një pamje unitare.

### 3. VENDI I BUJQËSISË NË EKONOMINË E SANXHAKUT TË SHKODRËS

Materialet e regjistrit kadastral të vitit 1485 japin mundësi të hidhet dritë jo vetëm mbi shkallën e zhvillimit të bujqësisë, por edhe mbi vendin që ajo zinte në ekonominë e fshatit të marrë në tërësi. Kjo bëhet e mundur po të zbulojmë vendin që zinin të ardhurat nga prodhimet bujqësore (drithërat, perimet, frutat, prodhimet e rrushit, bimët e nevojshme për prodhimin zejtar, të ardhurat nga ekonomitë personale të spahinjve-hassa) në rentën totale që shkonte në doli të feudalëve të vecantë. Më hollësisht gjendja sipas krahinave paraqitet si më poshtë:

Siç del nga këto të dhëna, të ardhura më të mëdha nga tatimet e taksat mbi prodhimet bujqësore siguronte Rrafshi i Dukagjinit dhe zona e ulët e Shkodrës. Në zonën e regjistruar të Rrafshit të Dukagjinit të ardhurat nga prodhimet bujqësore arrinin në 655053 akce dhe zinin 75.4% të rentës së sanxhakut që shkonte në doli të spahinive. Në zonën e ulët të Shkodrës arrinin në 143592.5 akce dhe zinin 16.5% të rentës spahiore. Në Ultësirën e Shkodrës të ardhurat më të mëdha nga prodhimet bujqësore i siguronin nahijet e Shkodrës, të Drishtit e të Breçut të Këndejmë, ato arrinin në 131408.5 akce dhe zinin 15.1 për qind të rentës spahiore të sanxhakut, kurse nga nahijet e Merkodit dhe të Kraiës siguroheshin 12184 akce që përbënin 1.4 për qind të saj. Rrafshi i Dukagjinit dhe Ultësira e Shkodrës kanë kushte më të përshtatshme gjeografike që favorizojnë një zhvillim më të mirë të kulturave bujqësore meqë përbëhen kryesisht nga një terren fushor. Krahina e Bihorit kishte më pak të



**Ekonomia bujqësore e sanxhakut të Shkodrës sipas defterit osman të vitit 1485**

Nr.	Zonat	Të ardhura në akçe nga:						Vendi që zinin të ardhurat e prodhimit bujqësor në shumën totale të zonave të sanxhakut	
		Dritërat	Perimet	Frutat	Prodhime të rrushit	Bimë për prurshmëri të personave (hassa)	Gjithsej të ardhurat nga bujqësia		
1.	Zona e ulët e Shkodrës <sup>1</sup>								
	a) Nënzona I (Nahijet e Shkodrës e të Drishtit, e Bregut të Këndejmë)	83742,5	4600	593	49179	1243	4235	143592,5	16,5
	b) Nënzona II (Nahijet e Merikodit dhe të Krajës)	78112,5	4320	533	43015	1193	4235	131408,5	15,1
2.	Rrafshi i Dukagjinit (Nahijet e Pejës, Suhogëritës, Altun-ilisë).	5630	280	60	6164	50	—	12184	1,4
3.	Krahina e Bihorit (nahijet e Korninit, Playës, Izla-Rjekës).	290329	10366	9424	278530	13007	53397	655053	75,4
4.	Malësia e Mëbshkodrës (nahijet e Kelmendit dhe të Piprit të vitit 1497).	63136	2347	46	49	2105	420	68103	7,8
		1714	—	—	120	—	—	1834	0,3
	<b>Shuma:</b>	<b>438921,5</b>	<b>17313</b>	<b>10063</b>	<b>327878</b>	<b>16355</b>	<b>58052</b>	<b>868582,5</b>	<b>100%</b>

1) Në shumat totale për Ultësirën e Shkodrës nuk janë përfshirë të ardhurat e fshatrave të nahijes së Zhabjakut, meqë ato nuk janë dhënë sipas kulturave bujqësore, por vetëm si shumë e përgjithshme.

**Vendi i grup-kulturave bujqësore në prodhimin e përgjithshëm të Sanxhakut (1485)**

Nr.	Grup-kulturat	Të ardhurat për krejt sanxhakun	Vendi në të ardhurat e prodhimit bujqësor të sanxhakut (86582.5 akçe)	Vendi në të ardhurat totale të rentës spahiore të sanxhakut (1291215 akçe)
1.	Drithërat	438921,5	50.53	33.99
2.	Perimet	17517	1.99	1.34
3.	Frutat	10063	1.16	0.78
4.	Prodhime të rrushit	327878	37.75	25.39
5.	Bimë për prodhime zejtare	16355	1.88	1.27
6.	Ekonomitë personale të feudalëve (hassa)	58052	6.68	4.50

ardhura nga kulturat bujqësore në krahasim me zonën e lartpërmendur, ato arrinin në 68 103 akçe dhe zinin 7.8<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të rentës spahiore të sanxhakut. Zona që shënon shifrën më të ulët të të ardhurave nga prodhimet bujqësore është Malësia e Mbishkodrës (të dhëna kemi vetëm për nahijet e Piprit e të Kelmendit të vitit 1497). Në këto dy nahije ato arrinin në 1834 akçe dhe zinin vetëm 0.3<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të rentës së sanxhakut në dobi të spahut.

Zhvillimi i bujqësisë siç del nga rezultatet e tabelës nuk ka qenë i njëjtë në të gjitha trevat e sanxhakut të Shkodrës. Ai varej nga një sërë faktorësh gjeografikë, klimatikë, ekonomikë, shocërorë, politikë etj. Jo vetëm cdo zonë në kuadrin e sanxhakut të Shkodrës, por edhe cdo nahije edhe cdo fshat kishte specifikën e vet në këtë drejtim. Fakt është se të ardhurat nga prodhimet bujqësore ndryshojnë sipas krahinave.

Me interes është gjithashtu të shikojmë se cili është raporti midis të ardhurave nga bujqësia dhe rentës totale në dobi të spahinjve. Vendi që zënë të ardhurat nga prodhimet bujqësore në rentën totale mendojmë se është një tregues i saktë dhe i drejtë për të përcaktuar vendin në zinte ekonomia bujqësore në cdo trevë. Rriedhimisht, në mënyrë të fërdhërtë, nga kjo del edhe vendi që zinin edhe degët e tjera të ekonomisë fshatare si blegtoria, zejtaria etj.

## Sanxhaku i Shkodrës i vitit 1485

Zonat	Renta spahiore	Në akçe:		
		Të ardhurat nga bujqësia	Vendi i të ardhurave nga bujqësia në rentën spahiore të zonës në %	Vendi i të ardhurave nga bujqësia në rentën spahiore totale të sanxhakat (12912135) në %
1. Ultësira e Shkodrës	195669,5	143592,5	58,32	11,12
a) Nënzona I (N. e Shkodrës, Drishtit, Bregut të Këndejmë).	173551,5	131408,5	59,44	10,18
b) Nënzona II (Nahijat e Merkodit e të Krajë)	22118	12184	46,21	0,94
2. Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	923338	655053	70,94	50,73
3. Krahina e Bihorit	149707	68103	45,49	5,27
4. Malësia e Shkodrës	22499	1834	8,15	0,14
	1291213,5	868582,5	62,78	67,27

Nga shifrat del se të ardhurat nga prodhimet bujqësore në Ultësirën e Shkodrës dhe në Rrafshin e Dukagjinit zinin më shumë se gjysmën e të ardhurave të rentës spahiore respektivisht 58.32 për qind dhe 70.94 për qind, kurse në krahinën e Bihorit 45,49%, dhe në Malësinë e Shkodrës 8.15 për qind.

Vendi kryesor që zenë të ardhurat nga bujqësia në rentën spahiore dëshmon qartë se Ultësira e Shkodrës, zona e Rrafshit të Dukagjinit dhe krahina e Bihorit ishin treva ku bujqësia zinte vendin kryesor në ekonomi. Ky vend nuk ishte i njëjtë në të tria zonat, ai ndryshonte në përputhje me përcindien që zinin në rentën spahiore të ardhurat nga bujqësia. Në Malësinë e Shkodrës (nahijet e Kelmendit e të Pibrut 1497) vendi i të ardhurave nga bujqësia ishte shumë më i pakët, gjë që dëshmon se bujqësia aty nuk ishte e zhvilluar dhe se blegtoria zinte vendin më të rëndësishëm në ekonominë e krahinës. Këtë, ndër të tjera, e provon edhe fakti se të ardhurat për rentën spahiore nga taksat lidhur me blegtorinë ishin më të mëdha se të ardhurat nga prodhimet bujqësore (prej

këtyre vileshin 1834 akçe. ndërsa për taksën e dheneve 1901 akçe). Po të kemi parasysh edhe taksat e tjera që vileshin nga malësorët del se të ardhurat nga bujqësia zinin një vend edhe më të vogël në ekonomi. Kjo të çon pa luhatje në mendimin se këtu blegtoria kishte epërsi mbi bujqësinë, gjë që ishte kushtëzuar nga kushtet gjeografike të terrenit malor. Këtë e mbështet edhe fakti tjetër se këtu kultivoheshin një numër më i vogël kulturash bujqësore në krahasim me trevat e tjera të sanxhakut të Shkodrës, si gruri, elbi dhe pak rrushi (nuk kultivoheshin perimet dhe pemëtaria). Kjo situatë ishte edhe në trevat e tjera malore që paguanin detyrime fikse dhe përfshiheshin në statusin e florixhinjve e të derbendxhinjve.

Vendi që zinte bujqësia e blegtoria në ekonomi bëhet i qartë edhe po të zbulojmë vendin që zinte prodhimi bujqësor i çdo zone në sasinë e përgjithshme të prodhimit bujqësor të sanxhakut, si dhe forcat e gjalla njerëzore (shtëpitë) që kishin zonat bujqësore dhe ato blegtorale.

Nga të dhënat që japin tabelat e mësipërme rezultojnë se klasa feudale osmane, me të marrë pushtetin dhe me të vendosur sistemin e timarit, regjistron një shumë prej 868582.5 akçe rentë që do të merrte nga prodhimi bujqësor i sanxhakut të Shkodrës. E krahasuar me shumën e përgjithshme të të ardhurave të saj që përbëheshin nga disa burime, rezultojnë se nga ekonomia bujqësore e vendit ajo do të siguronte 62.78%. Nga kjo përcindje kuptohet se dega kryesore e ekonomisë së sanxhakut të Shkodrës, ishte bujqësia dhe se mbështetja më e rëndësishme e sistemit feudal ushtarak osman në këtë sanxhak ishte prodhimi bujqësor.

Duke u nisur gjithmonë nga pasqyrat e lartpërmendura, del se vendin e parë nga të ardhurat prej prodhimit bujqësor e zinte Rrafshi i Dukagjinit, me 655053 akçe ose 75.4% të prodhimit bujqësor të krejt sanxhakut, të dytin e zinte Ultësira e Shkodrës, me 143502.5 akçe ose 16.5%, vendin e tretë zona e Bihorit me 68103 akçe ose 7.8% dhe vendin e katërt zona e Malësisë së Shkodrës me një shumë krejt të parëndësishme 1834 akçe ose 0.3%.

E njëjta gjë del edhe nga vendi që zinin të ardhurat nga prodhimi bujqësor i çdo krahine në rentën totale shtetërore të sanxhakut. Kështu prodhimi bujqësor i Rrafshit të Dukagjinit jepte 50,73 për qind, Ultësira e Shkodrës 11.12%, kra-

hina e Bihorit 5,27%, Malësia e Shkodrës 0,14% të të ardhurave të rentës spahiore totale të sanxhakut.

Zona më e fuqishme bujqësore ishte ajo e Rrafshit të Dukagjinit. Për këtë luante rol edhe faktori demografik dhe gjeografik. Kjo zonë kryesisht fushore më 1485 kishte 275 fshatra ose aq sa të tria zonat e tjera dhe rreth 500 shtëpi më shumë se ato. Duke pasur fuqi punëtore më shumë vetvetiu do të prodhonte shumë më tepër se të tjerat. Këtu ndikonte edhe fakti se kishin kaluar 30 vjet që ajo nuk njihte pasojat e luftës pushtuese.

Zona e Ultësirës së Shkodrës, ndonëse ka qenë e njohur si zonë bujqësore e zhvilluar, duke pasur pas furtunës së madhe shkatërruese të pushtuesit osman, pothuajse gjysmën e numrit të fshatrave të zonës së Dukagjinit dhe rreth 1/3 e shtëpive të saj që mbetën domos nuk mund të jepte veçse 1/5 e prodhimit bujqësor të Rrafshit të Dukagjinit. Nga ana tjetër krahinat malore të Bihorit e të Malësisë së Shkodrës, duke mos pasur kushte të përshtatshme për bujqësi do të jepnin bashkërisht vetëm 8%.

Edhe pse është folur për grupet e kulturave bujqësore, duhet të theksojmë se vendi që zinin ato në prodhimin bujqësor të krejt sanxhakut më 1485 paraqitej si më poshtë: 50,5% e zinin kulturat e drithërave të bukës e të tagjisë, 37,7% prodhimi i rrushit, 5,1% perimet, frutat e bimët industriale. Kështu që spahinjët do t'i nxirrnin rreth 88,2% të të ardhurave të tyre nga prodhimi bujqësor vetëm nga drithi e rru-shi, të cilët janë treguesit më tipikë të bujqësisë mesjetare. Në të njëjtën kohë kjo dëshmon për nivelin mjaft të lartë që kishte arritur bujqësia në sanxhakun e Shkodrës.

Të dhënat ekonomike të lartpërmendura provojnë që sanxhaku i Shkodrës, i cili më 1485 ishte sanxhaku më i madh shqiptar, edhe pse përmbante në gjirin e vet zona malore të ashpra e pak produktive në kultura bujqësore, kishte karakter bujqësor në kuptimin e vërtetë të fjalës, kurse blegtoria ishte degë e dorës së dytë e, për më tepër, degë ndihmëse e bujqësisë, pavarësisht se ajo duhet të ishte më e zhvilluar në zonat malore. Ky përfundim, megjilthëse nuk disponohen të dhënat e plota mbi blegtorinë, po të nisemi nga fakti që në zonat malore (Malësia e Mbishkodrës dhe Krahina e Bihorit) ekzistonin 3748 shtëpi ose më pak se 1/4 e gjithë shtëpive të sanxhakut është më i drejtë nga ai në të cilin kanë arri-

tur ato studiues që pohojnë se popullsia shqiptare e zonave veriore ishte kryesisht blegtorale dhe bile nomade. Dhe, duke u nisur nga fakti që një shekull më vonë, më 1582, zonat bujqësore kishin 560 fshatra me 14531 shtëpi e zonat malore 167 fshatra me 4828 shtëpi, 30<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të fshatrave dhe 33<sup>0</sup>/<sub>0</sub> të shtëpive të sanxhakut, gjë që tregon se edhe ekonomia blegtorale duhet të jetë rritur, prapëseprapë duke pasur parasysh se zhvillimi i blegtorisë kushtëzohet nga ai i bujqësisë, ekonomia bujqësore duhet të ketë ruajtur epërsinë e vet, kurse ekonomia blegtorale mbeti pas saj. Këtë përfundim e përforcon fakti që familje të tëra malësore zbritën e u ngulën në zonat fushore, sepse zonat malore nuk mund t'i mbanin, së pari, duke mos pasur terren për shtimin e mëtejshëm të fshatrave dhe, së dyti, se edhe sistemi i tufave nuk mund të bëhej pa siguruar kushtet e nevojshme dimërore, dmth. vetëm me kullotat verore.

Fshatari në shek. XV, XVI merej me rritjen dhe kultivimin e kulturave bujqësore si drithërat, kopshtarinë, pemëtarinë, kulturën e rrushit dhe bimët industriale, por njëherazi edhe me blegtorinë. Në territorin e tij ai kishte livadhet dhe merrej gjithashtu me rritjen e bagëtive si të dheneve, të derrave që i shërbenin për të plotësuar nevojat e jetës. Ai e ripërtërinte jetën e vet duke nxjerrë të ardhura nga bujqësia dhe nga blegtoria, duke u marrë si me njërin ashtu edhe me tjetrën degë të ekonomisë, në përputhje me kushtet konkrete të vendit.

#### 4. TË DHËNAT E DEFTERËVE KADASTRALE PËR BLEGTORINË DHE VLERA E TYRE

Të dhënat konkrete të burimeve kadastrale janë të pamjaftueshme për të shqyrtuar drejtpërdrejt nivelin e zhvillimit të blegtorisë si dhe vendin që zinte ajo në krejt ekonominë. Me to nuk mund të zbulohet vendi i blegtorisë në ekonomi. Në defterët zakonisht janë regjistruar disa taksa që lidhen me blegtorinë si p.sh. bidati i derrave, taksa për livadhet, për barin e korrur etj. Këto taksa nuk shprehin tërësisht të ardhurat që kishte fshatari nga ekonomia blegtorale, ashtu siç paraqitin në mënyrë të saktë të dhjetat e kulturave bujqësore prodhimin bujqësor të një zone të caktuar dhe vlerën e tij në të holla. Nëpërmjet tyre nuk mund të nxirren

të ardhurat e fshatarit nga mishi, qumështi, lëkurët, leshi etj.

Në llogaritjen e të ardhurave nga prodhimet blegtorale në përgjithësi në defterët nuk është shënuar taksa e dhenve, me përjashtim të nahijeve të Kelmendit e të Piprit në regjistrimin e vitit 1497. Kjo taksë përgjithësisht nuk del në zonat e tjera të sanxhakut të Shkodrës, gjë që është pasojë e faktit se ajo shlyhej në dobi të rentës qendrore. Edhe sikur ta njihnim këtë taksë, prej saj mund të nxirrej vetëm numri i dhenve, por jo të ardhurat e fshatarit prej tyre. Taksat e rentës spahiore që lidhen me blegtorinë defterët nuk i japin për trevat e vendosura në statusin e florixhinjve, të derbendxhinjve, të eflakëve të cilat ishin kryesisht vise blegtorale. Tatimet që shlyheshin nga banorët e këtyre viseve ishin në përgjithësi fikse dhe paguheshin në formë qesimi. Ata nuk paguanin të dhjeta prodhimi, meqë nuk i ishin nënshtruar regjimit feudal-ushtarak të timarit.

Me gjithë këto mangësi e shohim me interes të përllogarisim sasinë e të ardhurave nga taksat që lidhen me blegtorinë dhe vendin që ato zinin në rentën spahiore sipas regjistrimit të vitit 1485. Kjo ndonëse nuk jep vendin e blegtorisë në ekonominë e vendit mund të shërbejë si argument për të gjykuar disi mbi ndryshimet që kishin krahinat në zhvillimin e blegtorisë në treva të ndryshme.

Të ardhurat nga taksat lidhur me blegtorinë tregojnë se kjo degë e ekonomisë në trevat e sanxhakut të Shkodrës ka qenë e zhvilluar krahas bujqësisë, duke zënë në ekonomi një vend jo të barabartë në të gjitha zonat. Kjo shprehet edhe nga vendi që këto të ardhura zinin në rentën spahiore. P.sh. në Ultësirën e Shkodrës nahijet nuk kishin të njëjtin nivel zhvillimi të blegtorisë. Në nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të bregut të Këndejmë të ardhurat lidhur me blegtorinë zinin 3,72 për qind të rentës spahiore. Duke kaluar nga një vend fushor, siç është nënzona e parë e Ultësirës së Shkodrës, në një vend më pak fushor rritet edhe vendi që zenë këto të ardhura në rentën spahiore, gjë që flet edhe për vendin më të madh që zinte blegtorinë në ekonominë e atjeshme. Në krahasim me nënzonen e parë, në nahijet e Merkodit dhe të Kranjës ato kapnin 6.87% të rentës spahiore, pra kishin të ardhura më të mëdha nga blegtorinë.

Në zonën e Dukagjinit të ardhurat nga taksat lidhur me blegtorinë zinin 3,71% të rentës që shkon në dobi të spahiut.

## Sanxhaku i Shkodrës i vitit 1485

Në akçe:

Zonat	Taksa e barit		Taksa e barit nga të gjithë	Nga livadhet	Bidati i rrave	Bidati i de-Shuma e të ardhurave	Renta spahiore %	Vendi që zë- në taksat li- dhur me blegtorinë në rentën spahiore në
	barit	të gjithë						
1. Ultësira e Shkodrës	6883,5	—	—	20	1078,5	7982	195669,5	4,08
a) Nënzona e I (Nahijet e Shkodrës, Dritit, Bregu i Këndimë).	5463,5	—	—	20	978,5	6462	173551,5	3,72
b) Nënzona II (Nahijet e Merkodit, Krajës).	1420	—	—	—	100	1520	22118	6,87
2. Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	27508	115	—	60	6571	34254	923338	3,71
3. Krahina e Bihorit	9942	—	—	—	1341	11283	149707	7,54
4. Malësia e Shkodrës	1901	—	—	—	—	1901	22499, (pa taksën e dhenve)	8,45



Edhe këtu zhvillimi i blegtorisë paraqitet jo i njëjtë kudo.

Në krahinën e Bihorit, të ardhurat nga taksat lidhur me blegtorinë zinin 7,54% të rentës spahiore.

Malësia e Shkodrës (nahijet e Kelmendit dhe të Piprit të vitit 1497) ishte treva që shënonte të ardhurat më të mëdha nga taksat e blegtorisë në krahasim me të gjitha zonat e tjera për të cilat folëm më lart. Këto të ardhura zinin 8,45 për qind të rentës spahiore. Tufat e bagëtive ishin për ta një burim i rëndësishëm ekonomik për të përballuar jetën në rrethanat e vështira të pushtimit të huaj e në kushtet jo shumë të përshtatshme të terrenit malor për kultivimin e kulturave bujqësore. Në trevat e Piprit e të Kelmendit taksa e dhenve përbën një nga zërat më të rëndësishëm të detyrimeve. Kjo përbën një argument bindës se kemi të bëjmë përgjithësisht me një popullsi blegtorale dhe me tradita të mira të trashëguara nga brezi në brez në këtë fushë.

Të ardhurat nga taksat e blegtorisë janë një tregues i rëndësishëm që dëshmon në mënyrë të qartë se blegtorja nuk kishte qenë e zhvilluar njëlloj në të gjitha zonat e sanxhakut të Shkodrës dhe se brenda secilës zonë, në nahije të veçanta ajo kishte specifikën e vet.

Nga ana tjetër del se bujqësia dhe blegtorja, si dy anë të ekonomisë kishin qenë të lidhura ngushtë dhe pazgjidhmërisht me njëra-tjetrën. Nuk ka pasur fshat thjesht bujqësor ashtu si nuk ka pasur edhe fshat thjesht blegtoral. Fshatarësia është marrë në të njëjtën kohë me të dyja degët e ekonomisë: me bujqësi dhe me blegtori, pavarësisht se kujt i ka takuar përparësia në krahina të veçanta, kësaj apo asaj dege të ekonomisë.

Siç e kemi theksuar më parë, të dhënat e defterëve nuk na lejojnë të nxjerrim të ardhurat e fshatarit nga ekonomia blegtorale prandaj nuk mund të gjejkojmë për vendin që zinte blegtorja në ekonominë e çdo krahine. Megjithatë për blegtorinë mund të gjejkojmë edhe nga sasia e bagëtive prej të cilave pushteti osman vilte taksën e dhenve. Sipas defterit të hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582 në nahijet e Shkodrës e të Podgoricës ishin vjelë si taksë për dhentë 42000 akçe.<sup>1</sup> Duke pasur parasysh të dhënat e kanunnamesë

---

1) TK.A, defter nr. 59, fl. 6.

së Vuçiternit të viteve 1525, 1530,<sup>1</sup> dhe të kanunnamesë së Sulejman Ligjvënësit,<sup>2</sup> sipas të cilave taksa e dhenve merrej një akçe për çdo dy dele, del se në këto treva duhet të kishte rreth 84000 kokë dhen.

Bujqësia e blegtoria pavarësisht nga vendi i veçantë që zinte në vise të caktuara si dy degë të rëndësishme të ekonomisë, ishin ushtruar në të gjitha trevat, edhe psc përparësia i ka takuar në përgjithësi bujqësisë.

---

1) H. Kaleshi, *Jetna prizrenska i dve vuciternske kanunnama*, *Glasnik Muzeja Kosova, Metohije*, 2 (1957), f. 294-298.

2) M. Arif, *Kanunnâme-i al-i osman*, në *Tarihi Osmani Encümeni Mecmuasi (TOEM)*, cüz 13-18, Istanbul 1330-1331, f. 30.

## KREU IV

### RENTA NË NATYRË DHE RENTA NË TË HOLLA NËN SUNDIMIN VENEDIKAS DHE OSMAN

Kadastra venedikase e Shkodrës e viteve 1416-1417 dhe defteri osman i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 na lejojnë të bëjmë një përpjekje për të përcaktuar vendin që zinin në rentën feudale detyrimet në natyrë dhe ato në të holla. Në këtë drejtim kadastra venedikase është më e varfër sesa defteri osman i regjistrimit të vitit 1485. Kadastra e Shkodrës duke qenë regjistër i pushtuesit të huaj ku shënoheshin të ardhurat për Sinjorinë, nuk jep të dhëna mbi rentën që siguronin feudalët vendas. Në kadastër janë shënuar të gjitha tokat e bashkisë, kufijtë e tyre, personat që i mbanin ato toka dhe sa duhet të paguante secili kur i posedonte si konçesione, apo në çfarëdo mënyre tjetër. Në të është regjistruar e gjithë renta që i shkonte «zotit të vendit», në rastin tonë Sinjorisë, qoftë kjo me detyrim fiks, me të dhjetën e prodhimeve ose me të ardhurat që siguronte bashkia venedikase, duke i lëshuar tokat e veta me qira. Kadastra jep të dhëna për shfrytëzimin ekonomik të fshatarësisë nga pushuesi, nga ana tjetër në raste të veçanta dhe në mënyrë të tërthortë, edhe për shfrytëzimin e fshatarësisë nga feudali

vendas. Rrjedhimisht me të dhënat e këtij burimi mund të ndriçohet renta në natyrë, ajo në të holla që merrte pushteti qendror dhe jo renta feudale në tërësi, meqë nuk njihet në mënyrë të plotë renta në dobi të feudalëve të veçantë.

Defterët osmanë (1485) na japin të dhëna më të plota e më të gjithanshme për çdo kulturë bujqësore në veçanti, për detyrimet blegtorale, për taksat e ndryshme dhe gjobat në të holla etj. Për të gjitha këto detyrime është dhënë edhe vlera e tyre në akçe, pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre grumbulloheshin në natyrë. Zakonisht është shënuar edhe sasia e tyre në natyrë e shprehur sipas njësave matëse të përdorura në atë kohë si barrë, dengje etj.

Të dhëna të kësaj natyre nuk gjenden në regjistrin venedikas të fillimit të shek. XV. Në të thuhet se në përgjithësi nga çdo familje vilej 1 mod drithë dhe e dhjeta e melit dhe asgjë më tepër. Gjithashtu në regjistrin venedikas nuk ekzistojnë të dhëna për perimet, për frutat, për kulturën e lirit etj. Ai nuk jep as të dhëna mbi çështjen se sa llogaritej në të holla 1 mod drithë ose për sasinë e melit dhe vlerën e tij në të holla.

Defterët kadastralë na njohin hollësisht vetëm me rentën në dobi të feudalëve të veçantë, dhe nuk sjellin të dhëna për rentën që vilte pushteti qendror osman. Si rrjedhim, nëpërmjet të dhënave të tyre mund të zbulohet vetëm renta në natyrë e në të holla që përbënte rentën në dobi të feudalëve të veçantë spahinj.

Duke pasur një gjendje të tillë të burimeve sigurisht është vështirë të përcaktohet raporti midis rentës feudale në natyrë dhe asaj në të holla të marrë në tërësi (renta në dobi të pushtetit qendror dhe të feudalëve të veçantë). Megjithatë nëpërmjet një shqyrtimi të imët të materialeve do të përpiqemi të trajtojmë këtë problem brenda mundësive që lejojnë burimet.

## 1) RENTA NË NATYRË DHE NË TË HOLLA NË DOBI TË SHTETIT VENEDIKAS, RAPORTI MIDIS TYRE.

Fshati në shek. XV nuk ishte një njësi e mbyllur në vetvete ku bujku prodhonte vetëm për vete. Përkundrazi ai përfaqësonte një njësi ekonomike që prodhonte edhe për feu-

dalim edhe për tregun. Që një pjesë të prodhimeve fshatari i kishte të destinuar për treg e provon para së gjithash fakti se ai shlyente detyrime në të holla.

Nga regjistri kadastral i viteve 1416-17 del e qartë se shtetit venedikas detyrimet i paguheshin pjesërisht në të holla e pjesërisht në prodhime bujqësore. Sic e kemi vënë në dukje, lryefamiljarët (nënkuptonin vatrat) shlyenin detyrimin fikse në masën e 1 dukati flori, 4 groshëve 1 modi drithë, dhe të dhjetën e melit. Kuptohet vetiu se të hollat për detyrimin e dukatit e të obrokut fshatari i siguronte vetëm nëpërmjet shitjes në treg të produkteve bujqësore e blegtorale.

Dokumentacioni na njeh edhe me raste kur banorë të fshatrave të veçanta, siç ishte rasti i fshatit të Tuzit,<sup>1</sup> i shlyenin detyrimet vetëm në të holla.<sup>2</sup> Ata në vend të taksave të sokut<sup>3</sup> dhe të obrokut<sup>4</sup> që paguanin më parë, siç na bëhet e ditur nëpërmjet kadastrës së vitit 1403, tashmë në vitet 1416-17 paguanin vetëm një sasi të hollash, pa qenë të ngarburuar me detyrime në natyrë dhe me punë angari. Ky ishte një përjashtim i bërë për arsye se të gjithë burrat e aftë për armë (gjithsej rreth 500 burra) qenë të detyruar të kryenin shërbimin ushtarak sipas urdhrave të rektorëve venedikas.<sup>5</sup>

Gjithashtu pronarët e fshatit Podgorë<sup>6</sup> merrnin cdo muaj nga banorët e tij 50 perperë në kohë paqeje, kurse në kohë lufte 100 perperë. Pra të dhënat dokumentare të regjistrit të kadastrës së Shkodrës të marra në shqyrtim, dëshmojnë se fshatari shqiptar si në kohën e principatave, ashtu edhe nën sundimin venedikas nuk ka qenë i mbyllur në guaskën e ekonomisë natyrore, por në një masë të konsiderueshme ishte i lidhur me tregun.

Nga parashtrësia në bëmë në kapitullin e mësipërm del se gruri ishte kultura kryesore midis drithërave, e cila shkonte në dobi të rentës qendrore. Kjo pohohet drejtpërdrejt mjaft herë në materialet e Kadastrës së Shkodrës, ku regjistri nuk

1) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 42/b.

2) *Po aty*, fl. 42/b, 43/b.

3) Soku — detyrim feudal që paguhej për tokën.

4) Obrok ose brok — taksë fikse që paguante çdo shtëpi fshatare për administratën e huaj.

5) *Po aty*, fl. 136/b.

6) *Po aty*, fl. 172/b.

na flet për detyrime në drithë, por vetëm në grurë,<sup>1</sup> duke na dhënë sasinë e tij (në mode) për çdo vatër.

Por për kulturën e melit hasim edhe më tepër vështirësi, pasi ne nuk dimë se ç'sasi meli i shlyente cdo shtëpi fshatari Sinjorisë. Nxjerrja e melit me detyrim fiksohet paraqet raste të pakta. Për trembëdhjetë ara e gjysmë që i janë lëshuar Benko Gramshit dhe Titavës dhe biive të saj, ata duhet të paguanin çdo vit dy mode grurë dhe dy mode mel.<sup>2</sup> Për tokat që i janë lëshuar Pal Gjini Pamaliofit, për besnikërinë ndaj pushtetit venedikas ai paguante pesë mode grurë dhe katër mode mel.<sup>3</sup>

Në fshatin Gaduc është një tokë e quajtur Badara prej dhjetë arash ose aty rreth që i janë dhënë Giin Prekalit dhe për të cilat ai duhet të paguante cdo vit dy mode mel.<sup>4</sup>

Fshatrat e Somesit, të Trompsisit, të Vukut dhe të Luorsit në vend të së dhjetës së melit paguanin dhjetë mode mel në vit.<sup>5</sup> Në fshatin Kakarriq janë trembëdhjetë ara tokë buke që i janë dhënë me koncesion Jon Neraçit me kusht që ai të paguante çdo vit pesë mode mel.<sup>6</sup>

Sic del edhe për kulturën e melit Sinjoria po shkonte drejt zbatimit të detyrimit fikso. Nga tërësia e materialeve të Kadastrës së Shkodrës del se shlyeria e detyrimit të melit me sistemin fikso ishte ende tepër i rrallë: në përgjithësi fshatrat e III-tësirës së Shkodrës e shlyenin këtë kulturë kundrejt të dhjetës së prodhimit. Detyrimi i melit nuk mund të ishte i barabartë nër cdo familje sepse jo të gjitha prodhonin një sasi të barabartë meli. Kështu duke mos ditur sasinë e melit që mbillej e prodhohej, si dhe ç'sasi i dorëzohej pushtuesit venedikas nuk mund të bëhen as llogaritje për të.

Po të marrim si njësi familjen konstatohet se në përgjithësi ajo shlyente në natyrë 1 mod drithë, që vllente rreth 1 perper, ose rreth 0.728 të dukatit,<sup>7</sup> si dhe në të holla 1 dukat flori

---

1) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 83/a, (njëqind e pesëdhjetë mode grurë), 84/b (tre mode grurë), 85/a (njëzet e një mode grurë etj.).

2) *Po aty*, fl. 102/b.

3) *Po aty*, fl. 106/a.

4) *Po aty*, fl. 110/a.

5) *Po aty*, fl. 87/a, 88/b, 89/a.

6) *Po aty*, fl. 93/a.

7) AAV. Tomus IX, Partis II, f. 163.

dhe katër groshë. Le t'i kthejmë groshët në dukate. Groshi ishte i barabartë me rreth 0,050 dukati<sup>1</sup> kurse katër groshëve u takon të kenë rreth 0,200 dukati. Pra detyrimet në të holla për familjen të llogaritura së bashku kapin vlerën e 1,200 dukateve.

Në natyrë kryefamiliarët shlyenin krahas grurit e melit edhe detyrimin për verën, gjë që e rrit më tej vëllimin e rentës në natyrë, si dhe vendin e saj në rentën feudale. Ishte *Sinjoria veredikase ajo që përcaktonte tatimin që do të paguanin fshatarët, nëse ajo do të nxirrte të tretën, të katërtën ose të gjashtën e verës nga prodhimet e vreshtave.*<sup>2</sup> P.sh. fshatarët e Kalldrunit detyroheshin të paguanin taksën në atë masë që do ta përcaktonte Sinjoria. Në mjaft raste edhe në këtë drejtim dokumentacioni flet për shlyerje të detyrimit në formë fikse. Kështu banorët e fshatit Kalldrun duhej të paguanin pas vitit 1417 165 barrë vere të pastër e të kulluar<sup>3</sup> çdo vit dhe këtë verë duhej ta çonin me shpenzimet e veta në kësh-tiellën e Shkodrës. Detyrimi fiks paguhej pavarësisht nëse ishte vit me prodhime të bollshme ose jo. Dhe në rast se fshatarët nuk do të arrinin ta plotësonin sasinë e caktuar të verës atëhere ata ishin të detyruar të paguanin pesë perperë e katër groshë për çdo barrë vere që do të mungonte.<sup>4</sup> Gjith-ashtu Sinjoria i njoftonte rektorët se në vitet pasuese nuk do të dërgoheshin dhjetarë për të çmuar verën, prandaj do të paguanin në bazë të tatimit fiks dhe vetëm në rast mungese të saj të shlyenin detyrimin në të holla.<sup>5</sup> Duke ditur çmimin e një barre vere<sup>6</sup> dhe duke përcaktuar sasinë e barrëve të verës që vilte Sinjoria gjatë një viti jemi përpjekur të llogarisim me

1) *Po aty*.

2) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 41/b. «Nota che iomegnj de caldiron e tegnudj pagar del un de le uigne de caldiron quella quantitate de un che plase a la signoria zioe el terzo o el quarto o el sexto».

3) Sipas kadastrës për vitin 1416-17 do të paguanin 124 barrë vere, fl. 150/b.

4) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 41/b, 45/a.

5) *Po aty*, fl. 42/a.

6) Le t'i kthejmë 5 perperët e 4 groshët, që ishte çmimi i një barre vere, në dukat. Katër groshët, siç e thamë më lart, ishin 0,200 e dukatit. Ndërsa 1 perperë ishte 0,728 e dukatit, pesë perperë bëjnë (5 x 0,728) = 3,640. Gjithsej pesë perperët e katër groshët bëjnë 3,840 dukate.

përafërsi vëllimin e këtij detyrimi në natyrë, si dhe vlerën e tij në të holla.

Më poshtë po paraqitim të ardhurat e detyrimeve në natyrë dhe të atyre në të holla, që shlyenin fshatarët e Ultësirës së Shkodrës ndaj shtetit venedikas, në vitet 1416-17. Në formë të përmbledhur ato paraqiten të tilla:

(Këto shënime i takojnë tabelës në faqen 121)

1) Këtu nuk kemi përfshirë fshatra dhe toka të bashkisë për të cilat nuk na jepet ndonjë sasi e caktuar modesh meqë shlyejnë detyrimet në natyrë, jo në formën fikse. Kështu p.sh. nuk kemi përfshirë fshatin Beltoja (Beltomi), (fl. 79/b), për të cilin në regjistër nuk na jepet numri i shtëpive, por thuhet se banorët e tij duhet t'i paguanin Sinjorisë të dhjetën e të gjitha prodhimeve që korrin. Po ashtu as fshatrat Musanthi e Gramshi, të cilët do t'i paguanin një të dhjetën kishës së Shirgjit ose abatit të saj dhe një të shtatën Sinjorisë. Në qoftë se në shifrën e dhënë më sipër do të kishim përfshirë edhe detyrimin në natyrë të këtyre fshatrave, si dhe të tokave të lëshuara me koncesion personave të veçantë që shlyenin me të dhjetë prodhimi, kuptohet se shifra do të rezultonte më e lartë. Për këto raste të veçanta nuk mund të përcaktohet sasia e drithit që shkonte në hambarët e Venedikut.

Përveç tatimit të modit të drithit, detyrimi tjetër që jepnin në natyrë banorët e zonës së Shkodrës ishte e dhjeta e melit. Ky detyrim nuk përmendet në Regjistrin e Kadastrës së Shkodrës vetëm për shtatëmbëdhjetë fshatra, kurse të tjerat në përgjithësi paguajnë të dhjetën e melit, me përjashtim të pak rasteve që e shlyenin në formë fikse, në mode. Si rrjedhim nuk mund të përcaktohet se sa mode mel vilej si e dhjetë, si dhe vlera e tyre në të holla.

2) Në të ardhurat për Sinjorinë, krahas të ardhurave nga fshatrat, janë përfshirë edhe ato prej tokave të bashkisë, qofshin këto ara apo vreshta që u jepeshin me koncesion personave të veçantë kundrejt detyrimit fiks.

3) Një mod drithë është rreth 1 perper, i cili është i barabartë me rreth 0,728 të dukatit (shih AAV. Tomus IX, Partis II, fq. 163).

4) Një barrë vere është e barabartë me pesë perperë dhe katër groshë =  $3,640 + 0,200$  dukati = 3,840 dukate (shih AAV, Tomus IX, Partis II, fq. 163).

5) Soldi është i barabartë me rreth 0,010 i dukatit (shih AAV, Tomus IX, Partis II, fq. 163).

6) Në detyrimet në të holla përveç dukatit bën pjesë edhe obroku, detyrimi për administratën e huaj, i cili paguhej në groshë. Për të



**Renta në natyrë**

	Sasia e modeve të dritshit <sup>1</sup>	Vlera e modeve të dritshit në dukatë <sup>3</sup>	Sasia e barreve të verës	Vlera e barreve të verës në dukatë <sup>4</sup>	Vlera e rentës në natyrë në dukatë	në akçe <sup>7</sup>
116	1305,25	950,222	594	2280,96	3231,182	113091,370

**Renta në të holla**

Sasia e fshatrave <sup>2</sup>	Sasia e dukatëve	Sasia e perperëve	Vlera e perperëve në dukatë	Sasia e soldeve	Vlera e soldeve në dukatë <sup>5</sup>	Obrok <sup>6</sup> (sasia e Groshëve)	Vlera e rentës në holla		
							Vlera e Groshëve në dukatë	në dukatë në akçe	
116	1010	194	141,232	173	1,730	4429	221,450	1374,412	48104,420

### Vendi i rentës në natyrë dhe asaj në të holla

Renta qendrore (renta në natyrë dhe renta në të holla)	Renta në natyrë e shprehur në dukatë	Vendi që zë renta në natyrë në rentën qendrore	Renta në të holla e shprehur në dukatë	Vendi që zë renta në të holla në rentën qendrore %
4605,594	3231,18	70,15	1374,41	29,85

Në bazë të përlogaritjeve del se banorët e zonës së Shkodrës shlyenin si detyrim në të holla (dukatim, obrokun dhe pagesat për tokat e bashkisë të dhëna me qira) gjithsej 1374.412 dukatë (ose 48104.420 akçe), kurse si rentë në natyrë jepnin 1305 25 mode që vlenin gjithsej 950,222 dukate (ose 33257.770 akçe).

bërë llogaritjet është e domosdoshme t'i kthejmë në njësi të përbashkët monetare, edhe groshët në dukatë. Nga tërësia e materialeve të Kadastrës del se 1106 shtëpi shlyenin obrokun, dhe vetëm gjashtë fshatra nuk e shlyenin atë. Ka raste që Sinjoria i kishte përjashtuar banorët e disa fshatrave nga pagesa e obrokut, por për këtë ishin të detyruar të shkonin për gjah kudo që ta kërkonte ajo dhe gjahun t'ia dorëzonin përsëri asaj. (Në këtë status ishin banorët e fshatit Reglat 95/b, të fshatit Trush 113/a, dhe të fshatit të Trompsisit të vjetër 113/b).

Me fjalë të tjera banorët e zonës së Shkodrës i shlyenin Republikës së Venedikut për taksën e obrokut 221,450 dukatë (1106 shtëpi x 0.200 dukati për një shtëpi dhe 5 groshë x 0.050 dukatë që paguan Anjeza Sekatë për një tokë të bashkisë që gjendet në qytetin e Shkodrës).

Groshi është i barabartë me rreth 0.050 të dukatit (shih AAV, Tomus IX, Partis II, fq. 163).

7) Sipas mendimit të studiuesit H. Inalçik një dukat në fillim të shek. XV ishte i barabartë me 35 akçe. Në hyrjen e Regjistrit të Sanxhakut Shqiptar të vitit 835 hixhri (që i përgjigjet periudhës vjetore 1431-1432) lidhur me vlerësimin e një floriri konstatojmë se ka luhatje nga 33 deri në 36 akçe. Mendimi më i përgjithshëm është se 1 flori është i barabartë me 35 akçe, këtë po e marrim në konsideratë edhe në punimin tonë. (H. Inalçik, *Sûret-i defteri sancaki arvanid*, Ankara 1954, f. XXXV).

Renta në natyrë është akoma më e madhe po t'u shtojmë atyre edhe tatimin për verën. Sipas Kadastrës, fshatarët e Kalldrunit shlyenin 124 barrë vere, të Koplikut 400 barrë vere, të Gruemirës 10 barrë vere dhe ato të Grizhës 60 barrë vere. Vera që i dërgohej Sinjorisë arrinte në 594 barrë,<sup>1</sup> ndër-sa e llogaritur në të holla kapte vlerën e 2280,96 dukateve. Pra vlera e rentës në natyrë, gjithsej me gjithë mangësitë e vëna në dukje, arrinte në 3231,182 dukate.

Pra, në rentën në dobi të shtetit venedikas, renta në natyrë kishte përparësi në krahasim me rentën në të holla. Ajo ishte 2.35 herë më e madhe sesa renta në të holla. Madje kjo përparësi bëhet akoma më e qartë, po të analizojmë edhe detyrimet e tjera që paguante fshatari.

Deri tani ne kemi folur vetëm për detyrimet që i kalonin Republikës së Venedikut. Por fshatarësia shqiptare ndodhej nën një shtypje dhe shfrytëzim të dyfishtë, sepse ajo ishte e detyruar të paguante edhe tatimet për feudalin vendas.<sup>2</sup> Duke pasur parasysh shfrytëzimin e fshatarësisë edhe nga ana e proniarëve, e krerëve dhe e institucioneve fetare del qartë epërsia e rentës natyre ndaj rentës në të holla.

Kadastra venedikase e viteve 1416-1417, siç e kemi vënë në dukje, nuk tregon rentën që i shkonte feudalit vendas të përfaqësuar nga kreu e proniari. Edhe kur jepen të dhëna në këtë drejtim, janë të rastit dhe të pjesshme, dhe nuk kanë të bëjnë aspak me qëllimin e hartimit të regjistrit.

Fshatari, ishte i detyruar të bënte punë angari edhe për proniarin, t'i paguante atij të gjitha tokat paraspor që zotëronte.<sup>3</sup> P.sh. banorët e Kalldrunit,<sup>4</sup> duhet të punonin me punë angari të dhjetë arat që i kishte paraspor kreu i fshatit të tyre. Në bazë të të dhënave të Kadastrës del se kishte fshatra në krye të të cilave qëndronte kreu, kishte fshatra të tjera që kishin proniarë, kishte edhe fshatra që kreu ishte në të njëjtën kohë edhe proniar. Në Ultësirën e Shkodrës ishin re-

---

1) Duhet thënë se në rentën në natyrë nuk kemi përfshirë vresh-tat e bashkisë që u jepeshin me koncesion personave të veçantë që paguanin në raport me prodhimin; ky detyrim shkonte nga e dhjeta deri në gjysmën e prodhimit.

2) I. Zamputi, *Kadastra e Shkodrës*, fl. 41/a, 93/b, 102/a.

3) *Po aty*, fl. 41/a, 45/b, 62/a, 93/b, 102/a, 153/b.

4) *Po aty*, fl. 41/a.

gjistruar gjithsej 17 proniarë. Si kreu dhe proniari qenë pjesëtarë të klasës feudale, ata ishin shfrytëzues, prodhimet bujqësore të parasporëve të tyre ishin rezultat i punës angari të fshatarëve, me fjalë të tjera kreu dhe proniari jetonin në sajë të punës së fshatarit.

Banorët e fshatit Grizhë<sup>1</sup> ishin të detyruar të lëronin e t'i mbillnin të njëzet arat paraspor të proniarit dhe kreut të fshatit të tyre, kurdo që të kërkonte ai. Gjithashtu ata ishin të detyruar t'i korrnin drithërat dhe t'u bënin të gjitha shërbimet e nevojshme derisa t'i dërgonin në shtëpi të gjitha prodhimevet. Fshatarët e Balldrenit<sup>2</sup> ishin të detyruar të mbillnin e të kryenin të gjitha punët në të gjashtë arat paraspor të kreut të fshatit, Aleks Beganit. Po kështu njerëzit e fshatit Belan<sup>3</sup> duhet të lëronin e të mbillnin të shtatë arat paraspor të proniarit Jon Bestole. Kurse proniari duhet t'u jepte vetëm farën. Të gjitha shërbimet ndaj kulturave bujqësore, derisa të dërgohej prodhimi në shtëpinë e proniarit, duhet t'i kryenin pa asnjë pagosë. Po kështu edhe banorët e fshatit Dajç<sup>4</sup> ishin të detyruar të punonin të katërmbëdhjetë arat që i gëzonte si paraspor Jonema Prekali.

Ishin fshatarët ata që punonin tokat paraspor të proniarit apo të kreut, por këta të fundit ishin të detyruar t'u jepnin atyre farën për prodhimet që do të mbilleshin në parasporët e tyre.<sup>5</sup> Gjithashtu krerët apo proniarët duhet t'i mbanin fshatarët e tyre me dy ngrënie në ditë për kohën që ata do të ishin duke punuar në tokat paraspor ose në vend të ushqimit duhet t'u jepnin 6 perperë gjithsej ose 3 perperë për çdo ngrënie<sup>6</sup> kur ata të ishin duke lëruar, duke mbjellë, duke prashitur e duke kryer punëra të tjera në dobi të tyre.

Pra, për krerët dhe proniarët<sup>7</sup> që kishin paraspor fshatari ishte i detyruar të bënte punë angari në tokat e tij duke i kryer të gjitha shërbimet e nevojshme deri në dërgimin në shtëpi të prodhimeve bujqësore. Ndaj fshatarëve që nuk bin-

1) Po aty, fl. 62/a.

2) Po aty, fl. 93/b.

3) Po aty, fl. 102/a.

4) Po aty, fl. 153/b.

5) Po aty, fl. 62/a, 154/a.

6) Po aty, fl. 47/a.

7) Regjistri i kadastrës së Shkodrës na njeh me 17 proniarë.

deshin ose vepronin kundër vendimeve të Sinjorisë dhe për ata që nuk kryenin punën angari në parasporet, merreshin masa duke i gjobitur me një sasi të hollash, — njëzet e pesë perperë. Me këtë gjobë dënoheshin njerëzit e fshatit të Dajçit në rast se nuk i lëronin, i mbillnin dhe i kultivonin të 14 arat e proniarit të tyre, nuk korrnin dhe nuk i dërgonin në shtëpi prodhimet e gatshme.<sup>1</sup> Kur të nxirrej gjoba, ajo do të ndahej në këtë m.nyrë: 3, 4 i takonin pushtuesit dhe 1/4 shkonte për feudalin vendas e konkretisht 1/4 i shkonte bashkisë venedikase, 1/4 rektorit, 1/4 dhomëtarit dhe 1/4 proniarit.<sup>2</sup>

Nga këto të dhëna del se një pjesë e fshatarësisë në Ul-tësirën e Shkodrës shlyente një vëllim të caktuar pune angari. Nga tërësia e materialeve të Kadastrës të Shkodrës merret vesh se paraspore kishin vetëm shtatë fshatra: Balldreni, Belaj, Bisht-Rjoll, Dajçi, Grizha, Kalldrani dhe Krroqi, të cilët janë përgjithësisht fshatra me një numër të madh banorësh si dhe të pasur në prodhime bujqësore. Në pjesën më të madhe të fshatrave nuk figurojnë paraspore. Për krerët dhe proniarët që nuk zotëronin paraspore, fshatari u jepte atyre zakonisht të dhjetën e prodhimeve të veta bujqësore. Duke pasur parasysh se në Ul-tësirën e Shkodrës fshatrat në përgjithësi kishin krerë dhe se vetëm shtatë fshatra kishin paraspore që punoheshin me punë angari, mund të thuhet se pjesa më e madhe e fshatarësisë shlyente edhe një të dhjetën e prodhimeve për proniarët, përveç modit etj. Përlllogaritja me saktësi e vëllimit të kësaj të dhjete është e vështirë. Megjithatë po qe se këto ia shtojmë vëllimit të rentës në natyrë ndaj pushtetit qendror, del qartë se renta totale në natyrë nga pikëpamja e vëllimit bëhet akoma më e madhe se renta në të holla.

Fshatarët bënin punë angari edhe ndaj pushtetit venedikas sa herë që urdhëronin rektorët e Sinjorisë.<sup>3</sup> Fshatari ishte i detyruar të kryente një sërë punësh si p.sh., duhej të bënte dërrasa dhe çdo dru tjetër, të punonte në kështjellë, të përgjigjej për gjithçka që do të jepnin urdhër autoritetet venedikase. Fshatari ishte i shtrënguar të peshkonte kurdoherë që të urdhëronte Sinjoria,<sup>4</sup> p.sh. banorët e fshatrave Trush dhe

1) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 154/a.

2) *Po aty*, fl. 154/a.

3) *Po aty*, fl. 39/b, 45/a, 47/ab.

4) *Po aty*, fl. 109/a, 111/b.

Regbat duhet të merreshin me gjueti për Sinjorinë.<sup>1</sup> Por puna angari që fshatari i zonës së Shkodrës ishte i detyruar të kryente për sunduesin e huaj është e vështirë të përllogaritet. Madje fshatarët e shtypur dhe të shfrytëzuar duhej të jepnin edhe regalie e honorare për proniarët. Banorët e fshatit Grizhë<sup>2</sup> përveç që punonin me punë angari të tridhjetë arat para-spor të proniarit të tyre, duhej t'i çonin atij edhe verë si regalie,<sup>3</sup> dhe këtë duhej ta bënin për të drejtën e proniarit.<sup>4</sup>

Për të kuptuar më mirë raportin midis rentës në natyrë dhe rentës në të holla është e domosdoshme të shqyrtohet për aq sa na intereson mënyra sesi i siguronte të ardhurat Republika e Venedikut, çfarë sistem detyrimi përdorte ajo? Duke kaluar nga njëri sistem detyrimi në tjetrin në regjistrimin e vitit 1416-17 çfarë ndryshimesh u bënë në raportin midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla? Siç dihet Republika e Venedikut në vjeljen e detyrimeve mbi vendet e pushtuara kishte zëvendësuar në një masë të konsiderueshme sistemin e së dhjetës me detyrimin fikse dhe po shkonte gjithnjë drejt konsolidimit të këtij sistemi. Me detyrimin fikse Sinjoria siguronte të ardhura konstante. Në gjithë materialet e Kadas-trës nuk ekziston as edhe një rast që të dëshmojë se ajo me sistemin e ri të grumbullimit të tatimeve, kishte ulur detyrimin, përkundrazi ishte e prirë për t'i shtuar gjithnjë e më shumë fitimet duke rritur sasinë e të ardhurave që nxirrte për fshat. P.sh. proniari dhe kreu i fshatit Trush i Madh duhej t'i shlyenin Sinjorisë detyrimin fikse i cili do të mbetej në masën e tij të plotë edhe po të pakësoheshin shtëpitë brenda fshatit. Fakti që ky detyrim do të qëndronte i pandryshuar edhe në rastet e rënies së numrit të shtëpive të fshatit, tregon se barra e rëndimit ekonomik do të binte mbi shtëpitë e tjera të fshatit, pra rritej për to pesha e shfrytëzimit. Por një qëndrim krejt i kundërt mbahej nga ana e Sinjorisë kur rastiste të kishte zgjerim të fshatit si rrjedhojë e vendosjes së shtëpive të reja që vinin nga territore të zotërimit venedikas. Në këto rrethana proniari dhe kreu ishin të detyruar jo vetëm të shlyenin detyrimin e caktuar fikse, po për çdo shtëpi që do të

1) Po aty, fl. 113/ab, 95/b.

2) Po aty, fl. 170/a.

3) Po aty.

4) Po aty.

shkonte për të banuar në Trush do të nxirrnin aq sa secila shtëpi paguante në vendin nga kishte ardhur.<sup>1</sup> Me këtë veprim, Sinjoria kishte për qëllim të ndalonte lëvizjet e fshatarëve, ta mbante fshatarin të lidhur pas tokës edhe në të njëjtën kohë të mos cenonte aspak të ardhurat e saj. Pra pakësimi i numrit të shtëpive të fshatit e rëndonte më tepër gjendjen e familjeve që vazhdonin të qëndronin aty, ndërsa rritja e tyre nuk sillte ndonjë ndryshim në gjendjen e fshatarësisë. Nga ana tjetër pakësimi i numrit të shtëpive të fshatit nuk ia cenonte të ardhurat Venedikut, ndërsa rritja e tyre sillte me vete edhe rritjen e të ardhurave për shtetin dukal. Sinjoria kishte orientuar ndjekjen e një politike të tillë që çdo ndryshim që do të ndodhte në kuadrin e fshatit qoftë zvogëlim apo zmadhim i tij të ishte në interes të saj.

Gjatë periudhës së sundimit venedikas, periudhë relativisht e shkurtër, vëllimi i rentës në natyrë dhe ai i rentës në të holla pësuan ndryshime; vëllimi i rentave nuk paraqitet i dhënë një herë e përgjithmonë, përkundrazi ai ecën në rrugën e zhvillimit në përshtatje me kushtet konkrete të vendit dhe me ndryshimet që bëjnë pushtuesit për mënyrën e nxjerrjes së detyrimeve. Zëvendësimi i detyrimit në raport me prodhimin me detyrimin fiks në vjeljen e tatimeve ndikoi domosdo edhe në vëllimin e njërës apo tjetrës rentë. Fshatarësia duke i paguar detyrimet me sistemin e së dhjetës jepte në natyrë një vëllim më të madh të rentës, kurse me sistemin e detyrimit fiks ajo dorëzonte në pjesë të detyrimeve në prodhime bujqësore (drithërat, meli, vera) siç ishte modi, e dhjeta e melit, detyrimi për verën, por në të njëjtën kohë shlyente edhe detyrime në të holla (dukatin, obrokun). Me këtë ndryshim pakësohej vëllimi i rentës në natyrë dhe rritej renta në të holla. Madje kjo dëshmon se zhvillimi i ekonomisë feudale tashmë kishte përparuar mjaft se ai e bënte të mundshme rritjen e rentës në të holla nga ana e pushtuesit; kjo tregon se fshatari ishte i lidhur më shumë me tregun. Është e kuptueshme se nga ana e vet kjo rentë ndikonte në një zhvillim më të madh të tregut dhe të qarkullimit monetar, sepse fshatari duhet të shiste prodhimet e veta që të nxirrte të hollat e nevojshme për shlyerjen e rentës.

Mbi masat ra pesha e shfrytëzimit të huaj, e feudalëve

1) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 113/a, 166/b.

vendas dhe në të njëjtën kohë edhe e institucioneve fetare.<sup>1</sup> të cilat si pjesë përbërëse e klasës feudale, me politikën dhe veprimtarinë e tyre u shërbyen sunduesve të vendit. Për këtë pushtuesi i huaj i kishte përjashtuar nga taksat<sup>2</sup> dhe i kishte çliruar nga detyrimet,<sup>3</sup> ashtu si në kohërat e mëparshme edhe tani në kohën e zotërimit venedikas.<sup>4</sup> Peshkopatat përherë kanë qenë të falura nga pagesat e doganave, nga çdo lloj takse. nga honoraret, nga të dhjetat si dhe nga çfarëdo ngarkese. Pushtuesi i huaj, për besnikërinë e madhe dhe veprat e lavdërueshme autoritetet fetare i kishte shpërblyer me benefice të mëdha<sup>5</sup> dhe me koncesionc.<sup>6</sup> Regjistrat kadastralë na dëshmojnë se peshkopatat kanë qenë pronare të mëdha tokash. Peshkopi i Shkodrës Johan Nigri pohonte se peshkopata e tij kishte rreth 100 ara<sup>7</sup> në vendin e Siljetit, të cilat kufizoheshin nga Drini, Drinasa, nga fshatrat Gleros dhe Kroni i Zi.<sup>8</sup> Nëpërmjet dokumenteve bëhet e qartë se në duart e kishës dhe të institucioneve të tjera fetare ishin sipërfaqe të tëra tokash. Popullsia që jetonte në këto vise shlyente përgjithësisht detyrimet në natyrë. Pra po të kemi parasysh edhe atë pjesë të fshatarësisë që banonte në territore të këtyre institucioneve, kuptohet që vëllimi i rentës në natyrë rritet akoma më shumë. Në kadastrën e viteve 1416-17 fshati Domini figuron i pabanuar, por më parë, sipas kadastrës së vjetër, banorët e tij paguanin të dhjetën kur mbillnin në tokën e Sinjorisë, ndërsa kur mbillnin në tokën e abatis duhej t'i paguanin të dhjetën abatis dhe obrokun Sinjorisë.<sup>9</sup> Banorët e fshatrave të Musanthit e të Gramshit ishin të detyruar t'i paguanin të dhjetën kishës së Shirgjit ose abatis të saj dhe të shtatën Sinjorisë dukale të Venedikut.<sup>10</sup> Fshati i Shirgjit

1) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 97/a.

2) *Po aty*, fl. 45/a, 46/a, 78/a, 90/a, 139/a.

3) *Po aty*, fl. 45/a.

4) *Po aty*, fl. 161/a.

5) *Po aty*, fl. 161/b.

6) *Po aty*, fl. 161/b.

7) Për sipërfaqen e arës janë dhënë mendime nga studiues të ndryshëm. G. Valentini mendon se ara ka një sipërfaqe prej 3,6 ha, ndërsa I. Zamputi thotë se ara ka një sipërfaqe prej 2,5 ha.

8) I. Zamputi. *Kadastra e Shkodrës*, fl. 161/a.

9) *Po aty*, fl. 110/b.

10) *Po aty*, fl. 97/a.



në bazë të kadastrës së vjetër i ka takuar abacisë, prandaj edhe ia shlyente të dhjetën abatis, kurse modin dhe obrokun Sinjorisë. Kisha dhe institucionet fetare në tërësi kanë qenë pronarë të mëdhenj tokash; ato kishin përqendruar në duart e tyre pasuri të mëdha kryesisht duke shfrytëzuar punën e fshatarit të varur.

\*  
\*   \*  
\*

## 2. RENTA SPAHIORE NË NATYRË E NË TË HOLLA, RAPORTI MIDIS TYRE

Përbërjen dhe raportin midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla, në saje të një dokumentacioni më të pasur, e njohim më mirë për periudhën e sundimit osman në shek. XV. Fshatrat e Sanxhakut të Shkodrës, si të zonave fushore, ashtu edhe të atyre malore shlyenin detyrime në natyrë dhe detyrime në të holla. Sipas defterëve kadastralë në dobi të spahiut shkonte renta në natyrë dhe një pjesë e rentës në të holla. Në bazë të të dhënave të regjistrave dhe të kanunnameve fshatari i shlyente në natyrë spahiut të dhjetat e prodhimeve kryesore bujqësore siç ishin: e dhjeta e grurit, e thekrës, e elbit, e okrës, e tagjisë, e melit, e ujemit dhe e ndonjë drithi tjetër, e dhjeta e burçakut, e thjerrzës, e bathës, në natyrë shlyhej dhe e dhjeta për mushtin. Për këto në defterët janë regjistruar sasitë e të dhjetës së prodhimeve bujqësore në bazë të njësive matëse të kohës në barrë, dengje, karte për drithërat, medre, sabur për mushtin e verës. Krahas këtyre është shënuar edhe vlera e tyre në akçe që shërben për të përllogaritur të ardhurat e feudeve. Përveç këtyre e dhjeta për perimet, me përjashtim të bathëve, të thjerrzave e të burçakut, për frutat, për livadhet nuk është vjelë në natyrë siç veprohej zakonisht për të dhjetat e prodhimeve bujqësore kryesore, por në të holla. Kjo për arsye se vjelja e tyre në natyrë paraqiste vështirësi për spahinj të. Në defterët për to janë shënuar vetëm të ardhurat e tyre në akçe në formën e taksave si p.sh. taksa e qepëve, e spinaqit, dhe e perimeve të tjera, taksa e gështenjave, e arrave, e kumbullave, e qershive,

e mollëve, e dardhëve, e fiqve dhe e frutave të tjera, taksa e linit, e qoqelit, e zagrefanit, e barit, e livadhit, e druve. Në dobi të spahiut shlyheshin edhe disa taksa të tjera si taksa e govatës, e fuçisë, e bletëve, e peshkut, bidati i derrave, bidati i egërsirave, baxhi i pazarit dhe taksa e miroponit, baxhi i verës, taksa e manastirit, e qymyrit, e dajlanit, e mullinjve. Pjesën kryesore të rentës në të holla për spahinj të e përbënte ispenxhja, nijabeti dhe badihavatë. Duke grupuar detyrimet në natyrë dhe ato në të holla që jep defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 do të përpiqemi të përcaktojmë vendin që zinte secila prej tyre në rentën në dobi të spahiut.

Të dhënat tregojnë se sasia e detyrimeve në të holla që grumbullonte spahiu ndryshonte nga vlera e tatimeve në natyrë. Në krahina të veçanta të sanxhakut të Shkodrës raporti midis rentës në natyrë dhe asaj në të holla ishte i ndryshëm.

Nga Ultësira e Shkodrës të ardhurat në natyrë që shkonin në dobi të spahiut arrinin në 132755,5 akçe, ndërsa detyrimi në të holla 58679 akçe: ato zinin respektivisht 69,35% dhe 30,65% të rentës spahiore. Pra të ardhurat nga renta në natyrë këtu janë mbi dy herë më të mëdha se ato në të holla. Në nahije të veçanta ky raport ishte akoma më shumë në dobi të rentës në natyrë. Kështu p.sh. në nahijet e Shkodrës, të Drishtit dhe të Bregut të Këndejmë sasia e të ardhurave nga detyrimet në natyrë arrin në 121661,5 akçe dhe zinin 71,85% të rentës spahiore, ndërsa sasia e të ardhurave nga renta në të holla ishte 47655, d.m.th. 28,15% të rentës spahiore. Në nahijet e Merkodit dhe të Krajës sasia e të ardhurave në natyrë për spahiu ishte 11094 akçe dhe zinte 50,16% të rentës spahiore, kurse të ardhurat në të holla ishin 11024 dhe zinin 49,84% të rentës spahiore.

Në nahijet e Pejës, të Suhogërlës e të Altun-ilisë detyrimet në natyrë arrinin në 549954 akçe dhe zinin 63,22% të rentës spahiore, ndërsa ato në të holla kapnin 319987 akçe dhe zinin 36,78% të rentës spahiore. Pra Ultësira e Shkodrës dhe Rrafshi i Dukagjinit përbëjnë dy zonat më prodhuese e më të rëndësishme të sanxhakut të Shkodrës, ku spahinj të ardhurat më të mëdha i siguronin nga detyrimet e vjela në natyrë.

Në krahinën e Bihorit tatimet në natyrë që i shkonin spahiut kishin një vlerë prej 63376 dhe zinin 42,45% të rentës spahiore, ndërsa të ardhurat në të holla ishin 85911, d.m.th. 57,55% të rentës spahiore.

## Renta spahiore në sanxhakun e Shkodrës (Pa nahijen e Zhabjakut)

Renta në natyrë e shprehur në akçe:

Zonat	Drithërat	Perime <sup>2</sup>	Musht	Shuma
1. Ullësira e Shkodrës <sup>1</sup>	83742,5	2339	46674	132755,5
a) Nahijet e Shkodrës Drishtit e të Bregut të Këndejmë	78112,5	2339	41210	121661,5
b) Nahijet e Merkodit e të Krajës	5630	—	5464	11094
2. Malësia e Shkodrës (nahijet e Kelmendit e të Piprit më 1497)	1714	—	120	1834
3. Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	290329	2380	257245	549954
4. Krahina e Bihorit	63136	200	40	63376
	438921,5	4919	304079	747919,5

1) Në shumën totale nuk kemi përfshirë të ardhurat e nahijes së Zhabjakut, për arsye që përmenden më sipër.

2) Këtu kemi përfshirë vetëm të ardhurat nga bathët, thjerrëzat, dhe burçaku, të cilat sipas defterit të vitit 1485 ishin shlyer në natyrë.

## Renta në të holla (në akçe)

Zonat	Perime e frutat	Taksa e govatës dhe e fuqisë	Bimë të ndryshme për prodh. zeytarie	Kullota	Taksa e druve	Taksa e blëve	Taksa të ndryshme, e 10 e peshkut, manastir, gymyr e taksa e dajlanimit	Bidati i derrave egërsirave	Taksa e mullirit	Nijabeti baxhi-pazar taksa miroponit? gjer-dekut, badinavate	Ispenxhe	Shuma
1. Ultësira e Shkodrës	2854	2505	1243	6903,5	2755	1535	300	1078,5	—	1331	38174	58679
a) Nahijet e Shkodrës Drishtit e të Bregut të Këndejmë,	2514	1805	1193	5483,5	2191	1535	300	978,5	—	1331	30324	47655
b) Nahijet e Merkodit e të Krajës.	340	700	50	1420	564	—	—	100	60	2023	7850	11024
2. Malësia e Shkodrës	—	—	—	—	—	23	—	16	—	—	18543	20665
3. Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	17410	21285	13007	27683	11170	6163	219	6571	8647	19329	188503	319987
4. Krahina e Bihorit	2193	9	2105	9942	3908	1870	—	1341	1895	6714	55934	85911
<b>Shuma:</b>	224 57	23799	16355	44528,5	17833	9591	519	9006,5	10602	29397	301154	485242

1) Kemi përfshirë të ardhurat nga ato perime, të cilat vileshin në të holla sipas defterit të vitit 1485. Siç e kemi theksuar më lart vetëm për bathët, thjerrëzat e burçakun të dhjetat vileshin në natyrë.

2) Nijabetin, baxhin e pazarit dhe taksën e miroponit e kemi dhënë së bashku për faktin se edhe defteri në disa raste i regjistron pa i ndarë në zëra më vete.

## Raporti midis detyrimeve në natyrë dhe atyre në të holla në rentën spahiore

Zonat	Rental spahiore	Shuma e rentës në natyrë		Vendi që zë renta në natyrë në rentën spahiore		Vendi i rentës në të holla në rentën spahiore	
		191434,5	132755,5	69,35	58678	30,65	19,93
1. Ullësira e Shkodrës							
a) Nahijet e Shkodrës, Drishtit e të Bregut të Këndejmë	169316,5	121661,5	71,85	47655	28,15	17,91	
b) Nahijet e Merkodit e të Krajës	22118 22499	11094 1834	50,16 8,15	11024 20665	49,84 91,85	35,49 82,42	
2. Malësia e Shkodrës							
3. Rrafshi i Dukagjinit (një pjesë)	869941 149287	549954 63376	63,22 42,45	319987 83911	36,78 57,55	21,67 37,47	
4. Krahina e Bihorit							
Sanxhaku i Shkodrës (në tërësi)	1233161,5	747919,5	60,65	485242	39,39	24,42	

1) Në shqyrtimin e raportit midis rentës në natyrë e rentës në të holla nuk kemi përfshirë të ardhurat nga ekonomitë personale të feudalit (hassa), sepse në këto feudalit nuk grumbullonte të ardhurat me të dhjetë apo nëpërmjet taksash, por merrie gjithë prodhimin. Për të qenë më të saktë këto i kemi zbritur nga shuma totale e rentës spahiore.

Në Malësinë e Shkodrës detyrimet në prodhime në natyrë kishin vlerën e 1834 akçeve dhe zinin 8,15% të rentës spahiore, ndërsa detyrimet në të holla arrinin në 20665 akçe, d.m.th. përbënin 91,85% të rentës spahiore.

